

**TIPET E FERMAVE BUJQËSORE NË KOSOVË DHE
KONKURRUESHMËRIA E TYRE NË TREG
(RAJONI I PEJËS, GJAKOVËS DHE PRIZRENIT)**

Doktorant
Emine DACI-ZEJNULLAHI

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, me profil Zhvillim Ekonomik i
Qëndrueshëm për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Natasha Hodaj

Numri i fjalëve:53,452

Tiranë, Janar 2017

**TIPET E FERMAVE BUJQËSORE NË KOSOVË DHE
KONKURRUESHMËRIA E TYRE NË TREG
(RAJONI I PEJËS, GJAKOVËS DHE PRIZRENIT)**

Doktorant

Emine DACI-ZEJNULLAHI

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, me profil Ekonomi dhe zhvillim i
qendrueshëm për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Natasha Hodaj

Numri i fjalëve:53,452

Tiranë, Janar 2017

DEKLARATË E AUTORËSISË

Me përgjegjësinë morale dhe personale deklaroj se ky punim është origjinal dhe nuk është kopjuar nga punimet e hulumtuesve të tjerë me përjashtim të rasteve ku janë të cituar. Ky punim është rezultat i punës sime në zyrë, dhe në terren gjatë anketimit të fermerëve si dhe konsultimeve me ekspertë të fushës. Të gjitha rezultatet e fituara janë publikuar në këtë punim.

Emine Daci-Zejnullahi

Firma:

HYRJE E PËRGJITHSHME

ABSTRAKT

Bujqësia është një nga sektorët bazë dhe me potencial shumë të madh në Kosovë por që aktualisht nuk po arrin dot të konkurrojë denjësisht në tregjet kombëtare e ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës i ka kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit bujqësor por kërkohet ende koordinim dhe adaptim të Politikës Bujqësore Evropiane me qëllim shtimin e prodhimit dhe rritjen e të ardhurave nga ferma.

Zhvillimi i bujqësisë kosovare, duke rritur efikasitetin e përgjithshme dhe produktivitetin në fermë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve bujqësore, krahasuar me treguesit kombëtarë aktualë dhe atyre të vendeve të rajonit.

Ndryshimet e mëdha, që po ndodhin sot në kushtet e globalizimit, po determinojnë nevojën që të kemi një qasje krejt tjetër në raport me bujqësinë, jo vetëm si burim i punësimit të njerëzve por dhe si një element i rëndësishëm i sigurimit të ushqimit të popullsisë.

Bujqësia është çelësi me anë të së cilës adresohen çështjet e lehtësimit të varfërisë, sigurimit të ushqimit, menaxhimit të resurseve natyrore dhe qëndrueshmërisë ambientale.

Nisur nga këto fakte është e domosdoshme të studiohen karakteristikat e fermave kosovare në Rrafshin e Dukagjinit me qëllim që të kuptojmë se cilat prej tyre do të jenë ekonomikisht të frytshme dhe konkurrense në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: Fermat, tipologjia, Rrafshi i Dukagjinit, ekonomia, specializimet, anketa.

ABSTRACT

Agriculture is a basic sector and great potential in Kosovo but that currently can not compete with dignity in national and international markets. The Government of Kosovo has paid special attention to agricultural development but still required coordination and adaptation to European agricultural policy in order to increase production and increase farm income.

Kosovo agriculture development, through increasing overall efficiency and productivity on the farm will be a positive impact on the competitiveness of agricultural products, compared with the current national indicators and those of the region.

The great changes taking place today in conditions of globalization, determine the need to have a completely different approach in relation to agriculture, not only as a source of employment for people but also as an important element of food security of the population.

Agriculture is the key to address issues of poverty reduction, food security, natural resource management and environmental sustainability.

Based on these facts it is necessary to study the characteristics of the Kosovo farms in the Dukagjin region in order to understand which of them will be economically productive and competitive in national and international markets.

Keywords: farms, typology, plane of Dukagjin, economy, specializations, survey

FALËNDERIME

Me rastin e përfundimit të studimeve doktorale në UET, shfrytëzoj rastin të falënderoj disa persona të cilët kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në përfundimin me sukses të studimeve të mia. Në radhë të parë falënderoj profesorët e Universitetit European të Tiranës, të shkollës doktorale në krye me Prof.Dr.Ardian Civicin duke qenë gjithherë falënderuese për konsultat, këshillat dhe mësimet e vlefshme që i kam marrë e bindur se gjithherë do të më shërbejnë në jetë.

Një falënderim i veçantë për udhëheqësen time shkencore Prof. Dr. Natasha Hodaj, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi gjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e saj të pazëvendësueshëm drejt finalizimit të punimit tim, i cili është produkt i shumë e shumë orëve këshilla, konsultime dhe mbështetje nga ana e saj.

Në fund falënderoj familjen time për mbështetjen e vazhdueshme që më ka dhënë gjatë tërë kohës së studimeve, por shfrytëzoj rastin të falënderoj kolegët dhe bashkëpunëtorët e tjerë për përkrahjen që më kanë ofruar përmes konsultimeve, literaturës dhe këshillave.

Përzemërsisht

Emine Daci Zejnullahi

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE E PËRGJITHSHME	iii
ABSTRACT	iv
LISTA E SHKURTIMEVE	ix
KAPITULLI I	8
1.1 Hyrje.....	8
1.2. Qëllimi i studimit.....	10
1.3 Objektivat e studimit	11
1.4 Pyetjet kërkimore.....	11
1.5 Zgjedhja e metodës së studimit	12
1.6 Struktura e studimit.....	13
1.7. Kufizimet e studimit.....	16
KAPITULLI II	17
2. RISHIKIMI I LITERATURËS DHE TIPOLOGJIA E FERMËS NË KOSOVË DHE RAJON.....	17
2.1 Karakteristikat e fermave bujqësore.....	17
2.2 Klasifikimi i tipeve të fermave sipas literaturës	20
2.2.1 Llojet e Fermave sipas WAW	21
2.3. Tipologjia e fermave në Kosovë dhe vendeve në rajon	32
2.3.1. Tipologjia e fermave në Shqipëri.....	33
2.3.2. Tipologjia e fermave në Bosnjë –Hercegovinë.....	34
2.3.3. Tipologjia e fermave në Maqedoni	35
2.3.4. Tipologjia e fermave në Mal të Zi.....	36
2.3.5. Tipologjia e fermave në Serbi	36
2.4. Modelet e fermave në Kosovë.....	37
KAPITULLI III.....	41
3. SITUATA E ZHVILLIMIT RURAL NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT	41
(Rajoni i Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit)	41
3.1. Karakteristikat gjeografike	41
3.1.1. Struktura administrative	42
3.1.3. Konteksti Makroekonomik i Kosovës.....	45
3.1.3.3 Bujqësia në ekonominë kombëtare	48
3.1.3.4 Resurset natyrore për bujqësinë.....	50
3.1.3.5 Struktura e fermës.....	52
3.1.3.6 Prodhimet bujqësore	59
Pemëtaria.....	61
Blegtoria	63
Spektori i Qumështit.....	64
Spektori i mishit dhe vezëve	66
Spektori agro-përpunues.....	66
Rrushit dhe Vera	67
Biodiversiteti.....	68
Pyjet	69
Kullosat.....	69
Gjendja e ambientit	70
Zonat e Mbrojtura	70
Shërbimet këshillimore	71
KAPITULLI IV	63
4. VLERESIMI I SITUATËS EKONOMIKE TE FERMAVE BUJQËSORE NË RAJONIN E PEJËS, PRIZRENIT DHE GJAKOVËS	63
4.1. Treguesit kryesorë të ekonomisë bujqësore	63

4.2. Situata ekonomike e fermave në Rrafshin e Dukagjinit	72
4.3. Rajoni i Prizrenit.....	74
3.3.1. Përshkrimi i situatës ekonomike në rajonin e Prizrenit.....	74
4.3.1. Situata sociale - ekonomike e rajonit të Prizrenit	75
4.3.2. Zhvillimi i sektorit të Bujqësisë në Rajonin e Prizrenit.....	82
Kultivimi i drithërave në rajonin e Prizrenit	88
Perimtaria në Rajonin e Prizrenit.....	90
Pemëtaria në Rajonin e Prizrenit	91
Blegtoria në Rajonin e Prizrenit.....	93
Komuna e Suharekës	96
Komuna e Mamushës.....	97
Komuna e Dragashit	97
Komuna e Malishevës	100
3.4. Rajoni i Gjakovës	103
3.4.1. Situata sociale - ekonomike e rajonit të Gjakovës.....	103
3.4.2. Zhvillimi i Bujqësisë në rajonin e Gjakovës	103
Situata sociale - ekonomike dhe pozita gjeografike e Komunës së Rahovecit	112
Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të bujqësisë në komunën e Rahovecit.....	113
Sfidat në sektorin e bujqësisë (agrobiznesit) në rajonin e Rahovecit	114
3.5. Rajoni i Pejës	117
3.5.1. Situata sociale - ekonomike e Pejës	117
3.5.2. Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të bujqësisë në rajonin e Pejës.....	120
Sektori i blegtorisë.....	128
Situata e ujitjes në rajonin e Pejës.....	130
Zhvillimi Social-Ekonomik i Komunës së Klinës.....	132
Bujqësia dhe zhvillimi rural në komunën e Istogut.....	134
Agro-përpunimi, tregu dhe marketingu.....	137
KAPITULLI V	139
5. Metodologjia e studimit	139
4.1. Paradiagnostika.....	140
4.1.1. Grumbullimi dhe analizimi i dokumentacionit të disponueshëm	140
4.1.2. Përcaktimi i zonës së studimit.....	141
Përzgjedhja e mostrës.....	144
Mbledhja e të dhënave.....	148
4.2.2. Realizimi i anketës.....	152
Analiza e të dhënave dhe përpunimi i informacionit	155
KAPITULLI VI	164
REZULTATET E STUDIMIT.....	164
Indikatori 1 - Përshkrimi i familjes fermere	166
Indikatori 2 - Niveli i edukimit të fermerëve	168
Indikatori 3 - Fermat sipas forcës së punës	171
Indikatori 4 - Llojet e punës në fermë	172
Indikatori 5 - Numri i fermave që punësojnë punëtor	174
Indikatori 6 - Llojet e të ardhurave shtesë në fermë	174
Indikatori 7 - Struktura e tokës.....	177
Indikatori 8 - Madhësia e fermave.....	181
Indikatori 9 - Ujitja e fermës.....	182
Indikatori 10 - Pajisje dhe makineri pune.....	183
Indikatori 11 - Vlera e prodhimit.....	183
Indikatori 12 – Shpenzimet në fermë.....	184
Indikatori 13 - Lloji i të ardhurave në fermë.....	187
Analiza e klasterëve	192
1. Fermat që mbjellin kultura lavërtare me drejtim kryesor autokonsumin.	192
2. Klasteri me kultura të përhershme	192
3. Klasteri me bagëti që kullosin	193

4. Klasteri me kultura të përziera	194
5. Klasteri të përziera blegtorale	194
6. Klasteri me ferma të përziera bimë dhe kafshë	195
Rekomandime të pjesshme	195
KAPITULLI VII	198
KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET	198
7.1. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	198
7.2 REKOMANDIME.....	210
8. Appendix 1-tabelat e hulumtimit	212
8.1. Tabela e hulumtimit në rajonin e Pejës.....	212
8.2.Tabela e hulumtimit në rajonin e Prizrenit.....	214
8.3.Tabela e hulumtimit në rajonin e Gjakovës	216
7. BIBLIOGRAFIA	229

LISTA E SHKURTIMEVE

BE – Bashkimi Evropian

EUROSTAT – Statistikat e Evropës

NJ.B – Njësia Blegtorale

MBPZHR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

HMSJ - Hulumtimi i Matjeve të Standardit të Jetesës

BPV – Bruto Produkti Vendor

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

ASK – Agjensioni i Statistikave të Kosovës

IKP - Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve

NjPV - Njësitë e Punës Vjetore

PZHK - Plani Zhvillimor Komunal

VSM - Vlerësimi Strategjik Mjedisor

FTP - Faktori Total i Produktivitetit

FADN - Rrjeti i Kontabilitetit në Fermë

FSS - Anketa e Strukturës së Fermës

FTP - Faktorit Total i Produktivitetit

Lista e tabelave

Tabela 1: Sipërfaqja në km² dhe popullsia e Kosovës 1921-2014

Tabela 2: Popullsia rurale dhe urbane në Kosovë (1981 – 2014)

Tabela 3: Treguesit ekonomikë të Kosovës 2001 – 2014, si përqindje e BPV-së

Tabela 4: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme sipas viteve 2005-2013 ('000 €)

Tabela 5: Struktura e fermës sipas madhësisë dhe llojeve në vitin 2013

Tabela 6: Numri i fermave në fushën e hulumtimit

Tabela 7: Kategoritë e fermave sipas madhësisë së sipërfaqes punuese

Tabela 8: Ekonomitë Bujqësore sipas pronësisë së tokës, Kosovë, 2014

Tabela 9: Kategorizimi i llojit kryesor të fermave

Tabela 10: Sipërfaqja e kulturave bujqësore në vitet 2005-2013

Tabela 11: Prodhimi i kulturave bujqësore sipas viteve 2005-2013

Tabela 12: Tregjet

Tabela 13: Kostoja e prodhimit në fermat qumështore

Tabela 14: Zonat e mbrojtura në Kosovë, sipas IUCN

Tabela 15: Numri i fermave bujqësore, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, njësia blegtorale dhe njësia e punës vjetore(njpv), sipas statusit ligjor të ekonomive, Kosovë, 2014

Tabela 16: Ekonomitë Bujqësore sipas statusit ligjor, sipas komunave, Kosovë, 2014

Tabela 17: Ndarja rajonale e Rrafshit të Dukagjinit dhe komunat e përfshira në studim

Tabela 18: Popullsia sipas grup moshave në komunën e Prizrenit

Tabela 19: Punësimi në bujqësi në komunën e Prizrenit

Tabela 20: Papunësia e regjistruar sipas gjinisë në Prizren

Tabela 21: Kualifikimi i të papunëve sipas gjinisë dhe kualifikimit në Prizren

Tabela 22: Klasifikimi i tokës bujqësore

Tabela 23: Struktura e shfrytëzimit të tokës bujqësore në rajonin e Prizrenit

Tabela 24: Sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimi në vitin 2013 komuna e Prizrenit

Tabela 25: Niveli arsimit të punonjësve ne fermë komuna Prizren

Tabela 26: Kultivimi i drithërave në rajonin e Prizrenit

Tabela 27: Situata e ujitjes në këtë rajon

Tabela 28: Ekonomitë Bujqësore sipas statusit ligjor, sipas komunave, Kosovë, 2014

Tabela 29: Struktura e kultivimit të pemëve në rajonin e Gjakovës

Tabela 30: Situata e punësimit në komunën e Pejës

Tabela 31: Struktura e shfrytëzimit të tokës në rajonin e Pejës në ha

Tabela 32: Struktura e shfrytëzimit të tokës në komunën Pejës

Tabela 33: Paraqitja e strukturës së tokës sipas aktiviteteve në komunën e Pejës

Tabela 34: Sipërfaqet e mbjella dhe prodhimtaria mesatare vjetore

Tabela 35: Sipërfaqja e ujitur për kulturat kryesore

Tabela 36: Sipërfaqja e ujitur për kulturat kryesor në rajonin e Pejës

Tabela 37: Variablat kryesore në FADN sipas rajoneve në euro/fermë

Tabela 38: Koeficientet e Outputit Standard për Kosovë

Tabela 39: Kufiri i SO në disa vende të BE-së (000 €)

Tabela 40 : Përmbajtja e pyetësorit, fermeri

Tabela 41 : Përmbajtja e pyetësorit, ferma

Tabela 42: Efektiviteti ekonomik i fermave bujqësore

Tabela 43: Treguesit e fermës në tre rajonet e studiuara

Tabela 44: Kufijtë e ulët dhe të lartë të përfshirë në rrjetin e FADN-së

Tabela 45 : Struktura e metodologjisë së studimit

Tabela 46: Parcelizimi i tokës në rajonin e Pejës

Tabela 47: Parcelizimi i tokës në rajonin e Prizrenit

Tabela 48: Parcelizimi i tokës në rajonin e Gjakovës

Tabela 49: Vlera e prodhimit në tre rajonet

Tabela 50: Të ardhurat neto/NjPV

Tabela 51: Të ardhurat neto/NjPV

Tabela 52: Të ardhurat neto/NjPV

Tabela e hulumtimit në rajonin e Pejës

Tabela e hulumtimit në rajonin e Prizrenit

Tabela e hulumtimit në rajonin e Gjakovës

Lista e grafikoneve

Grafiku 1: Importi i mallrave në Kosovë

Grafiku 2: Eksporti i mallrave në Kosovë

Grafiku 3: Struktura e tokës në Ekonomitë Bujqësore, Kosovë, 2014

Grafiku 4: Struktura e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore në Ekonomitë Bujqësore, Kosovë, 2014

Grafiku 5: Paraqitja në % e fermave bujqësore

Grafiku 6: Numri i fermave bujqësore në % ndaj totalit

Grafiku 7: Paraqitja në % e fermave blegtorale

Grafiku 8: Numri i fermave blegtoriale në % ndaj totalit

Grafiku 9: Punësimi në bujqësi në komunën e Prizrenit

Grafiku 10: Papunësia e regjistruar sipas grup moshave në Prizren

Grafiku 11: % e të papunëve sipas gjinisë dhe kualifikimit

Grafiku 12: Sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimi në vitin 2013, komuna e Prizrenit

Grafiku 13: Niveli arsimit të punonjësve në fermë komunën e Prizrenit

Grafiku 14: Kultivimi i drithërave në rajonin e Prizrenit

Grafiku 15: Kultivimi i perimeve në rajonin e Prizrenit

Grafiku 16: Përshkrimi i gjendjes së pemëtarisë në rajonin e Prizrenit

Grafiku 17: Përshkrimi i gjendjes së pemëtarisë në komunat e rajonit të Prizrenit

Grafiku 18: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunat e rajonit të Prizrenit

Grafiku 19 : Sipërfaqja e kultivimit të pemëve në ha në komunën Gjakovës

Grafiku 20: Kultivimi i perimeve në rajonin e Gjakovës

Grafiku 21: Kultivimi i drithërave në rajonin e Gjakovës

Grafiku 22: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Deçanit

Grafiku 23: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Gjakovës

Grafiku 24: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Junikut

Grafiku 25: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Rahovecit

Grafiku 26: Struktura e shfrytëzimit të tokës në rajonin e Pejës në ha

Grafiku 27: Numri i ekonomive bujqësore në rajonin e Pejës dhe sipërfaqja në ha

Grafiku 28: Struktura e shfrytëzimit të tokës në komunën Pejës

Grafiku 29: Paraqitja e strukturës së tokës sipas aktiviteteve në komunën e Pejës

Grafiku 30: Struktura e kultivimit të perimeve në komunën e Pejës

Grafiku 31: Struktura e kultivimit të pemëve në rajonin e Pejës

Grafiku 32: Plantacionet e pemëve në komunën e Pejës sipër/ha

Grafiku 33: Struktura e prodhimit për kulturat kryesore

Grafiku 34: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Pejës

Grafiku 35: Plantacionet e pemëve në komunën e Istogut sipër/ha

Grafiku 36: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Istogut

Grafiku 37: Struktura e kultivimit të pemëve në komunën e Klinës

Grafiku 38: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Klinës

Grafiku 39: Struktura familjare fermere në rajonin e Pejës

Grafiku 40: Struktura familjare fermere në rajonin e Prizrenit

Grafiku 41: Struktura familjare fermere në rajonin e Gjakovës

Grafiku 42: Niveli i arsimimit të fermerëve në rajonin e Pejës

Grafiku 43: Niveli i arsimimit të fermerëve në rajonin e Prizrenit

Grafiku 44: Niveli i arsimimit të fermerëve në rajonin e Gjakovës

Grafiku 45: Krahu i punës në fermë – Pejë

Grafiku 46: Krahu i punës në fermë – Gjakovë

Grafiku 47: Krahu i punës në fermë – Prizren

Grafiku 48: Llojet e punës në fermë në rajonin e Pejës

Grafiku 49: Llojet e punës në fermë në rajonin e Prizrenit

Grafiku 50: Llojet e punës në fermë në rajonin e Gjakovës

Grafiku 51: Angazhimi i anëtarëve të familjes dhe lloji i punës në fermë në rajonin e Pejës

Grafiku 52: Angazhimi i anëtarëve të familjes dhe lloji i punës në fermë në rajonin e Prizrenit

Grafiku 53: Angazhimi i anëtarëve të familjes dhe lloji i punës në fermë në rajonin e Gjakovës

Grafiku 54: Struktura e fermës në rajonin e Pejës

Grafiku 55: Struktura e fermës në rajonin e Prizrenit

Grafiku 56: Struktura e fermës në rajonin e Gjakovës

Grafiku 57: Madhësia e fermave në zonat e marra në studim

Grafiku 58: Madhësia e fermave në rajonin e Pejës

Grafiku 59: Shpenzimet për plehra kimike

Grafiku 60: Shpenzimet për punimin e tokës

Grafiku 61: Të ardhurat neto në rajonin e Pejës

Grafiku 62: Të ardhurat neto në rajonin e Prizrenit

Grafiku 63: Të ardhurat neto në rajonin e Gjakovës

Grafiku 64: Të ardhurat neto / NJ.P.V

Lista e fotove dhe hartave

Fig 1. Struktura e tezës së doktoraturës

Foto 1: Pamje e bjeshkëve të Prizrenit

Harta 1: Harta administrative e Kosovës

Harta 2: Toka e shfrytëzuar në Kosovë sipas komunave (2014)

Harta 3: Shtrirja gjeografike e Rrafshit të Dukagjinit

Harta 4: Shtrirja gjeografike e komunës së Prizrenit

Harta 5: Plani zhvillimor komunal i Prizrenit

Harta 6: Rajonet gjeografike të Komunës së Prizrenit

Harta 7: Klasifikimi i tokës bujqësore

Harta 8: Pozita gjeografike e Suharekës

Harta 9: Shtrirja gjeografike e komunës së Dragashit

Harta 10: Struktura e tokës sipas bonitetit dhe shfrytëzimit në komunën e Malishevës

Harta 11: Harta e komunës së Malishevës

Harta 12: Shtrirja gjeografike e komunës së Gjakovës

Harta 13: Shtrirja gjeografike e komunës së Deçanit

Harta 14 :Shtrirja gjeografike e komunës së Pejës

Harta 15: Zonat e studimit

Harta 16: Rajoni i Pejës

Harta 17: Rajoni i Gjakovës

Harta 18: Rajoni i Prizrenit

KAPITULLI I

1.1 Hyrje

Në vendet me ekonomi të zhvilluar rëndësi e veçantë i kushtohet zhvillimit të secilës degë të saj veç e veç, e në këtë drejtim edhe të bujqësisë. Bujqësia si degë mjaft e rëndësishme e ekonomisë së çdo vendi, përveç që punëson numër të madh njerëzish si në punët e përditshme, ashtu edhe gjatë sezonit, dhe kështu shtohet numri i tyre varësisht nga prodhimi i cili duhet kultivuar dhe mbledhur.

Bujqësia në Kosovë është degë kryesore e ekonomisë, konsiderohet se 60% e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale, dhe ky sektor luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e mundësive të punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave për banorët që jetojnë në këto zona. Sektori i bujqësisë ballafaqohet me mungesën e studimeve në të gjithë fushat duke filluar nga tipet e fermave, madhësia e tyre, format strukturore dhe organizative, format e menaxhimit, efektiviteti ekonomik, etj. Mungesa e të dhënave në të gjithë sektorët e bujqësisë është mjaft e evidente, dhe kjo dukuri, i ka sjellë probleme dhe mungesa të shumta zhvillimit të bujqësisë si në prodhimtari, përpunim, planifikim dhe hartim të politikave bujqësore për zhvillimin e këtij sektori. Vlerësimi i tipeve të fermave dhe efektiviteti ekonomik në Kosovë paraqet një nevojë imediate dhe shumë të rëndësishme për Kosovën.

Pra, në një mjedis kompleks dhe të pastabilizuar problemet kryesore të zonave rurale mund ti përcaktojmë si më poshtë:

- Vazhdojnë të jenë zonat më pak të zhvilluara të vendit, ku aktivitetet ekonomike nuk janë në nivelin e duhur dhe niveli i të ardhurave dhe shërbimeve të popullsisë është akoma i ulët;

- Varfëria dhe pabarazia vazhdojnë të mbeten problem kryesor për këto zona, megjithëse jeton mesatarisht 64% e popullsisë dhe përfshin rreth 60% të territorit;
- Veprimtaritë ekonomike nuk janë orientuara ka tregu, investimet janë të ulëta;
- Fenomeni i braktisjes së shkollës është një nga problemet që haset në këto zona ;
- Eksodi i popullsisë drejt qyteteve po vazhdon të thellohet sidomos i rinisë duke mos parë perspektivë për ardhmen në këto rajone;
- Sipërfaqet e tokës bujqësore po zvogëlohen çdo ditë si pasojë e ndërrimit të paligjshëm të destinimit, pyjet në veçanti po degradojnë gjithnjë e më tepër si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të tyre;

Pra, siç mund ta shohim dhe nga elementet e trajtuar me sipër, kuptojmë se zonat rurale shfaqin karakteristika të veçanta të zhvillimit të tyre, dhe përmbledhin shërbime të rëndësishme ekonomike. Gjithashtu, popullsia e zonave rurale ndihet e pambështetur sa duhet për sa i përket perspektivave dhe mundësive të zhvillimit të mënyrave të qëndrueshme të jetesës.

Ndryshimet e mëdha, që po ndodhin sot në botën bashkëkohore, posaçërisht ato në fushën ekonomike dhe të teknologjisë informative, determinojnë nevojën që të kemi një qasje krejt tjetër në raport me bujqësinë si burim i punësimit të njerëzve por edhe i ushqimit të popullatës.

Në këtë disertacion objekt studimi janë fermat dhe ekonomitë bujqësore në Rrafshin e Dukagjinit - me vështrim të posaçëm në tipologjinë e fermave në rajonin i cili njihet si rajon bujqësor në Kosovë dhe konkurrueshmërinë e tyre në treg.

1.2. Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi është njohja dhe studimi i shumanshëm i çështjeve thelbësore dhe faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë kosovare e në rend të parë tipologjinë e fermave. Përmes metodave më bashkëkohore të hulumtimit siç është metoda CLUSTER kemi arritur që të përfitojmë rezultate, paraqitjen e të cilave do ta botojmë në një libër të lidhur dhe do ta dorëzojmë tek organet kompetente që merren me bujqësi, te fermerët, organizatat ndërkombëtare si dhe te studentët për nevoja të studimeve të mëtutjeshme.

Me këtë punim përveç përfundimit të shkollës doktorale kemi për qëllim të vendosim bazat e një forme të hulumtimit të fermave duke u bazuar në metodat më bashkëkohore të hulumtimit dhe anketimit.

Hulumtimet në këtë punim janë trajtuar dhe analizuar nga disa aspekte. Së pari analizimi i tyre është bërë në aspektin krahasues duke i krahasuar me vendet me bujqësi të zhvilluar, pastaj nga të dhënat e pyetësorëve dhe duke i paraqitur pastaj në tabela, grafikone dhe diagrame.

Qëllimi i këtij kërkimi shkencorë ka qenë analiza dhe përcaktimi i modelit të fermave bujqësore në Rrafshin e Dukagjinit në rajonin e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, faktorëve që mbështesin zhvillimin e fermave bujqësore, si një rrugë e qëndrueshme dhe afatgjatë në zhvillimin perspektivës të sistemeve të bujqësisë.

Kërkimi shkencor është fokusuar në analizimin e gjendjes ekzistuese të fermave, madhësinë, strukturën, drejtimin, efektivitetin ekonomik të tyre, tipet e menaxhimit të fermave bujqësore, problemeve me të cilat fermerët përballen, konkurrueshmërinë e tyre në ekonominë e tregut të lirë, si dhe ndikimin e politikave bujqësore në zhvillimin afatgjatë të fermave në Kosovë

1.3 Objektivat e studimit

Studimi ka këto objektiva:

Kjo doktoraturë do të analizojë karakteristikat kryesore të fermave bujqësore në Kosovë, tipologjinë e tyre, rolin e tyre në treg si dhe përmirësimin e mundshëm të efikasitetit të tyre.

Objektiva 1: Studimi do të analizojë në veçanti problematikat e fermave bujqësore dhe konkurrueshmërinë e tyre në treg kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit, me specifikisht, në rajonin e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit;

Objektiva 2: Studimi do të përcaktojë tipet e fermave më të përshtatshme për nga madhësia e tyre, tipologjia e prodhimit, lloji i punësimit dhe ndikimi i tyre në tregun rajonal dhe më gjerë;

Objektiva 3: Nëpërmjet studimit do të identifikojmë instrumentet e politikave bujqësore në mbështetje të fermave bujqësore familjare, duke rekomanduar përmirësimet e mundshme për të rritur efektivitetin ekonomik të fermave bujqësore në Kosovë;

1.4 Pyetjet kërkimore

- Cila është tipologjia e fermave bujqësore në Kosovë dhe në zonën e studimit që do të bëjë të mundur rritjen e efektivitetit të tyre me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në treg ?
- Cila është madhësia, tipologjia, lloji i punës dhe tregues të tjerë që bëjnë të mundur përcaktimin e tipologjisë së fermës më të përshtatshme për rajonin e marrë në studim aspektet pozitive dhe negative të funksionimit të këtyre tipave të fermave ?
- Cilat janë instrumentet e politikave që mbështesin fermat bujqësore familjare në

ndihmë të rritjes së efektivitetit ekonomik të tyre dhe mundësisë për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në treg ?

Argumenti ose hipoteza/t e punimit

Hipoteza 1: Konkurrueshmëria e fermave nuk varet vetëm nga madhësia e tyre por dhe nga disa tregues të tjerë, si numri i të punësuarve, të ardhurat neto të saj, apo të ardhurat për ditë pune;

Hipoteza 2: Tipi i fermave që ruan një nivel konkurrueshmërie më të lartë ndikon pozitivisht në efektivitetin e punës në fermë dhe në përmirësimin e të ardhurave të fermës familjare;

Hipoteza 3: Instrumentet e politikës bujqësore në mbështetje të fermave bujqësore në Kosovë perceptohen si të pamjaftueshme për rritjen e të ardhurave në nivel ferme;

1.5 Zgjedhja e metodës së studimit

Në Kosovë bujqësia është dega kryesore e ekonomisë, një nga sektorët bazë dhe me potencial shumë të madh, por që vitet e fundit po vuan pasojat e mungesës së një strategjie të paqartë dhe afatgjatë. Në këto kushte gjithnjë e më tepër po ndjehet nevoja e ristrukturimit dhe riorganizimit të fermave bujqësore për ti bërë ato të afta për të konkurruar me produkte cilësore brenda dhe jashtë Kosovës. Nga ana tjetër kërkohet të valorizohet efektshmëria e ditës së punës së fermerit kosovar nëpërmjet rritjes së të ardhurave mesatare për dite pune. Kjo nënkupton që një fermë të konsiderohet ekonomikisht e qëndrueshme jo domosdoshmërisht duhet të disponojë vlerë të lartë asetesh apo të ardhurash, pasi mund të ketë një vlerë më të ulët të ditës së punës. Pra, problemet që kanë të bëjnë me përmirësimin e përdorimit të kapaciteteve prodhuese, si një alternativë nxitëse për shtimin e prodhimit dhe rritjen e të ardhurave nga ferma, si dhe shpejtimin e ritmeve të rritjes dhe zhvillimit të bujqësisë në funksion të rritjes së të

ardhurave rurale aktualisht përbëjnë një domosdoshmëri. Nisur nga ato që thamë më sipër puna jonë do të lidhet me zgjedhjen e një metodologjie analitike e cila është e lidhur me objektivat e kërkimit, ku qëllimi i saj është verifikimi i hipotezave të studimit.

Hulumtimi i literaturës ekzistuese jo vetëm për Kosovën e rajonet e studimit, por dhe të teorive për karakteristikat e fermave bujqësore na drejtuan në përcaktimin e një modeli të qëndrueshëm statistikor dhe sinjifikativ. Për rastin tonë metoda më e përshtatshme u konsiderua klasterifikimi. Zgjedhja e fermave të anketuara u mbështet tek metoda e Rrjetit të Kontabilitetit në Fermë (FADN), i cili është një instrument i përdorur nga BE për vlerësimin e të ardhurave të fermave bujqësore. Nëpërmjet kësaj metode u morën në analizë vetëm ato ferma që kanë një vlerë ekonomike dhe që si pasojë mund të konsiderohen si komerciale. E gjithë analiza na ndihmoi për krijimin e klasterave të cilët përbëjnë një zgjidhje të mirë për identifikimin e tipeve të fermave që do të ndikojnë për rritjen e konkurrueshmërisë së tyre afatgjate brenda sektorit bujqësor.

1.6 Struktura e studimit

Për të realizuar këtë studim, punën tonë e kemi ndarë në pesë kapituj kryesorë të cilat po i citojmë si më poshtë vijon:

Kapitulli i parë shërben si pikënisje e studimit nëpërmjet analizës së problematikës, ngritjes së pyetjeve të kërkimit dhe të hipotezave të studimit. Fusha e studimit tonë do të lidhet me identifikimin e tipeve të fermave në Kosovë, dhe se cilat tipe kanë një ndikim pozitiv në qëndrueshmërinë ekonomike të komuniteteve rurale. Gjithashtu në këtë kapitull do të bëhet edhe analiza e përgjithshme e realitetit kosovar ku do të japim një panoramë të përgjithshme të situatës ekonomike dhe bujqësore të Kosovës. Njëkohësisht do të analizojmë evolucionin e të gjithë sektorit bujqësorë, si dhe

problemet kryesore të cilat ndikojnë në zhvillimin e zonave rurale në vend. Një rëndësi të veçantë në këtë pjesë do të zërë dhe strategjia ndërsektorale e zhvillimit rural 2007-2013, si dhe ajo 2014-2020, si elemente të rëndësishme në drejtim të politikave bujqësore e rurale që po adaptohen sot në Kosovë.

Kapitulli i dytë do të na çojë në kërkim të një teorie për të mbështetur analizën tonë për të realizuar një tipologji të fermave bujqësore. Në këtë kapitull jemi mbështetur në shumë autorë që kanë studiuar tipet e fermave bujqësore, kryesisht në Azi dhe në dhjetëra vende të tjera në zhvillim. Tipologjitë e përcaktuara prej këtyre autorëve afrohen me karakteristikat e realitetit kosovar. Gjithashtu në këtë kapitull është bërë dhe një analizë e detajizuar e karakteristikave të fermës në vendet e rajonit. Kosova ka karakteristika të ngjashme me to si nga pikëpamja e madhësisë së fermave por dhe për sa i përket kulturave bujqësore që mbjellin.

Në kapitullin e tretë kemi analizuar karakteristikat e fermave në Kosovë dhe në rajonet e studimit. Analiza është mbështetur mbi bazën e hulumtimeve ekzistuese (raporte, studime, artikuj shkencorë e divulgativ, monografi) dhe mbi bazën e të dhënave statistikore të publikuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Instituti i Statistikave të Kosovës. Kjo analizë ishte e nevojshme pasi na bëri të analizonim situatën se ku do të mbështetej studimi ynë në tërësi.

Në kapitullin e katërt do të analizojmë metodologjinë e kërkimit. Fillimisht në këtë pjesë do të analizojmë arsyet se pse kemi zgjedhur rajonet e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit si pjesë e hulumtimit tonë. Pjesa e parë e metodës së punës do të lidhet me analizimin e pyetësorit të përdorur (të dhënat parësore) të cilat do të na ndihmojnë në identifikimin tipeve të fermave. Përzgjedhja e mostrës është mbështetur në metodën e FADN-së. Pjesa e dytë e metodës së punës do të lidhet me analizën që do të përdorim për të identifikuar tipologjinë e fermave e cila në bazë të literaturës së studiuar do të jetë


analiza Klaster.

Kapitulli i pestë lidhet në analizën e zonës së studimit. Analiza do të mbështetet në shpjegimin e tipeve të fermave në zonën e studimit me qëllim identifikimin e tipeve të fermave që do ti rezistojnë kohës dhe që do të luajnë rol në arritjen e qëndrueshmërisë së zonës dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë lokale.

Në fund do të jepen konkluzionet dhe rekomandimet të cilat janë jo vetëm një reflektim mbi situatën aktuale të zonës, por japin dhe zgjidhje për qëndrueshmërinë e fermave dhe mundësitë e daljes në treg në afatin e gjatë kohor.

Fig 1. Struktura e studimit doktoral

Figura 1.Struktura e tezes se doktoratures



1.7. Kufizimet e studimit

Kufizime, pengesa dhe drejtime të kërkimit në të ardhmen

1. Një studim shpesh përfaqëson një gur në një mur të madh dhe sigurisht është i limituar vetëm në fokusin e tij duke mënjeluar në këtë mënyrë dhënien e përgjigjeve të shumë pyetjeve të tjera me interes. Këto kufizime mund të jenë një potencial për kërkime të mëtejshme që mund të plotësojnë gjetjet e këtij studimi "Si çdo studim, edhe ky punim ka kufizimet e veta:
2. Studimi është realizuar në nivel ferme komerciale në Rrafshin e Dukagjinit në rajonin e Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës, mirë do të ishte një shtrirje në të gjithë Kosovën, sepse kjo mund të mos reflektojë në tipologjinë dhe efektivitetin ekonomik të fermave bujqësore në rajonet tjera të Kosovës.
3. Nisur nga fakti që shumica e fermave në Kosovë i takojnë sektorit joformal dhe ne nuk kemi përfshirë ferma informale kjo do të thotë se popullimi i marrë në studim nuk është përfaqësues i tërë fermave që operojnë në rajonet e marra në studim, ky përbën një kufizim tjetër të këtij studimi.
4. Studimet e ardhshme në këtë fushë duhet të kenë parasysh këto kufizime, mangësi, në mënyrë që të përmirësohen rezultatet e këtij punimi.
5. Përdorimi i pyetësorit për grumbullimin e informatave shpesh ka edhe kufizime, sepse direkt varet edhe nga sinqeriteti i palëve të intervistuar, duke u nisur nga fakti që kemi të bëjmë me fermer të cilit në shumicën e rasteve nuk mbajnë shënime lidhur me të hyrat dhe shpenzimet në fermë edhe kjo lenë për të dëshiruar.

KAPITULLI II

2. RISHIKIMI I LITERATURËS DHE TIPOLOGJIA E FERMËS NË KOSOVË DHE RAJON

2.1 Karakteristikat e fermave bujqësore

Zhvillimi i aktiviteteve bujqësore që nga fillimi deri tek implementimi në fushat e fermerëve, pashmangshëm dëmtojnë resurset e disponueshme natyrore dhe ambientin. Mirëpo, transformimi i tyre varet shumë nga lloji i aktiviteteve bujqësore si dhe i përdorimit të sistemit apo modelit të prodhimit bujqësorë. Fermerët vazhdimisht duhet të bëjnë zgjedhje se çka të prodhojnë, si të prodhojnë dhe kur të prodhojnë. Vendimet që fermerët marrin varen shumë nga faktorët ekonomikë natyrorë dhe kulturorë. Përveç faktorëve të sipër cekur, vendimi i fermerëve në përcaktimin e sistemit të prodhimit varet edhe nga kushtet politiko/ekonomike, dhe karakteristikat e ekonomive familjare. Kapaciteti i shtrirjes së shërbimeve si dhe qasja në teknologjitë e reja përmes hulumtimeve janë gjithashtu faktorë që influencojnë vendimet e fermerëve në modelimin e fermës. Duke ditur që këta faktorë nuk janë gjithmonë stabil dhe në mënyrë të vazhdueshme ndryshojnë me kalimin e kohës, sistemi, organizimi dhe metodat e prodhimit bujqësorë do të demonstrojnë gjithashtu ndryshime të vazhdueshme.

Vendi ynë karakterizohet nga një larmi zonash dhe mikrozonash të përshtatshme për zhvillimin dinamik të bujqësisë dhe blegtorisë. Kjo bënë të nevojshme që ne sot të flasim pa frikë për drejtimin dhe strukturimin e sektorit të bujqësisë mbi baza të reja të klasifikimit dhe menaxhimit të fermës. Janë realizuar një numër i madh strategjish e studimesh të pjesshme për zhvillimin e bujqësisë, por nuk është studiuar struktura

madhësia e fermave, sistemi i menaxhimit dhe tipologjia e fermave, e cila është baza e zhvillimit të bujqësisë në Kosovë. Menaxhimi i deri tanishëm i fermave bujqësore është mbështetur në mënyrën tradicionale të menaxhimit, e diktuar kjo nga madhësia e vogël e fermës, prodhimi i pakët kryesisht për vet familjen, dhe shume pak për treg, mungesa e politikave dhe mekanizmave ekonomike të përshtatshme për të realizuar strategjitë e hartuara për zhvillimin e bujqësisë në kushtet e burimeve të kufizuara (natyrore, fizike e njerëzore), dhe kërkesës për të ruajtur ambientin.

Nga analiza e bërë mbështetur në raportet vjetore statistikore del se :

- Fermat karakterizohen nga një mozaik kulturash bujqësore dhe nga lloje të shumta të gjësë së gjallë që me një strukturim dhe menaxhim më të mirë në të ardhmen do të arrijmë në reduktimin e llojshmërisë dhe do të mundësoj specializimin e fermave për një qëllim të caktuar;
- Tradita, është e lidhur me eksperiencën e fituar nga fermeri gjatë punës në fermat shtetërore dhe në kooperativat bujqësore, në kultivimin e kulturave bujqësore dhe në mbarështimin e blegtorisë;
- Me prodhimet e fermës, fermeri siguron nevojat e familjes së tij dhe shumë pak teprica nxjerr në treg;
- Fermeri kultivon ato bimë që prodhimet e tyre janë për treg me qëllim për të siguruar të ardhura kryesisht për nevojat e familjes, me të cilat blen ato impute e shërbime që nuk realizohen në fermë;
- Fermeri nuk ka informacion për format e reja të menaxhimit të cilat bëjnë të mundur optimizimin e rezultateve të fermës në kushtet e burimeve të kufizuara;
- Shqetësues është qëndrimi dhe aktiviteti i fermerit në raport me ambientin në përgjithësi dhe tokën në veçanti, që është burimi bazë mbi të cilin zhvillohen të gjitha aktivitetet e fermës;

Janë kryesisht këto arsye, por edhe të tjera të evidentuara gjatë punës për të ndërmarrë këtë studim që na bëjnë të mbështesim konceptin se tipologjia tradicionale e fermës i takon të "**kaluarës**". Nga autorë të ndryshëm ka qenë i definuar (Dillon 1980, p. 258)¹, si "proces me të cilin burimet dhe situata janë të manipuluar nga menaxheri i fermës (fermeri), që duke u përpjekur, me më pak informacion dhe burime, të përmbushi qëllimet e tij ose të saj ". Shih gjithashtu Makeham dhe Malcolm (1986, Ch. 2) dhe Upton (1973, Ch. 1).

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është të analizojë karakteristikat kryesore të sistemeve bujqësore në Kosovë në nivel ferme, të tipologjisë së tyre dhe rolin e tyre aktual dhe potencial në sigurimin e ushqimit në kushtet e burimeve të kufizuara. Prandaj fokusi do të vendoset mbi perspektivat dhe sfidat e bujqësisë kosovare duke analizuar aspekte të veçanta të sistemit bujqësor, dhe në mënyrë të veçantë tipologjinë e fermave familjare për të përcaktuar tipin e fermës me efektivitet më të lartë ekonomik për kushtet e Kosovës, me synim për të prodhuar ushqim të mjaftueshëm dhe të sigurt dhe në pajtueshmëri me ambientin si dhe për të patur një menaxhimi të integruar të fermës.

Kontributi kryesor i studimit do të jetë analiza e tipologjisë së fermave bujqësore në Kosovë dhe qëndrueshmëria e tyre për të nxjerrë në pah tipologjinë më efikase në drejtim të tokës, punës, produktivitetit dhe të kapitalit. Studimi do të paraqes analizën e tipeve të fermave, qëndrueshmërinë e tyre në aspektin e prodhimit për plotësimin e nevojave të familjes dhe për treg.

¹ Farm Management Research for small Farmer Development

2.2 Klasifikimi i tipeve të fermave sipas literaturës²

Në kushtet e sotme, zhvillimi i bujqësisë po merr vlersimin e duhur nga fermerët të cilët e shikojnë zhvillimin e bujqësisë si një shtysë në rritjen e të ardhurave, në sigurimin e ushqimeve dhe në rritjen e pandërprerë të mirëqenies së tyre. Pronësia mbi tokën ka bërë që në shkallë vendi të kemi një zhvillim të shpejtë në të gjithë sektorët e bujqësisë.

Nga literatura fermat klasifikohen në gjashtë lloje themelore të fermave që janë:

Lloji 1. Të mbijetesës të përfaqësuar nga fermat e vogla familjare;

Lloji 2. Fermat e vogla familjare gjysmë-mbijetesë, ose me pjesë të vogël (tepricë) për treg, zakonisht kanë nga një deri në dy hektarë tokë , por sipërfaqja e tokës nuk është një kriter i mirë për të karakterizuar llojin e fermës, sepse duhet të konsiderohen edhe treguesit e tjerë të strukturës;

Lloji 3. Fermat e vogla familjare të pavarura e të pa specializuara, këto prodhojnë edhe për treg një shumëllojshmëri prodhimesh e thënë ndryshe pak nga të gjitha;

Lloji 4. Fermat e vogla familjare të specializuara, shpesh me familjen si qiramarrëse të tokës dhe prodhojnë një numër të kufizuar produktesh, shpesh shfrytëzojnë avantazhet e sezonit;

Lloji 5. Fermat e mëdha familjare komerciale, zakonisht të specializuara dhe operohet përgjatë linjave të modifikuara, kanë të punësuar specialist;

Lloji 6. Fermat komerciale, zakonisht mono-kulturë dhe menaxhimi bëhet me staf teknik të punësuar;

Deri më sot, fermat janë më shpesh të klasifikuara në bazë të faktorëve agro-ekologjik (si klima, toka, shpat, lartësi dhe, jo nuk kanë lidhje me këta faktorë, sistemet e kulturës dhe bagëtitë e shfrytëzuara), në një masë më të vogël, me kriteret socio-

² Farm Management Research for small Farmer Development

ekonomike (Fresco dhe Westphal 1988). Në mënyrë të pashmangshme kjo qasje çon në një bollëk të llojeve të fermave. Theksi është në strukturën e fermës, të sistemit të menaxhim të saj dhe perspektiva e fermës bujqësore familjare me klasifikimin e bazuar në: (1) qëllimin kryesor të fermës, (2) shkallën e saj të pavarësisë dhe (3) "madhësinë" e saj. Nga një këndvështrim i tillë strukturor janë gjashtë lloje kryesore të tipit të fermës të gjetur në Azi dhe në dhjetëra vendet në zhvillim.

2.2.1 Llojet e Fermave sipas WAW

Në ekonominë bujqësore të Kosovës gjenden të gjashtë tipet e fermave të përshkruara me poshtë sipas Word Agricultural Watch (WAW).

2.2.1.1 Lloji (tipe) 1: mbijetesë-orientuar te fermat e vogla familjare

Ka dy nëntipe kryesore. Së pari, dhe të një rëndësie më të vogël numerike, janë ato të bazuara në vetëm një ose dy kultura, ose llojet e bagëtive (p.sh. në grurë dhe perime, ose në dhen e dhi). Disa ferma të këtij nëntipi janë të bazuara më shumë në shfrytëzimin apo menaxhimin e burimeve natyrore lokale se sa për zgjedhjen e qëllimshme të tyre si aktivitet kryesor të fermës. Megjithatë, grupi kryesor i fermave aziatike të mbijetesës është i orientuar në një gamë të gjerë të kulturave dhe të llojeve të kafshëve. Nëntipi i dytë është domosdoshmërisht më shumë i përzier se sa nëntipi i parë.

Fermat që janë krejtësisht të vetë-mjaftueshme janë të rralla, sepse fermat e këtij lloji mund të ekzistojë në izolim nga bota e jashtme. Struktura e një ferme e tipit 1, në qendër për vlerësimin e saj është familja dhe jo komponenti i sistemit të fermës. Megjithatë, Tipi 1 i fermave kanë shumicën e karakteristikave të tipit 2 të fermave dhe këto kanë shumë pika për të diskutuar në lidhje midis tyre.

2.2.1.2 Lloji (tipi) 2 : Janë ferma të vogla bujqësore që shesin tepricat në treg ose të quajtura gjysmë-ekzistenciale ose pjesë-komerciale Ky lloj është mbizotërues në të

gjithë Azinë e Jugut dhe Azinë Jug-Lindore në aspektin e numrit të njësive të tilla, numri i madh i njerëzve të mbështetur prej tyre dhe të vëllimit të përgjithshëm të prodhimit të tyre, sidomos të ushqimeve bazë.

Po ndalemi te tipi 2 i fermave bujqësore sepse janë pikërisht këto që përbëjnë rreth 60% të fermave bujqësore në Kosovë. Objektivi i përgjithshëm operativ i këtij lloji është furnizimi i familjes me ushqim për konsum dhe materialeve për përdorim në fermë, dhe e dyta sigurimi i të ardhurave në të holla për blerjen e ushqimeve që nuk prodhohen në fermë, plehra, pesticide, shkollim, argëtim etj.

2.2.1.2.1 Aktivitetet e prodhimit: Tipi 2 i fermave mund të klasifikohen më tej në përputhje me ndodhjen gjeografike. Fermat janë të integruara ngushtë me aktivitetet tradicionale të zonës, kanë prioritet kryesor sigurimin e mirëqenies së familjes. Ky tip ferme ka lidhje të pakta me botën jashtë. Në kontrast me fermat në vendet e zhvilluara, kanë lidhje më të forta dhe ndërvarësitë me fermat e tjera në komunitetin lokal se sa me botën e jashtme, pra me furnizuesit komercial të inputeve dhe tregje për prodhimet e tyre. Në këtë tip ferme mungojnë praktika të tilla si shkëmbim të shërbimeve të punës, të zhvillimit të infrastrukturës të ujitjes, rrugëve, fshatrave, shkëmbim të prodhimeve, inputeve etj, secila njësi fermë-familje është një lidhje në një rrjet **agro-socio-ekonomik**, shpesh i zhvilluar shumë brenda komunitetit lokal. Çdo tip 2 i fermës është më shumë një pjesë e komunitetit dhe shpesh nuk mund të funksionojë në mënyrë efektive në qoftë se divorcohet prej tij. Ajo mund edhe të thuhet se "një fermë e tillë është një ishull në vetvete."

2.2.1.2.2 Aktiviteti dhe diversiteti produkt: Diversiteti i tipit 2 të fermave ka tre elemente: numrin e kufizuar të aktiviteteve të kulturave bujqësore / blegtorale të pranishëm; numri i produkteve të marra nga këto aktivitete, dhe numri i mënyrave në të cilat çdo produkt mund të përdoret apo të konsumohet. Fermat e përziera zakonisht

përbëhen nga katër deri në gjashtë aktivitete bujqësore dhe dy deri në tre aktivitete blegtorale; dhe që secili mund të ketë deri në katër mënyra të ndryshme përdorimi (shitur / blerë, konsumuar, përpunuara, ruajtur).

2.2.1.2.3 Burimet dhe përdorimet e burimeve të fermës: Një karakteristikë e rëndësishme e tipit 2 të fermave (dhe të fermave të tipit 1) është përqindja e lartë e produkteve bujqësore të prodhuara në fermë nga burimet e vet fermës familjare dhe nga kjo buron, përkatësisht, niveli i ulët i vartësisë nga inputet e blera. Kur këto ferma përdorin inpute të blera, shpesh veprojnë në nivele të dyfishta të teknologjisë - "përparuar" për disa kultura kryesore dhe "tradicional" për pjesën tjetër.

Aktivitetet e fermës që gjenerojnë mjete monetare, janë relativisht të rëndësishme në fermat e tipeve 1, 2 dhe 3, shembulli më i zakonshëm është bagëtia e mbajtur kryesisht për prodhimin e plehut (si dhe për qëllime të tjera), rritja e një kulture të gjelbër që i shërben një qëllimi të ngjashëm ose aktiviteti më i zakonshëm "burimeve gjeneruese" është thjesht rritja e një peme në shtëpi-oborr (për material ndërtimor, gardh, transport uji etj). Nëpërmjet ndarjes së thjeshtë të një pjese të prodhimit nga përdorimi familjar për treg ose ushqim të blegtorisë.

Së pari ushtrimi i një shumëllojshmërie aktiviteteve bujqësore e blegtorale për tregun dhe për përdorimin e vet të familjes, në mënyrë tipike, mund të jetë i mangët por do të gjenerojë të holla për familjen fermere.

Së dyti mund të jetë i aftë për ruajtje të cilësive të tjera të vlefshme në zonat rurale, por jo në tregjet e sofistikuara urbane.

Së fundi në fermat e tipit 1 dhe 2, kapitali i krijuar në fermë siguron nivel të lartë të vetë-mjaftueshmërisë që karakterizon këto lloje fermash, sidomos në vendet në zhvillim.

2.2.1.3. Lloji (Tipi 3): Fermat e vogla të pavarura të specializuara familjare

Karakteristikat kryesore të tipit 3 janë: (a) specializimi i tyre në një kulturë apo blegtori, aktivitet të veçantë të cilat i dallojnë ato nga fermat e përziera të tipit 1 dhe 2 dhe (b) pavarësia e tyre e menaxhimit që i dallon ata nga tipi 4 i fermave.

Në vendin tonë gjenden të gjashtë llojet e fermave që përshkruhen në literaturë por nga informacioni që ne kemi grumbulluar për realizimin e këtij studimi dominues në Kosovë është **lloji 2 i fermave**. Në literaturë rekomandohet që këto lloje të fermave (lloji i 2-të) duhet të kenë një strukturë mikse (të përzier).

Objektivi i përgjithshëm i këtij lloji ferme është furnizimi i familjes, së pari prodhimi i ushqimit për konsum, së dyti për të siguruar pak të ardhura në të holla që do të përdoren për të blerë (a) produkte ushqimore të domosdoshme që nuk prodhohen në fermë kripë, çaj etj; (b) të domosdoshme të tjera të tilla si veshje, ilaçe, radio, televizor etj, (c) inpute për prodhimin në fermë si pesticide, plehra etj; dhe (d) argëtim si pushime, udhëtime etj. Të hollat për këto janë siguruar kryesisht nga shitja e produkteve, pasi janë plotësuar nevojat e familjes.

Sipas Regjistrimit të Bujqësisë Botërore (Word Agricultural Watch WAW 2012)³ për të kuptuar karakteristikat e fermave bujqësore dhe për të bërë krahasimet aktuale duhet të mbështetemi në tre treguesit specifik të përzgjedhur nga korniza metodologjike që janë:

- Sipas llojit të punës në fermë nëse ajo është bërë nga familja apo nga puna me pagesë;
- Sipas statusit të menaxhimit të fermës, nëse nga familja (kryefamiljari) apo nga specialist me pagesë;

³ Word Agricultural Watch, 2012

- Sipas statusit të pronës, nëse toka është pronë e familjes fermere apo e marrë me qira;

Nëse do të dispononim informacionin e nevojshëm do ti gruponim fermat bujqësore në tre grupimet, e cila do të na jepte një pasqyrim të përgjithshëm, por kjo do të ishte e pa mjaftueshme sepse nuk merr në konsideratë tregues të tjerë si madhësinë e sipërfaqes së tokës, strukturën e aktivitetit, prodhimit, shpenzimet dhe të ardhurat e prodhimit, teknologjinë e përdorur etj. (Tittonell et al 2006)⁴. Efikasitetin e përdorimit të burimeve (Zingore 2007;. Tittonell et al 2007⁵), efikasitetin e përdorimit të ujit (Senthilkumar et al 2009⁶), ose klasifikimin e përgjithshëm e llojeve të fermave (Bidogeza et al 2009⁷). Pra shumica e studimeve të tipologjisë së fermave është fokusuar në faktorët socio-ekonomikë dhe agro-ekologjikë për klasifikimin e fermave.

Fermat në Kosovë janë të vogla dhe mjaft të fragmentuara, modeli teorik sa i përket tipologjisë së fermave, bazuar në literaturë është i ngjashëm kryesisht në ferma-familjare në vendet aziatike studiuar nga autorët J.L. Dillon dhe J.B Hardakar⁸, dhe një seri librash e studimesh mbi zhvillimin e menaxhimit të fermave të vogla, ku përcaktohet që klasifikimi i tipologjisë së fermave është shumë kompleks, por këndvështrimi është sipas qëllimit që do të realizosh.

Për klasifikimin e fermave dhe identifikimin e llojeve të fermave (USDA, ERS 2000⁹; Briggeman et al 2007;. Andersen 2009¹⁰) supozon se klasifikimi i fermave duhet bazuar në kthimet ekonomike nga ndërmarrjet bujqësore, së bashku me faktorë të tjerë që lidhen me faktor jo-ekonomik.

⁴ Tittonell et al 2006.),

⁵ Zingore 2007;. Tittonell et al 2007

⁶ Senthilkumar et al 2009

⁷ Bidogeza et al 2009

⁸ Farm Management Research for small Farmer Development

⁹ USDA, ERS 2000

¹⁰ Briggeman et al 2007;. Andersen 2009

Për sa i përket selektimit të tipit të fermave sipas (Jouve, 1986)¹¹, tipologjitë e fermave ndahen në dy grupe të ndryshme sipas 1. Strukturës (analiza e organizatës) dhe 2. Funksionit (analiza e procedurave teknike). Kriteret e ndarjes së fermave duhet të kenë vlerë të ndryshme në popullacion, kriteret të cilat kanë vlerë të njëjtë nuk janë të përshtatshme që të përdoren si kritere për ndarje (segmentim të fermave) pra kanë korrelacion të ulët në mes veti dhe lehtë të grumbullohen.

Tipologjia e fermës në një rajon të caktuar i referohet sistemeve të ndryshme bujqësore thotë Castel¹², ndërsa Bizotega¹³ thekson se "tipologjia përbën një hap thelbësor në çdo vlerësim realist të kufizimeve dhe mundësive që ekzistojnë brenda familjeve fermere".

Tipologjia "është një metodë efikase për të përmbledhur diversitetin e sistemeve bujqësore dhe perceptuar për çdo zonë rurale" thekson Righi¹⁴. Për specifikimin e kriterëve të klasifikimit të fermave në ekonomi me të ardhura të ulëta Tittonell¹⁵ et al. 2010 ka përdorë kriteret më të detajuara për klasifikimin e fermave të vogla në Afrikën Lindore, madhësia e të cilave ferma është e njëjtë me madhësinë e fermave në Kosovë. Këto janë dhjetë kriteret të cilat ai ka përdorur:

- I. Madhësinë e fermave (sipërfaqja e përgjithshme e fermave, sipërfaqja e kultivuar).
- II. Sasia e prodhuar në fermë (të ardhurat €)
- III. Madhësia e familjes
- IV. Puna nga anëtarët e familjes
- V. Anëtarët e familjes të punësuar jashtë fermës
- VI. Teknologjia e përdorur (mekanizim, plehërim, ujitje)

¹¹ Jouve, 1986

¹² Castel et al. 21.010

¹³ Bizotega et al. 2007

¹⁴ Righi et al. 2011

¹⁵ Tittonell et al. 2010

- VII. Shpenzimet për prodhimin(\$)
- VIII. Orientimi prodhimit (% e prodhimit për treg)
- IX. Numri i përgjithshëm i ha/ krerë etj
- X. Mundësitë dhe potencialet për rritjen dhe zgjerimin e fermës

Kur flasim për identifikimin dhe përcaktimin e tipologjisë së fermave duhet të kemi parasysh se tipologjia e fermave ka ndikim direkt edhe në aplikimin e teknikave dhe teknologjisë së avancuar e cila ndikon drejtpërdrejt në rritjen e produktivitetit të fermës, dhe në bazë të literaturës së shtjelluar shihet se fermerët e vegjël të vendeve në zhvillim si në Kosovë kanë problem ti fusin në përdorim teknologjitë e avancuara. Shumë shpesh, këto teknologji nuk përshtaten mirë në sistemet e fermave të fragmentuara dhe heterogjene, të cilat kanë nevojë për zgjidhje specifike teknologjike. Ndryshueshmëri e tillë e natyrshme shpesh ndikon në reagimin e fermerëve në teknologjitë e ndryshme që synojnë përmirësimin e produktivitetit në fermë dhe në menaxhimin e burimeve natyrore (Lal et al 2001;. Emtage dhe Suh 2005).¹⁶

Autorë të ndryshëm kanë zhvilluar mënyrën dhe metodat e klasifikimit të tipologjive të fermave të vogla bujqësore, duke i parë ato në disa këndvështrime. Këto metoda do të përdoren në këtë studim për të bërë investigimin, diagnostikimin dhe ndërhyrjen për rritjen e efektivitetit të fermave në vendin tonë.

Do të studiojmë dhe analizojmë metodat ekzistuese të menaxhimit të fermave bujqësore nga autorë të ndryshëm në disa dekada në vende të ndryshme të ngjashme me vendin tonë jo vetëm nga lloji i fermave por edhe nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, mjedisor e gjeografik.

Do të studiohet gjendja ekzistuese e tipologjisë së fermave familjare nëpërmjet informacionit zyrtar, anketimeve, intervistave me pyetësorët me fermerë e specialistë të

¹⁶ Lal et al 2001. Emtage dhe Suh 2005

bujqësisë, për të marrë informacionin e nevojshëm për realizimin e studimit.

Do të përdorim me kujdes analizën e situatës nëpërmjet metodave të analizës ekonomike: funksionimi dhe kontrolli, studimi, kuptimi, përshkrimi, diagnoza, receta (zgjidhja) (Dixon et al 1994. Upton dhe Dikson 1994¹⁷), analizën krahasuese, përgjigjet e analizës, metodën e programimit, dhe të stimulimit, duke u mbështetur jo vetëm në përvojën e huaj të disa dekadave por edhe atë të vendit tonë në dy dekadat e fundit për aktivitetin e fermës në tërësi.

Për të realizuar objektivat e këtij studimi do të na duhet të bashkërendojmë analizën e informacionit teknik me atë ekonomik e social, si dhe të marrim në konsideratë shumë njohuri nga shkencat e tjera si bujqësia, ekonomia, sociologjia etj.

Aktiviteti bujqësor në Kosovë realizohet në fermat që karakterizohen nga një diversitet në madhësinë e tokës në përdorim, në modelet e prodhimit, në një shumëllojshmëri të madhësive të fermave, dhe me një shpërndarje të konsiderueshme gjeografike. Çdo përpjekje për planifikimin e prodhimit bujqësor synon të karakterizoj modelet e prodhimit të cilat kërkojnë një metodë të analizimit të të dhënave nëpërmjet teknikave ekonomike. Modelet e bazuara në të dhënat mesatare statistikore janë të kufizuara për shkak se ato paraqesin fermat që nuk ekzistojnë në realitet.

Ky studim zhvillon një metodologji për të karakterizuar fermat dhe pse ato kanë një diversitet të madh. Studiohen llojet e fermave sipas variablave bazë: përdorimin e tokës, klasave, të madhësisë dhe sistemet e prodhimit. Informacioni i përdorur në këtë studim është marrë kryesisht nga regjistrimi i bujqësisë 2014. Metodologjia e zhvilluar është mbështetur duke marrë informacion të rëndësishëm në lidhje me evoluimin e aktivitetit bujqësor nëpërmjet pyetësorëve për tre rajone të rëndësishme të Kosovës që janë: rajoni i Pejës, Gjakovës dhe i Prizrenit.

¹⁷ Dixon et al 1994;. Upton dhe Dikson 1994

Do të përcaktojmë se cilët faktorë luajnë rolin kyç në analizën e sistemit të fermave të vogla (ekzistenciale dhe gjysmë ekzistenciale), me një diversifikim të madh për sa i përket kushteve të prodhimit por edhe rezultateve, për ta afruar fermën familjare në një sistem të menaxhimit të integruar, i cili është i nevojshëm të kuptohet dhe provohet në të gjithë elementet e saj, përpara se të implementohet.

Do të mbështetemi kryesisht në fermat familjare që janë për vet konsum dhe gjysmë komerciale mbasi janë këto që dominojnë në vendin tonë. Nëpërmjet studimit do të mundemi të bëjmë klasifikimin e mundshëm të tyre në katër rinde që njihen nga literatura.

Një bazë e rëndësishme do të jetë literatura nga analiza që i është bërë fermave të vogla dhe kryesisht ferma- familje në vendet aziatike nga autorët J.L. Dillon dhe J.B Hardakar¹⁸, në një seri librash për studimin e zhvillimit të menaxhimit të fermave të vogla (Farm Management Research for small Farmer Development¹⁹).

Zgjedhja e faktorëve që përcaktojnë tipologjinë e fermave ndryshojnë shumë nga studimi në studim dhe zakonisht udhëhiqen nga qëllimet e hulumtimeve. Nga autorë të ndryshëm për shembull, për përcaktimin e tipologjisë së fermave është përdorur studimi i aplikimit të duhur të plehrave (Tittonell et al 2006²⁰), efikasiteti i përdorimit të burimeve (Zingore 2007: Tittonell et al. 2007²¹), efikasiteti i përdorimit të ujit (Senthilkumar et al. 2009²²), apo klasifikimi i përgjithshëm i llojeve të fermave (Bidogeza et al. 2009), IMM (Leeson et al. 1999²³), nganjëherë klasifikimi i tipologjisë së fermave bëhet specifik për kulturën që kultivohet në ato vende (Mwijage et al 2009 :

¹⁸ J.L. Dillon dhe J.B Hardakar

¹⁹ Farm Management Research for small Farmer Development

²⁰ Tittonell et al 2006

²¹ Zingore 2007: Tittonell et al. 2007

²² Senthilkumar et al. 2009

²³ Bidogeza et al. 2009), IMM (Leeson et al. 1999)

Reckling 2011²⁴).

Shumica e studimit të tipologjive të fermave janë fokusuar në faktorët socio-ekonomik dhe agro-ekologjik për klasifikimin e fermave, kurse studimi i faktorëve (variabla) ekonomik është përdorur më pak, ndërsa në hulumtim kemi përdorur edhe variabla socio-ekonomike dhe variabla ekonomike siç janë i) cilësinë e tokës, ii) kushtet socio-ekonomike, iii) Infrastrukturën iv) strukturën e prodhimit bujqësor, v) inputet në prodhimin bujqësor, vi) të ardhurat nga prodhimi dhe profitabilitetit, vii) indeksin e përfitimeve bujqësore. Përdorimi i variabla ekonomike për klasifikimin e fermave të vogla se bashku me variablat jo ekonomike na japin njohuri për klasifikim me efektiv të tipit të fermave (USDA, ERS 2000; Briggeman et al 2007; Andersen 2009²⁵).

Në hulumtim, identifikimi i rajoneve të ngjashme gjeografike në të cilat iniciativa të suksesshme të zhvillimit mund të zgjerohen, ndikojnë për të shfrytëzuar ekonominë e shkallës (Bidinger et al. 1994)²⁶. Qëllimi i studimit ka qenë që të analizohen fermat komerciale në mënyrë më të detajuar duke ndërtuar një tipologji të fermave që grupon ferma me karakteristika të ngjashme brenda grupit dhe që ka dallime të rëndësishme midis grupeve (Köbrich, Rehman et al 2003; Iraizoz, Gorton et al 2007)²⁷, dhe kjo u arrit me krijimin e tipologjisë së fermave në gjashtë grupime (klastera) të ndryshëm njëri prej tjetrit dhe të ngjashme brenda grupit. Gjatë hulumtimit kemi arrit në përfundimin se zhvillimi i bujqësisë në këto rajone mund të jetë instrumenti më i përshtatshëm për arritjen e reduktimit të qëndrueshëm të varfërisë në vend, përmes rritjes së të ardhurave të fermerëve, duke ofruar punësim për punë në bujqësi, duke u rritur pagesat për punë të kryer në bujqësi, dhe uljen e çmimeve të ushqimeve për zonat

²⁴ Mwijage et al 2009. Reckling 2011

²⁵ USDA, ERS 2000; Briggeman et al 2007; Andersen 2009

²⁶ Bidinger et al. 1994

²⁷ Köbrich, Rehman et al 2003; Iraizoz, Gorton et al 2007

e varfra urbane dhe rurale (Chaudhuri, 2003²⁸).

Gjatë shqyrtimit të hollësishëm të literaturës kemi hasur, që klasifikimi i tipologjisë së zonave agroekologjike në Indi rëndësi primare kanë pasur këto variabla si : shtrirja gjeografike, klima dhe toka, kurse tek ne duke pasur parasysh shtrirjen në Rrafshin e Dukagjinit në të njëjtin rrafsh nuk kanë pasur rëndësi primare në klasifikimin e sistemeve bujqësore këto variabla (Sehgal et al 1992; ARPU 1993; Goi 1989 dhe Scholz 1987.²⁹).

Për Rrafshin e Dukagjinit do të monitorohen dhe regjistrohen tregues të tillë si sipërfaqja e tokës bujqësore në dispozicion të aktivitetit bujqësor e blegtoral, mënyra e organizimit të mbjelljeve, qarkullimin bujqësorë të kulturave, përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve, punonjësit, personeli përgjegjës administrativ e teknik i fermave dhe niveli arsimor i tyre, mekanika bujqësore në përdorim, gjendja e infrastrukturës (stallave, impiante, shërbimeve, magazinave tregu etj).

Një vështrim pozitiv i zhvillimit të bujqësisë për të kontribuar në përmirësimin e sigurimit të ushqimit dhe të ardhurave për popullsinë e varfër nga fermat e vogla duke përdorur teknologjinë tradicionale dhe burimet ekzistuese.

Së pari, duhet të kuptojmë strukturën aktuale agro - ekonomike, natyrore dhe funksionimin e sistemit të fermave të vogla me qëllim që të asistohen ato për ndryshimet e mundshme.

Së dyti do të asistojmë në atë që: ky sistem i fermave të vogla dominues në vendin tonë duhet ti takojë të "kaluarës" t'i ndihmojë për të kaluar nga forma e tanishme e vetë mbajtjes në ferma gjysmë komerciale e komerciale. Ne vet jemi dëshmitarë që kjo nuk është një punë e lehtë për ti kaluar ato nga ferma familjare të mbijetesës në ferma që të prodhojnë edhe për treg. Për realizimin e këtij studimi do të përdoret një literaturë e

²⁸ Chaudhuri, 2003.

²⁹ Sehgal et al 1992; ARPU 1993; Goi 1989 dhe Scholz 1987

gjerë nga shumë autorë të huaj e vendas, do të asistohemi nga shumë aktor (institucione dhe specialist) për grumbullimin dhe përpunimin e informacionit, si dhe me kontakte dhe intervista direkte.

Pasi të studiohet gjendja ekzistuese e drejtimit dhe menaxhimit të fermave, do t'u bëhet i njohur fermerëve se çfarë përfaqëson ferma e tyre, problemet me të cilat fermeri përballet gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij, avantazhet dhe mënyrat e zgjidhjes që ofron ky sistem.

Analizimi i situatës nëpërmjet metodave të analizës ekonomike: funksionimi dhe kontrolli, studimi, kuptimi, përshkrimi, diagnoza, receta (zgjidhja).

Ndikimi ekonomik do të jetë i dukshëm në fermën që do të zbatojë këtë sistem menaxhimi, sepse të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat do të jenë të planifikuara që në fillim të vitit, plehurat kimike dhe pesticidet do të përdoren në mënyrë rreptësisht të kontrolluar, do të regjistrohen në mënyrë kronologjike dhe do të përdoren ato që janë absolutisht të domosdoshme.

2.3. Tipologjia e fermave në Kosovë dhe vendeve në rajon

Në Kosovë nuk ka ndonjë tipologji të fermave bujqësore përpos klasifikimit ekzistues të fermave në bazë të madhësisë. Nga klasifikimi ekzistues, struktura e fermës nuk është mjaft e qartë. Sipas Sauer et al.(2012), në gjysmën e parë të viteve 2000, 86% e tokës bujqësore ka qenë në pronësi private dhe operohet nga fermat familjare; pjesa tjetër është në pronësi të kooperativave prodhuese (1%) ose të ashtuquajtura ndërmarrje shoqërore (13%). EC (2006)³⁰ potencon ekzistencën e tokës që i përket disa ndërmarrjeve (NSH) dhe kooperativave.

Aktualisht, ka ende toka që janë në pronësi të shtetit që shfaqen në statistikat

³⁰ EC (2006)

zyrtare (Varga & Villanyi, 2011³¹). Duket se sektori i korporatës nuk ekziston më, pasi ai nuk është përmendur në statistikat aktuale zyrtare (Qevani et al., 2010³²).

2.3.1. Tipologjia e fermave në Shqipëri

Sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të fundit të bujqësisë, i kryer në Shqipëri në vitin 2012, 99,77% e numrit të përgjithshëm të fermave bujqësore ju përket personave fizikë (INSTAT, 2012). Kështu, mund të konkludohet se për nga statusi ligjor nuk ka sektor të korporatës në këtë vend dhe klasifikimi i fermave bujqësore do të thotë janë vetëm ferma familjare.

Ka dy lloje të klasifikimeve zyrtare në Shqipëri: i pari nënkupton madhësinë e fermave (MBUMK, 2012³³), fermat grupohen në katër klasa të ndryshme, sipas sipërfaqes se përdorur:

- ☐ 1 klasë - 0,1-0,5 ha;
- ☐ 2 klasë - 0,6-1,0 ha;
- ☐ 3 klasë - 1,1-2,0 ha;
- ☐ 4 klasë - mbi 2.1 ha.

Dhe i dyti, tipologjia zyrtare e fermës lidhur me llojin e bujqësisë, sipas të cilit fermat janë grupuara si më poshtë (Cela et al 2010³⁴):

- ☐ Fermë me drithëra dhe blegtorale;
- ☐ Ferma me te drithëra pa bagëtinë;
- ☐ Ferma me bimët e arave;
- ☐ Fermat me të lashtat e përhershme;
- ☐ Ferma me tokë ugar.

Në lidhje me zgjerimin e BE, Instituti Shqiptar i Statistikave është përfshirë kohën

³¹ Varga & Villanyi, 2011

³² Qevani et al., 2010

³³ MBUMK, 2012

³⁴ Cela et al 2010

e fundit në tipologjinë e fermave sa i përket komponentës standard të prodhimit. Mesatarja për periudhën 2005-2009, i njohur si SO 2007, është dorëzuar në EUROSTAT. Pra, klasifikimi i tipologjisë së fermave bujqësore në bazë të madhësisë ekonomike, sipas BE-së pritët të miratohet në të ardhmen. Një përpjekje për të analizuar këtë çështje në nivel lokal është ndërmarrë nga Canali et al. (1998³⁵), duke marrë parasysh sektorin e tregut të fermës, si elementi më i rëndësishëm i diferencimit në mesin e familjeve, të cilat varen kryesisht në tre faktorë: disponueshmëria e tokave të ujtitshme, burimet financiare për të shfrytëzuar ato dhe aftësitë profesionale të kultivojnë kultura për treg.

Duke përdorur këto variabla janë klasifikuar pronat bujqësore nga rajoni i Divjakës së Shqipërisë

2.3.2. Tipologjia e fermave në Bosnjë –Hercegovinë

Bosnja dhe Hercegovina është një shtet i Ballkanit, me shumë pak informacion në lidhje me tipologjinë e fermave, informacioni zyrtar nga Agjencia e Statistikave është i pakët i kësaj natyre. Nga ky burim informacioni mund të konkludohet tipologjia ekzistuese në Bosnjë dhe Hercegovinë është klasifikimi i fermave në statusin ligjor në kompanitë private dhe publike, kooperativat, ndërmarrjet publike etj (Bhas, 2010³⁶). Kurse Bajramović et al. (2010) thekson se numri i vlerësuar i pronave në Bosnjë dhe Hercegovinë është 515,000 dhe vlerësohet se mbi 50% e këtij numri (mbi 250.000) i takon njësisë së prodhimit me më pak se 2 ha, dhe më shumë se 80% (mbi 400.000) është më e vogël se 5 ha dhe rreth 20.000 ferma, ose 4% nga numri i përgjithshëm, janë më të mëdha se 10 ha. D.m.th se tipologjia e fermave në Bosnjë dhe Hercegovinë është e caktuar më shumë në bazë të madhësisë së fermave.

³⁵ Canali et al. (1998)

³⁶ Bhas, 2010

2.3.3. Tipologjia e fermave në Maqedoni

Tipologjia e fermave në Maqedoni është sipas regjistrimit të bujqësisë të Maqedonisë (SSO, 2007³⁷), ku fermat janë klasifikuar në bazë të statusit të tyre ligjor në pronat individuale bujqësore dhe subjekte të biznesit. Subjektet e biznesit përbëhen nga ndërmarrjet bujqësore dhe kooperativat (SSO, 2012³⁸), si dhe nga madhësia e fermës, që konsiderohet si dimension i dytë i tipologjisë zyrtare, sipas të cilit fermat janë klasifikuar në: 1) më pak se 0.50 ha; 2) 0,51-1,00 ha; 3) 1,01-3,00 ha; 4) 5,01-8,00 ha; 5) 8,01-10,00 ha dhe 6) mbi 10 ha. Kurse, në kundërshtim me klasat e fermës të sugjeruara nga statistikat zyrtare, Martinovska-Stojçevska et al. (2011)³⁹ pohojnë se tipologjia e fermave në bazë të sipërfaqeve të kultivuara të fermave, fermat janë ndarë në 5 grupe si në vijim: më pak se 2 ha; 2-5 ha; 5-10 ha; 10-15 ha dhe fermat me më shumë se 15 ha.

Maqedonia duke e shikuar procesin për integrim në BE, ka përshtatur statistikat e saj në Rregulloret e Komunitetit Evropian. Në këtë kontekst, metodologjia FADN është aplikuar për zhvillimin e tipologjisë së fermave (Kamphius & Dimitrov, 2002⁴⁰). Zyra shtetërore për statistika ka krijuar një tipologji të fermave bujqësore në përputhje me Rregulloren e BE-së (EC) Nr 1242/2008 në vitin 2011, duke qenë klasifikimi uniform i fermave bujqësore me Bashkimin Evropian (SSO, 2011). Kjo tipologji e fermave është e bazuar në llojin e bujqësisë dhe madhësinë ekonomike të fermave, duke përdorur standardin e koeficienteve të prodhimit dhe të dhënat strukturore nga regjistrimi i Bujqësisë 2007

³⁷ SSO, 2007

³⁸ SSO, 2012

³⁹ Martinovska-Stojcevska et al. (2011)

⁴⁰ Kamphius & Dimitrov., 2002

2.3.4. Tipologjia e fermave në Mal të Zi

Një qasje e ngjashme me tipologjinë e fermës është regjistruar edhe në Mal të Zi. Sipas Statistikave Kombëtare, fermat janë klasifikuar në klasat e madhësisë nga sipërfaqja që operojnë: 1) deri në 2 ha; 2) 2-5 ha; 3) 5-10 ha; 4) 10-20 ha; dhe 5) mbi 20 ha (Marković dhe Marković, 2010⁴¹).

Megjithatë, një klasifikim më i detajuar i tokës së shfrytëzuar është vërejtur në regjistrimin e fundit të bujqësisë, që përmban edhe një klasë të fermave pa tokë (Peković et al., 2011⁴²). Sipas statusit ligjor, fermat janë klasifikuar në subjektet e biznesit (0.1% e totalit) dhe fermat bujqësore (Zvizdojević et al., 2010⁴³). Pas integritetit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian, ngjashëm me Maqedoninë klasifikimi i tipologjisë i është përshtatur klasifikimit zyrtar të komunitetit në bazë të madhësisë ekonomike (prodhimit standard) dhe llojit të bujqësisë.

2.3.5. Tipologjia e fermave në Serbi

Një nga më të varfërit në çështjen e tipologjive të fermës duket të jetë Serbia. Klasifikimi i vetëm zyrtar që ekziston është i bazuar në statusin ligjor, duke i ndarë fermat në fermat familjare bujqësore dhe fermat si persona juridikë dhe ndërmarrjeve të pa inkuorporuara (Sors, 2012⁴⁴). Bogdanov & Božić (2010)⁴⁵ potencojnë se struktura e fermës në Serbi përbëhet nga fermat e vogla familjare bujqësore, fermat e vogla semisubstanciale, ferma të mëdha familjare, si dhe të ndërmarrjeve të mëdha të privatizuara me pronësi të përzier.

Strukturë e cila nuk bie ndesh (Keenleyside et al. (2010⁴⁶), i cili i referohet " fermave private të mbijetesës "dhe" fermave private komerciale ", duke supozuar se ka

⁴¹ Marković dhe Marković., 2010

⁴² Peković et al., 2011

⁴³ Zvizdojević et al., 2010

⁴⁴ Sors, 2012

⁴⁵ Bogdanov & Božić (2010)

⁴⁶ Keenleyside et al. (2010)

një tipologji, duke përfshirë dimensionin e marketingut, mirëpo nuk ka ndonjë shpjegim apo referencë në këtë drejtim.

Todorović et al. (2009)⁴⁷ ka përdorur një klasifikim të fermave në bazë të madhësisë së fermës si : 1) më pak se 0.5 ha; 2) 0.5-2 ha; 3) 2,01-5 ha; 4) 5,01-10 ha dhe 5) më shumë se 10 ha. Megjithatë, autori nuk specifikon nëse kjo tipologji është zyrtare apo është klasifikim sipas tij.

Duke iu referuar integritit në BE, Enti Statistikor i Serbisë ka llogaritur Koeficientet Output Standard (SO 2007) si rezultat i IPA 2008 projektit Multi-përfitues. Llogaritja e SO ishte bërë në përputhje me metodologjinë e dhënë në dokumentin "Udhëzuesi për tipologji- RI / CC1500 rev3 ", datë 5.10.2009 dhe përfaqëson vlerën monetare të një hektari, kur është fjala për kulturë të prodhuar, si dhe për prodhimtarinë blegtorale që korrespondon me një kokë të bagëtisë (ose 100 krerë në rasti i shpendëve ose një zgjua i bletëve). Këta koeficient do të jenë bazë për përcaktimin e tipologjisë së fermave në Serbi në përputhje me rekomandimet e BE-së.

Nga analiza e kësaj problematike shohim se përcaktimi tipologjive të fermave nuk paraqet preokupim të madh për të dy qarqet zyrtare dhe kërkimore. Klasifikimet e përdorura janë shumë të zakonshme në të gjitha vendet e Ballkanit, të orientuar në statusin ligjor dhe madhësisë së fermës. Por, vlen të përmendet se disa nga vendet si pjesë e rëndësishme e integritimeve evropiane kanë filluar të zbatojnë tipologjinë e fermave në bazë të madhësisë ekonomike dhe llojin e bujqësisë.

2.4. Modelet e fermave në Kosovë

Bujqësia kosovare ka kaluar nëpër sfida të ndryshme, bujqësia e Kosovës ka qenë dhe do të mbetet për një kohë të gjatë njëri prej sektorëve kyç në ekonominë e Kosovës,

⁴⁷ Todorovic et al. (2009)

por ajo pati një rënie mjaft të madhe në dekadat e fundit para dhe pas luftës së fundit (1990-1999) ku u shkatërrua pjesa më e madhe e aseteve bujqësore, ra prodhimi vendor, u rritë papunësia, inflacioni dhe më shumë deficitit tregtar. Sfidat e tilla po e përcjellin Kosovën edhe në ditë e sotme edhe 17 vite mbas lufte ne kemi një bilanc tregtar negativ.

Mirëpo duke marrë parasysh vështirësitë e shumta me të cilat ballafaqohet ky sektor Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, shumë donator dhe agjensione zhvillimore të vendeve të huaja janë duke bërë përpjekje për përkrahjen dhe rimëkëmbjen e këtij sektori.

Përveç fragmentimit të tokës, bujqësia kosovare vuan nga disa probleme kritike strukturore të tilla si: I) sistemeve të pazhvilluara të ujitjes dhe kullimit, II) infrastruktura e mangët, III) qasje e kufizuar në tregje, IV) industri të pazhvilluar agro-ushqimore, V) nivel të ulët teknologjik, VI) dobësia e organizatave të fermerëve dhe VII) limiti i qasjes në kredi (EC 2010⁴⁸).

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është të analizojë karakteristikat kryesore të sistemeve bujqësore në Kosovë, të tipologjisë së tyre dhe rolin e tyre aktual dhe potencial në sigurimin e ushqimit kombëtar.

Prandaj fokusi duhet të vendoset mbi perspektivat dhe sfidat e bujqësisë kosovare duke analizuar aspekte të veçanta të mëposhtme të ardhshëm:

- sistemet bujqësore
- Prodhimi i ushqimit, konsumi dhe tepricat
- Qeverisja dhe politika mbështetëse

Kontributi kryesor i studimit është analiza e sistemeve bujqësore në Kosovë dhe qëndrueshmërinë e tyre dhe për të nxjerrë në pah sistemet më efikase bujqësore në

⁴⁸ EC 2010

drejtim të tokës, punës dhe produktivitetit të kapitalit. Studimi paraqet analizën e tipit fermë, qëndrueshmërinë në aspekt të plotësimit të objektivave të tyre që rrjedhin nga strategjia kombëtare për zhvillimin rural.

Struktura e fermave dhe mënyra se si këto ferma janë organizuar e menaxhuar kryesisht pas luftës (1990-1999) mund të çojë në përfundimin se, tipologjia e fermave është vjetruar, kjo dikton nevojën e studimeve specifike, në mënyrë që të rekomandohen politika ekonomike të nevojshme, në përshtatje me kushtet e reja të zhvillimit të ekonomisë bujqësore në Kosovë.

Dy dekadat e fundit e sidomos periudha (1999), struktura e fermave në Kosovë pësoi ndryshime, pronat shoqërore kaluan në procesin e privatizimit, kurse këto private pësuan ndryshime duke u ndërruar destinimi i tyre, ndryshimi për nga sipërfaqja, teknikat dhe cilësia e tokës bujqësore, menaxhimi etj. Në përgjithësi ato janë shumë të vogla dhe të pajisura dobët (Kodderitzsch 1999)⁴⁹. Objektivi kryesor i fermave të pas vitit 1999 ishte mjet jetese (Kodderitzsch 1999⁵⁰). Modeli i prodhimit bujqësor e blegtoral bazohet kryesisht në prodhimin për konsum familjar dhe shitjet të pak tepricave në treg. Kjo situatë përgjithësisht lë hapësirë të vogël për strategjitë e fermerëve dhe në anën tjetër për instrumente të përshtatura të politikave publike, në këto kushte studimi i tipologjisë së tyre merr një rëndësi të veçantë, pasi bën të mundur hartimin e politikave ekonomike të përshtatshme në nivelin e fermës.

Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, shumë faktorë ndikuan (gjeografik, procesi i privatizimit, infrastruktura, të ardhurat jo-bujqësore, futja e teknikave të reja, klima etj) që të dalin fermat e llojeve të ndryshme në Kosovë. Shumë ferma në pjesën fushore të vendit (Pejë, Gjakovë, Prizren etj) janë të specializuara në drithëra, perime dhe vreshta të prodhuara për tregun duke reduktuar pjesën për vetë-konsum në prodhimin total. Në

⁴⁹ Kodderitzsch 1999

⁵⁰ Po aty

rajone të tjera dominojnë sistemet bujqësore për vet- konsum.

Këto trende të përgjithshme duhet të analizohen në mënyrë më të detajuar duke ndërtuar një tipologji të fermave që grupon ferma me karakteristika të ngjashme brenda grupit dhe dallimet e rëndësishme midis grupeve (Köbrich, Rehman et al 2003;. Iraizoz, Gorton et al 2007)⁵¹. Krijimi i një tipologjie të sistemit të fermave lejon specifikimin e pyetjeve kërkimore, hartimin e politikave dhe instrumenteve për përmirësimin edhe ndërhyrjet në zonat rurale.

Në rastin e Kosovës ndërtimi i një sistemi bujqësor përfaqësues për menaxhimin e fermave në mënyrë të integruar, ndihmon hartimin e politikave për të adresuar më mirë instrumentet mbështetës për t'iu përgjigjur nevojave specifike.

Bazuar në gjendjen faktike fermat bujqësore klasifikohen sipas madhësisë, drejtimit të prodhimit, pronësisë mbi tokën dhe krahut të punës.

Sipas madhësisë fermat bujqësore klasifikohen në ferma të vogla, ferma të mëdha dhe ferma potenciale.

Sipas drejtimit të prodhimit fermat bujqësore klasifikohen, në ferma për prodhimin e bimëve të arave, për prodhimin e perimeve, për prodhimin e kulturave dru frutore, ferma me drejtim foragjere - blegtorale dhe në ferma blegtorale (qumësht - mish).

Sipas pronësisë fermat janë të organizuara në tokën pronë e familjes, në tokën e marrë me qira dhe e kombinuar në tokën e tyre dhe në tokën e marrë me qira.

Sipas krahut të punës fermat janë familjare kur të gjithë punimet kryhen nga pjesëtarët e familjes dhe ferma të kombinuara kur një pjesë e vogël e punimeve mbulohen nga pjesëtarët e familjes dhe pjesa tjetër kryhet nga puna me pagë.

⁵¹ Köbrich, Rehman et al 2003;. Iraizoz, Gorton et al 2007

KAPITULLI III

3. SITUATA E ZHVILLIMIT RURAL NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT

(Rajoni i Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit)

3.1. Karakteristikat gjeografike

Kosova është e vendosur në Evropën Juglindore dhe karakterizohet me pozitë qendrore në Gadishullin Ballkanik. Kosova rrethohet nga Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi.

Kosova ka një sipërfaqe prej 10,908 km² me 602 km vijë kufitare. Toka bujqësore mbulon 53% të vendit, ndërsa pyjet 41%. Lumenjtë kryesorë të Kosovës janë Drini i Bardhë (122 km), Sitnica (90 km), Bistrica e Pejës (62 km), Morava e Binçës (60 km), Lepenci (53 km), Ereniku (51 km), Ibri (42 km) dhe Bistrica e Prizrenit (31 km). Janë 5 liqene më të mëdha se 2.5 km². Njëra nga karakteristikat e hidrografisë është se lumenjtë rrjedhin nga Kosova në Detin Adriatik, Detin e Zi, dhe Detin Egje. Klima kontinentale e Kosovës karakterizohet me një temperaturë që luhet nga -20C gjatë dimrit deri +35C gjatë verës.

Mesatarja e të reshurave të shiut arrin deri në 700 mm. Janë dy zona kryesore agroekologjike të përcaktuara nga klima, dheu dhe vegjetacioni:


- Rrafshi i Dukagjinit që shtrihet në pjesën jugperëndimore, ka klimë më të butë, më shumë mesdhetare dhe me të reshura vjetore të shiut prej 770 mm, kulturat më të zakonshme janë jonxha, misri, rrushi dhe perimet të cilat kërkojnë ujitje gjatë një pjese të madhe të vitit.

- Pjesa lindore që njihet si Fusha e Kosovës ka klimë më shumë kontinentale dhe të reshura vjetore të shiut prej 600 mm, si dhe është shumë e varur nga ujitja.

3.1.1. Struktura administrative

Kosova është e ndarë në shtatë rajone kryesore e ndarë në bazë të qyteteve më të mëdha në vend (Prishtina, Gjilani, Peja, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjakova), si dhe 38 komuna me 1.469 fshatra.

Harta 1 . Harta administrative e Kosovës



Burimi: Vjetari statistikor 2015

Nga aspekti administrativ, politika për zhvillimin rural dhe bujqësor është e vendosur në nivel kombëtar. Implementimi i politikës zbatohet në nivel kombëtar dhe komunal. Në formulimin e politikës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural⁵² luan rolin kryesor. Ajo miraton masat për zhvillimin rural dhe bujqësor për mbështetje publike. Si institucionet administrative, ashtu edhe shumë partnerë shoqërorë dhe ekonomikë (Shoqatat e Fermerëve, Shërbimi Këshillimor Rural, Shërbimi Veterinar Publik, etj.) kanë përfaqësuesit e tyre në nivel rajonal. Ata luajnë një rol në formulimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit rural dhe bujqësor.

3.1.2 Popullsia

Popullsia e përgjithshme e Kosovës në bazë të regjistrimit të fundit të bërë në vitin 2011 dhe të dhëna të vetë vlerësuara për vitin 2012, 2013, 2014 llogaritet rreth 1.8 milion banorë. Megjithatë ka dhe vlerësime të tjera të cilat popullsinë rezidente të Kosovës e kanë konsideruar rreth 1.9 milion që në vitin 2000 (Funkhouser 2003).

Një problem madhor për administratën publike vazhdon të mbetet mosnjohja e shtetit nga popullsia serbe që jeton në komunat veriore; Mitrovicë, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Kjo ka pasoja të rëndësishme për çështje politike dhe administrative.⁵³

Aktualisht, në vend mosha mesatare është 30.2 vjet dhe raporti mes femrave dhe meshkujve është pothuajse i barabartë. Rritja e popullsisë ishte e dukshme pas Luftës së Dytë Botërore deri në fillim të viteve '90. (tabela 1)

Pas vitit 1990 popullsia e Kosovës u përball me dukurinë e migracionit, i cili ndikoi si në strukturë ashtu edhe në ritmet e rritjes së saj.

Popullsia është zhvendosur në dy drejtime:

⁵² Detajet rreth MBPZHR-së, përfshirë organizimin dhe personelin e saj, siç janë dhënë në [www.ampkosovo.com](http://www.ampkosovo.com/EC%20Workshop%2028%20June%2027%20June.pps) (<http://www.ampkosovo.com/EC%20Workshop%2028%20June%2027%20June.pps>).

⁵³ GIZ: Analiza sektoriale për diversifikimin e ekonomisë rurale në Kosovë, 2013

- Brenda vendit – Lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e popullsisë ka ndikuar në ndryshimin e raportit të popullsisë urbane me atë rurale. Sipas regjistrimit të popullsisë të realizuar në Prill të vitit 2011, 61% e popullsisë jeton në zonat rurale.
- Jashtë vendit – kryesisht në drejtim të Zvicrës e Gjermanisë.

Tabela 1: Sipërfaqja në km² dhe popullsia e Kosovës 1921-2014

Vitet	Sipërfaqja në km ²	Popullsia		
		Gjithsej	Meshkuj	Femra
1921	10.908	439.010	220.244	218.766
1931	10.908	552.064	280.856	271.208
1948	10.908	733.034	373.736	359.298
1953	10.908	815.908	416.538	399.370
1961	10.908	963.988	492.630	471.358
1971	10.908	1.243.693	636.958	606.735
1981	10.908	1.584.440	818.392	766.048
2011 ¹⁾	10.908	1.780.021	896.136	883.885
2012 ²⁾	10.908	1.815.606	914.051	901.555
2013 ²⁾	10.908	1.820.631	916.581	904.050
2014 ²⁾	10.908	1.804.944	907.887	897.057

¹⁾Të dhënat e vitit 2011 përfshijë Regjistrimin e Popullsisë 2011 si dhe vlerësimin e pjesës veriore të Kosovës.

²⁾Të dhënat për vitin 2012, 2013, 2014 janë të dhëna të vlerësuara.

Prishtina është qyteti kryesor në Kosovë, me një popullsi prej më shumë se 300,000 banorë, Prizreni ka më shumë se 200,000 banorë dhe Peja mbi 100,000. Në qytetet më të vogla bëjnë pjesë Gjakova, Mitrovica, Ferizaji, Podujeva dhe Gjlani.

Tabela 2: Popullsia rurale dhe urbane në Kosovë (1981 – 2014)

	1981	1991	2002	2004	2014
Popullata në '000	1.6	1.9	2.5	1.9	1.8
Rurale (%)	67.5	65.0	62.0	n/a	61.0
Urbane (%)	32.5	35.0	38.0	n/a	39.0

Burimi: 1981: Studimet e Zyrës Kosovare për Planifikim dhe Zhvillim 1991 2002: Riinvest (2002);Hulumtimi për Ekonomitë Shtëpiake dhe Tregun e Punës në Kosovë 2004. Vjetari statistikor 2015

Mbështetur në të dhënat e vjetarit statistikor të Kosovës popullsia që jeton në viset rurale është më e re se popullsia që jeton në viset urbane. Familjet rurale dhe urbane kanë mesatarisht 8.3 dhe 6.3 anëtarë përkatësisht, duke dhënë një mesatare kombëtare prej 7.4 anëtarë për familje.

Popullsia e Kosovës është e varfër. Bazuar në HMSJ (Hulumtimin i Matjeve të Standardit të Jetesës, 2014), 10% e popullsisë jeton në varfëri të skajshme, dhe 30% të tjerë janë të varfër. Megjithatë niveli i varfërisë është ulur krahasuar me vitin 2000 ku rreth 52% e popullsisë së Kosovës ishte e varfër (Banka Botërore – 2001).

3.1.3. Konteksti Makroekonomik i Kosovës

Vitet e fundit Kosova ka bërë përparim të dukshëm në ndërtimin e institucioneve dhe stabilizimin makroekonomik, megjithatë përparimi i situatës ekonomike është shumë i ngadaltë për të plotësuar kërkesat dhe pritshmëritë e popullsisë. Mungesa e zhvillimit ekonomik mund të ketë ndikim negativ në stabilitetin politik të vendit, fakt i cili do të frenonte më shumë reformat për zhvillim në të ardhmen.

Situata politike me të cilën po përballet Kosova aktualisht është reflektuar dhe në rritjen ekonomike të BPV, pra nga 5.7% në 2001 në 1.2% në vitin 2014.

Gjithashtu rritja ekonomike kushtëzohet dhe nga shkalla e lartë e papunësisë në vend. Megjithatë krahasuar me vitin 2001 ku shkalla e papunësisë ishte 57%, shihet se në vitin 2014 ka rënë në masën 35%. Shkalla e papunësisë në Kosovë është vlerësuar ndër shkallët më të larta të papunësisë në rajon dhe kjo është tre herë më e lartë se 28 vendet e BE – së (10.5%)⁵⁴. Gjithashtu në këtë pikë duhet theksuar se për një pjesë të të dhënave makro-ekonomike mungojnë tërësisht informacionet.

BPV tregon se në vend ka pasur një përmirësim të aktiviteteve ekonomike dhe

⁵⁴ Nxjerre nga Strategjia Ndersektorale e Kosoves 2014-2020 (Draft)

rritje pozitive që nga viti 2000. Rritja e BPV pasqyron nivelin e lartë të investimeve publike dhe private. Sidoqoftë, niveli i aktivitetit ekonomik në Kosovë është mbështetur nga ndihma e jashtme dhe hyrjet e mjeteve private financiare nga jashtë që së bashku përbëjnë rreth 34% të BPV.


Nga ana tjetër, në vend kërkohen politika të forta për të promovuar zhvillimin dhe për të krijuar një ambient i cili do të mundësojë investimet produktive me një strukturë efikase dhe efektive të shpenzimeve publike, dhe në të njëjtën kohë për të mbajtur stabilitetin fiskal, nxisin reformat në sektorin e ndërmarrjeve publike dhe përshpejtojnë ritmin e gjithmbarshëm të reformës së tregut. Treguesit kryesorë makroekonomikë të Kosovës për 2001-2015 janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3: Treguesit ekonomikë të Kosovës 2001 – 2014, si përqindje e BPV-së

Treguesit ekonomikë	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
1 Shkalla reale e rritjes (në përqindje të BPV)	5.1	3.7	3.6	3.7	3.8	3.9	3.9	4.5	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	1.2
2 Shkalla vjetore e inflacionit	11.7	3.6	1.3	-1.1	-1.4	0.6	4.4	9.4	-2.4	3.5	7.3	2.5	1.8	0.4
3 Shkalla e papunësisë	57.1	55.0	49.7	39.7	41.4	44.9	43.6	47.5	45.4	n.a.	n.a.	30.9	30.0	35.3
4 Tregtia e jashtme (mallrat dhe shërbimet) bilanci, % BPV	-36.9	-31.9	-33.0	-34.4	-36.2	-36.7	-38.6	-38.6	-34.9	-35.6	-37.2	-34.1	-31.6	-30.9
5 Bilanci i përgjithshëm (pas granteve) në përqindje të BVP-së	5.0	4.8	n.a.	-5.8	-3.2	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.
6 Investimet në përqindje të BVP-së	27.1	26.6	n.a.	24.1	24.1	25.6	26.3	28.4	29.8	32.5	33.9	29.0	27.6	25.8
7 Konsumi në përqindje të BVP-së	110.0	93.6	n.a.	90.9	91.7	111.1	112.3	107.5	103.7	102.6	103.3	105.2	104.0	105.2
8 Bilanci i tanishëm i llogarisë, % BPV para FA	-45.2	-47.9	n.a.	-38.7	36.2	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.	n.a.
9 Bilanci i tanishëm i llogarisë, % BPV pas FA	2.3	-8.0		-14.7	-15.3	-7.2	-6.3	-11.9	-9.2	-11.7	-13.7	-7.5	-6.4	-7.9
10 Investimet e drejtpërdrejta të huaja, në milion BPV	n.a.	n.a.	n.a.	31.0	28.5	9.5	13.0	9.5	7.1	8.4	8.0	4.5	5.3	2.7

Burimi: vlerësimet e FMN-së, Korrik 2005, bazuar në ndryshimet e sektorin publik të financuar nga donatorët konsumi dhe investimet, vjetari statistikor 2015


3.1.3.1 Importi i mallrave në Kosovë: Kosova është importuese e madhe e prodhimeve bujqësore dhe jo bujqësore. Niveli i importeve ka mbetur konstant duke pasur ne këtë mënyrë luhatje të vogla të sasive të importuara.

Grafiku 1: Importi i mallrave në Kosovë

Burimi: Vjetari statistikor 2015.

Nga grafiku 1, kuptojmë se vendin kryesor të importit në vite të zënë ushqimet dhe kafshët e gjalla, lëndët djegëse, produktet kimike, mallrat e përpunuara dhe makineritë dhe pajisjet e transportit. Një vend të vogël zënë pijet dhe duhani, produktet e papërpunuara dhe yndyrnat bimore e shtazore. Kjo situatë e importeve rezulton për shkak të nivelit të ulët të industrisë përpunuese në vend, si dhe mungesës së kapaciteteve për të prodhuar vet.

3.1.3.2 Eksporti: eksporti i mallrave në Kosovë është shumë i vogël krahasuar me importin, duke pasur prej vitesh një bilanc negativ.

Grafiku 2: Eksporti i mallrave në Kosovë

Burimi: Vjetari statistikor 2015

Kosova eksporton më shumë materiale të papërpunuara dhe yndyrna bimore e shtazore. Nga grafikët e importit dhe eksportit rezulton qartë se të gjitha ato produkte që zënë vend të vogël në import janë dominante në eksport.

Në vitin 2005, importi i përgjithshëm ishte 1.2 miliard euro, dhe eksporti i përgjithshëm ishte 56 milion euro, ndërsa në vitin 2013 vlera e importit arriti në 2.45 miliard euro dhe ajo e eksportit në 293 milion euro. Pra si rezulton dhe nga tabela 4. Kosova ka bërë ndryshime të rëndësishme në drejtim të rritjes së eksporteve vendase. Duhet theksuar se eksportet janë rritur jo vetëm në drejtim të vendeve kufitare si Shqipëri, Mal i Zi, por edhe në drejtim të vendeve të Komunitetit Evropian, SHBA, Turqi, Kanada etj. Importi i përgjithshëm i mbuluar nga eksporti për vitin 2013 ishte 12%, ndërsa bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ.

Tabela 4: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme sipas viteve 2005-2013 ('000 €)

Periudha	Eksporti	Importi	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
2005	56,283	1,157,492	-1,101,209	4,9
2006	110,774	1,305,879	-1,195,105	8,5
2007	165,112	1,576,186	-1,411,074	10,5
2008	198,463	1,928,236	-1,729,773	10,3
2009	165,328	1,935,541	-1,770,214	8,5
2010	295,957	2,157,725	-1,861,769	13,7
2011	319,165	2,492,348	-2,173,184	12,8
2012	276,100	2,507,609	-2,231,509	11,0
2013	293,842	2,449,064	-2,155,221	12,0

Burimi: Vjetari statistikor 2015

3.1.3.3 Bujqësia në ekonominë kombëtare

Bujqësia është dega kryesore e ekonomisë së Kosovës dhe kontribuon me 12.9% të PVP-së (GDP), bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Raporti i Gjellbër, Dhjetor 2014). Në zonat rurale, jeton afro 60% e popullsisë, ku bujqësia konsiderohet si burimi kryesor i të ardhurave. Numri i të punësuarve në bujqësi zë afërsisht 4.6 % të totalit të të punësuarve, të cilët janë pjesë e

tregut formal, pasi supozohet se ky numër është shumë herë më i madh nisur nga numri i popullsisë që jeton në zonat rurale. Megjithatë, rënia e vazhdueshme e punësimit në bujqësi dhe humbja e të ardhurave të ekonomive shtëpiake ka filluar të dëmtojë qëndrueshmërinë e komuniteteve rurale.

Situata që po kalon vendi aktualisht ka ardhur si pasojë e ndryshimeve dhe problemeve që ka pasur Kosova që pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Në atë periudhë, vendi ishte i organizuar sipas sistemit komunist ku e gjithë bujqësia ishte e organizuar në formën e kooperativave dhe kombinateve të mëdha bujqësore industriale. Gjatë kësaj periudhe bujqësia kosovare pati një zhvillim të hovshëm në kuptimin e plotë të fjalës në të gjitha degët e saj si në: blegtori, lavërtari, pemëtari dhe vreshtari, përpunim të produkteve bujqësore e deri te prodhimi i plehrave. Pothuajse në të gjitha viset e Kosovës u krijuan kombinatë që në të vërtetë ato ishin pjesë e një zinxhiri të plotë ushqimor duke filluar nga prodhimi i lëndës së parë e deri te prodhimi final. Gjatë kësaj kohe u ngritën shumë komplekse agro-industriale, ferma të mëdha blegtorale, vreshta si dhe fabrika që merreshin me përpunimin e produkteve bujqësore. Por, kjo situatë vazhdoi deri në fillim të viteve '90, periudhë në të cilën u ndërmorën shumë masa drastike të dhunshme e të cilat shkatërruan bujqësinë e Kosovës.

E gjithë kjo situatë vazhdoi deri në vitin 1999 që përkon me përfundimin e luftës në Kosovë dhe daljen e Kosovës si vend i lirë.


Në 1999-2004, pjesëmarrja sektoriale në BPV ka ndryshuar në mënyrë të dukshme. Sektori i shërbimeve ka treguar një rritje të shpejtë: pjesëmarrja e këtij sektori në BPV ka treguar një ngritje të shpejtë nga 46.5% në vitin 1993 në 58% në vitin 1998. Përkundër rënies së pjesëmarrjes në vitet e fundit, bujqësia kosovare ngel si një nga krijuesit e rëndësishëm të pasurisë kombëtare. Për më tepër, bujqësia kosovare ishte dhe vazhdon të jetë forca kryesore për rritjen reale të BPV.

Gjithashtu, sektori i bujqësisë në Kosovë ballafaqohet me një numër të madh sfidash, me një mos organizim sektorial, efektivitet dhe rentabilitet shumë të ulët të prodhimit, me një konkurrueshmëri jo të ndershme, kosto të lartë të prodhimit, bilanc tregtar negativ.

Megjithëse bujqësia është sektori kryesor i punësimit të popullsisë së zonave rurale, kontributi i saj në BPV është rreth 19%. Kontributi i këtij sektori në BPV me raportin e punësimit tregon se efikasiteti i sektorit bujqësor në Kosovë është i ulët. Një përmirësim i dukshëm në efikasitet do të reduktonte numrin e personave të punësuar në sektorin bujqësor. Rënia e vazhdueshme e punësimit në bujqësi dhe humbja e të ardhurave të ekonomive shtëpiake mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë e komuniteteve rurale, nëse nuk zhvillohen aktivitete ekonomike alternative.


3.1.3.4 Resurset natyrore për bujqësinë

Nga sipërfaqja totale e Kosovës prej 1.1 milion ha. 80.8 % mund të kultivohen, ndërsa 13 % janë tokë pyjore. Bujqësia është aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik, sektori i cili siguron pjesën më të madhe të punësimit në Kosovë. Pas përfundimit të luftës, shumica e fermerëve u kthyen dhe rindërtuan shtëpitë e tyre dhe filluan të punojnë në fermat e veta. 86% të tokës është në pronësi private, ndërsa pjesa tjetër i takon kooperativave (1%) dhe ndërmarrjeve shoqërore (NPSH) (13%), me tokë të madhësisë prej 500 deri 1,500 hektarë.

Grafiku 3: Struktura e tokës në Ekonomitë Bujqësore, Kosovë, 2014

Burimi: Vjetari statistikor 2015

Sipas të dhënave të Regjistrimit të Bujqësisë janë 129.884 Ekonomi Bujqësore që e shfrytëzojnë tokën bujqësore në Kosovë. Ekonomitë Bujqësore shfrytëzojnë gjithsej 413,635 hektarë të tokës bujqësore, nga të cilët 147,587 janë tokë e përbashkët (35.7%). Pjesa më e madhe e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore i përket livadheve dhe kullosave (54.2%), që pasohet nga toka e punueshme - arat (43.5%), kulturat shumëvjeçare (1.9%) dhe kopshtet (0.3%).

Grafiku 4: Struktura e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore në Ekonomitë Bujqësore, Kosovë, 2014

Burimi: Vjetari statistikor 2015

3.1.3.5 Struktura e fermës

Bazuar në të dhënat e Inventarizimit Nacional të Pyjeve⁵⁵ që është kryer në vitin 2012, toka bujqësore në Kosovë dhe shfrytëzimi i saj në vitin 2012 ka qenë 470,400 ha (tokë bujqësore, livadhe dhe kullosa). Nga ky total vetëm 296,830 ha janë të shfrytëzuar për kultivim (AESHB 2013). Po ashtu sipas anketës së ekonomive shtëpiake bujqësore⁵⁶ të ASK-së të vitit 2013, 49% e fermave të ekonomive shtëpiake të anketuara ishte me madhësi me më pak se 1 ha. Numri i fermave mbeti afërsisht i pandryshueshëm që nga viti 2007, por sipërfaqja e shfrytëzuar është rritur për 11.7%. Megjithatë, një rritje e fuqishme është e dukshme sa i përket numrit të hektarëve në “fermat e mëdha dhe të specializuara”, nga 3,434 në vitin 2007 në 7,502 në vitin 2013, një rritje prej 118.5%. (Raporti i Gjellbër i Kosovës, 2014, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë 2014⁵⁷. Krahasuar me numrin e fermave të vitit 2007, gjatë vitit 2013 kemi rritje të numrit të fermave të vogla prej 3.6% dhe po ashtu rritje të numrit të hektarëve për 11.7%. Ndryshimet janë evidente dhe në kategorinë e fermave të mëdha dhe të specializuara ku kemi rritje të numrit të fermave për 245.5%, dhe po ashtu shtim të numrit të hektarëve për 118.5%. Numri i përgjithshëm i fermave gjatë vitit 2013 është rritur për 3,8% krahasuar me numrin e fermave të vitit 2007, ndërsa sipërfaqja ka shënuar rritje prej 13.1%.⁵⁸

⁵⁵ Inventarizimi Nacional i Pyjeve, 2012

⁵⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, Anketë e ekonomive shtëpiake bujqësore, 2013

⁵⁷ Raporti i Gjellbër i Kosovës, 2014, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë, 2014

⁵⁸ Po aty

Tabela 5: Struktura e fermës sipas madhësisë dhe llojeve në vitin 2013

	Fermat e vogla			Fermat e mëdha dhe të specializuara			Gjithsej		
Madhësia (ha)	Nr. i fermave	Sip. (ha)	% e fermave	Nr. i fermave	Sip. (ha)	% e fermave	Nr. i fermave	Sip. (ha)	% e fermave
0.01- 0.5	40,891	13,042	21,5	6	2	1,7	40,897	13,044	21,5
0.51- 1	52,296	38,947	27,6	8	6	2,2	52,304	38,953	27,5
1.01-1.5	43,010	52,118	22,7	13	17	3,6	43,023	52,135	22,6
1.51-2	15,030	26,373	7,9	7	12	1,9	15,037	26,385	7,9
2.01-3	21,586	52,507	11,4	21	56	5,8	21,607	52,562	11,4
3.01-4	5,317	18,266	2,8	27	95	7,5	5,344	18,361	2,8
4.01-5	3,550	15,827	1,9	20	91	5,6	3,570	15,918	1,9
5.01-6	2,455	13,442	1,3	21	115	5,8	2,476	13,557	1,3
6.01-8	2,674	18,365	1,4	31	218	8,6	2,705	18,583	1,4
8.01-10	1,094	9,724	0,6	26	237	7,2	1,120	9,961	0,6
Mbi 10	1,917	30,718	1,7	179	6,653	49,9	2,096	37,371	1,1
Gjithsej 2013	189,821	289,328	100,0	359	7,502	100,0	190,180	296,830	100,0
Gjithsej 2007	183,182	259,094	100,0	104	3,434	100,0	183,286	262,528	100,0
Ndryshimi në %	+3.6	11.7		254.2	118.5		3.8	13.1	

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2007, 2013

Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma të vogla mesatarisht 2.4 ha, prodhimtari të ulët dhe mungesën e shërbimeve këshillimore, gjë e cila sjell një efikasitet të ulët të sektorit bujqësor. Sipërfaqja totale e Kosovës është rreth 1.1 milion ha, nga të cilat 53% mund të kultivohen, ndërsa 41% janë tokë pyjore. Pas mbarimit të luftës shumica e fermerëve u kthyen dhe rindërtuan shtëpitë e tyre dhe filluan të punojnë në fermat e veta.

Pra fermat bujqësore në Kosovë karakterizohen nga sipërfaqja e kufizuar e tokës së punueshme dhe nivel të lartë i fragmentizimit.

Njëri prej probleme kyçe me të cilin përballet sektori bujqësor në Kosovë është mos ekzistimi i të dhënave të sakta që reflektohen negativisht si në nivelin qendror, pra përpilimin dhe zbatimin e politikave bujqësore e po ashtu edhe në nivelin lokal pra fermerët, përpunuesit, furnizuesit e inputeve bujqësore, tregtarët e deri të konsumatorët. Megjithatë vitet e fundit janë bërë përpjekje për identifikimin dhe monitorimin e fermave kosovare.

Regjistrimi i Bujqësisë i organizuar në Kosovë në vitin 2014 është regjistrimi i parë i bujqësisë pas 54 vitesh. Regjistrimi është organizuar dhe realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) dhe me Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR).


Sipas të dhënave të Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, në fushën e hulumtimit për përzgjedhjen e mostrës së FADN-së kanë qenë 62,616 ferma (ku prodhimi standard ose Standard Output-i kalon prapë 2,000 Euro). Fermat janë klasifikuar nga madhësia dhe lloji i tyre. Pesë kategoritë e madhësisë së fermës dhe tetë lloje të tipologjisë janë të bazuara në përputhje me tipologjinë e BE-së.. Tabela 6, tregon strukturën e fushës së hulumtimit sipas madhësisë dhe tipit ose llojit të fermës.

Tabela 6: Numri i fermave në fushën e hulumtimit

Tipologjia e fermave sipas aktivitetit	Madhësia ekonomike					Totali	Pjesëmarrja %
	2000-4000	4000-8000	8000-15000	15000-25000	Mbi 25000		
Kultura lavërtare	2,531	998	403	253	792	4,978	10%
Kultura të përhershme	216	144	216	360		936	2%
Bagëti që kullosin	7,824	4,732	2,541	1,437	2,000	18,534	36%
Kultura të përziera	1,498	1,402	902	427	211	4,440	9%
Të përziera blegtorale		1474	552	96	96	2,218	4%
Ferma të përziera bimë dhe kafshë	7,532	9,410	2,793	453	806	20,995	40%
Totali	19,600	18,161	7,409	3,027	3,955	52,153	100%
Pjesëmarrja (%)	38%	35%	14%	6%	8%	100 %	

Burimi: FADN 2014

Në bazë të rezultateve të tabelës 6 kuptojmë se 38% e fermave janë të vogla, ku Standard Output-i nuk tejkalon 4,000 Euro në vit. Në këtë kategori mungojnë fermat e përziera blegtorale, të cilat zënë peshën më të madhe për tipin e fermave ku standard Output arrin deri në 8.000 euro. Ndërsa Standard Output mbi 8.000 euro në vit e arrijnë vetëm 28% e fermave në Kosovë. Këto rezultate dëshmojnë se pjesa më e madhe e fermave janë shumë të vogla dhe mezi arrijnë të mbijetojnë. Për fat të keq, fermerët e vegjël në vendin tonë kanë qenë të nënvlerësuar si nga komuniteti i biznesit e po ashtu edhe nga politikat qeveritare

Harta 2: Toka e shfrytëzuar në Kosovë sipas komunave (2014)

Në Kosovë është bërë një tipologji e shfrytëzimit të tokës. Nga harta e mësipërme rezulton se shfrytëzimi i tokës në vend është i larmishëm. Ka zona si Prishtina apo Peja ku sipërfaqja e tokës bujqësore shfrytëzohet në masën 30-40 %, si dhe zona si Dragashi ku toka shfrytëzohet në masën 60%. Kjo shumëllojshmëri e shfrytëzimit të tokës vjen për disa arsye:

- Zhvillimi ekonomik i zonave ndikon në shfrytëzimin e tokës bujqësore. Në zonat ekonomikisht më të zhvilluara popullsia i është larguar aktiviteteve bujqësore dhe ka filluar të investojë në drejtim të industrisë.
- Zonat më të zhvilluara janë përballur me presionin e rritjes së popullsisë si pasojë e migrimit të brendshëm dhe ato tashmë po shndërrohen në zona me

predominancë urbane si Prishtina, apo Peja.

- Kushtet klimatike, apo relievi janë faktorë të tjerë që ndikojnë në drejtim të shfrytëzimit të tokës bujqësore.
- Emigrimi i popullsisë duke lënë një pjese të tokave të papunuara apo të pa shfrytëzuara.

Megjithatë faktet tregojnë se Kosova është e dominuar nga ferma të vogla ekzistenciale (86% e tokës bujqësore), me një madhësi mesatare prej 2.4 ha të ndarë në disa parcela. Tabela në vazhdim pasqyron gjendjen reale në këtë sektor. Jo më shumë se 3,000 ferma janë më të mëdha se 10 ha, nga 150,000 ferma të vlerësuara në total.

Tabela 7: Kategoritë e fermave sipas madhësisë së sipërfaqes punuese

Kategoria	Numri i fermave	Sipërfaqja mesatare në hektar	% e fermave	Tokë e kultivuar (në ha)	Mesatarja e sipërfaqes së Përgjithshme
Fermat ekzistenciale	120,000	< 2	80%	220,000	45.83%
Fermat potenciale komerciale	23,000	2 – 5	14.3%	105,000	21.87%
Fermat komerciale	7,025	5-10	5.0%	135,000	28.12%
NSH	10	> 10	0.7%	20,000	4.18%
Totali	150,035		100%	480,000	100%

Burimi: Raporti i Gjellbër, 2014

Sipërfaqja e tokës për shfrytëzim (në dispozicion) në Kosovë përbëhet nga: toka bujqësore (e shfrytëzuar dhe e pashfrytëzuar), toka pyjore dhe toka jo pjellore. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në dispozicion të ekonomisë bujqësore është toka në pronësi të fermerëve ose anëtarëve të tjerë të ekonomisë bujqësore, si dhe toka në pronësi të të tjerëve dhe e shfrytëzuar nga ekonomia bujqësore, pavarësisht nëse toka është kultivuar ose jo.

Në regjistrimin e bujqësisë janë këto kategori të ekonomive bujqësore: toka në pronësi, toka e marrë me qira, toka e dhënë me qira, toka bujqësore e papërdorur,

kullotat dhe livadhet e pashfrytëzuara, sipërfaqja e tokës pyjore, sipërfaqja e tokës jobujqësore, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, toka e punueshme – arat etj.

Ekonomitë Bujqësore në Kosovë (Ekonomitë Familjare Bujqësore dhe Subjektet Juridike me aktivitet bujqësor) kanë pasur në pronësi 310,691 hektarë tokë, sipas regjistrimit të bujqësisë të vitit 2014. Mesatarisht, ekonomitë bujqësore kanë pasur në pronësi 2.4 hektarë tokë. 3,904 ekonomi bujqësore (3%) kanë dhënë tokën me qira. Ekonomitë bujqësore kanë dhënë me qira 6,311 hektarë tokë, mesatarisht 1.6 ha për ekonomi bujqësore. Njëkohësisht, në Kosovë, fragmentizimi i tokës bujqësore është evident për pjesën më të madhe të rajoneve.

Marrja e tokës me qira është shumë më e shpeshtë sesa dhënia e tokës me qira. Pothuajse 15.8% e ekonomive bujqësore kanë marrë tokën me qira. Ekonomitë bujqësore që kanë marrë tokë me qira, kanë marrë 60,032 ha tokë, nga të cilët 55,372 ha të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore.

Tabela 8: Ekonomitë Bujqësore sipas pronësisë së tokës, Kosovë, 2014⁵⁹

Sipërfaqja e tokës	Numri i Ekonomive Bujqësore	Sipërfaqja (ha)
Gjithsej	130,662	512,000.29
Tokë në pronësi	130,439	310,691.05
Tokë e marrë me qira	20,679	60,032.43
Tokë e dhënë me qira	3,904	6,310.75
Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës së përbashkët	24,808	147,587.56
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësor	129,884	413,635.16
Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore e marrë me qira	20,605	55,372.08

Burimi: Agjensioni i statistikave të Kosovës, Raporti i Cilësisë, Regjistrimi i Bujqësisë 2014

Ekonomitë bujqësore në Kosovë shfrytëzojnë gjithsej 512,000 hektarë tokë (në pronësi dhe të marrë me qira). Mesatarisht ato shfrytëzojnë 3.9 hektarë tokë për ekonomi bujqësore. Në strukturën e tokës për shfrytëzim nga ekonomitë bujqësore,

⁵⁹ Agjensioni i statistikave të Kosovës, Raporti i Cilësisë, Regjistrimi i Bujqësisë 2014

pjesa më e madhe është ajo e sipërfaqes së shfrytëzuar e tokës bujqësore, ku pjesëmarrja e saj është 80.8% e gjithsej tokës për shfrytëzim

Sipas të dhënave të regjistrimit të bujqësisë janë 129,884 ekonomi bujqësore që e shfrytëzojnë tokën bujqësore në Kosovë. Ekonomitë bujqësore shfrytëzojnë gjithsej 413,635 hektarë të tokës bujqësore, nga të cilët 147,587 janë tokë e përbashkët (35.7%).

Sa i përket tipologjisë së fermave kuptojmë se pjesa më e madhe e fermave në Kosovë janë të përziera (me bimë dhe kafshë) pasi fermerët ndihen të pasigurtë për të ardhmen e tyre nëse zhvillojnë vetëm një tip aktiviteti bujqësor. Gjithashtu ajo që duhet theksuar është se dhe fermat me një Standard Output mbi 25.000 € në vit janë pjesë e tipit të fermave polikulturë për një sërë arsesh:

- kanë nivel më të ulët risku
- kanë nivel më të lartë investimesh si vreshta, pemëtore, sera, apo numër të lartë bagëtish.
- kanë më shumë mundësi që produktet e tyre të jenë pjesë e tregut vendas
- kanë krah pune aktiv, që merret me aktivitet bujqësor

Tabela 9: Kategorizimi i llojit kryesor të fermave

	Tradicionale		Gjysmë-komerciale		Komerciale		Gjithsej
Drithërat (gruri)	62,000	89%	7,000	10%	1,000	1%	70,000
<i>Sipër. mesatare (ha)</i>	0.8		1.4		10.0		1.1
Perimet e fushës	140,000	100%	5,000	0%	1,500	0%	146,500
<i>Sipër. mesatare (ha)</i>	0.05 ha		0.5 ha		3 ha		0.1ha
Blegtoria							
Qumështi	78,124	94%	4,378	5%	787	1%	83,289
<i>nr i lopëve për tufë</i>	1.3		6.1		14.0		1.7
Dhentë	1,811	72%	446	18%	271	11%	2,528
<i>nr i dhenve për tufë</i>	15	58%	58		149		37

Burimi: Grupet Punuese për PZHR-në e MBPZHR-së

3.1.3.6 Prodhimet bujqësore

Bujqësia

Toka bujqësore në Kosovë kryesisht është e mbjellë me drithëra, në raport me kulturat industriale (p.sh duhani, panxhari i sheqerit, luledielli).

Sipërfaqja mesatare e tokës së shfrytëzuar bujqësore për ekonomi bujqësore është 3.2 ha, që përbën dhe tipin kryesor të ekonomive bujqësore në Kosovë. Toka bujqësore shtrihet relativisht në Kosovë; vetëm zonat me brigje të pjerrëta në pjesën jugore dhe perëndimore të Kosovës nuk janë të përshtatshme për bujqësi.

Regjistrimi Bujqësor i vitit 2014 paraqet rreth 413,634 hektarë të tokës bujqësore nga e cila 254,303 hektar (61,5 %) shfrytëzohet me sipërfaqe bujqësore (UAA). Toka e punueshme llogaritet për më shumë se gjysma e sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore (57.6% në vitin 2013), ndërsa kulturat permanente zënë vetëm sipërfaqe të vogla (3% në vitin 2014). Rreth 70 % e tokës së punueshme është kultivuar me drithëra. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është vazhdimisht në rritje.

Toka bujqësore në Kosovë kryesisht është e mbjellë më shumë me drithëra 43.6% (180,381 ha), se sa me kultura industriale (p.sh duhani, panxhari i sheqerit, luledielli). Kultura kryesore që mbillet është gruri (50.3%), i pasuar nga misri (19.4%). Shumica e ekonomive bujqësore kultivojnë deri në 0.5 ha të tokës së punueshme me bimë arash. Sipërfaqja mesatare e tokës së punueshme me bimë arash është rreth 1.6 ha.

Sipërfaqja e përgjithshme e drithërave, sipas Anketës së Ekonomive Bujqësore të ASK është 141,912 ha, me pjesëmarrje prej 47.8%. Kultura e grurit është kulturë dominante (101,846 ha) dhe strategjike në prodhimtarinë e drithërave. Në vitin 2013 kemi zvogëlim të sipërfaqes së mbjellur me grurë për 1% dhe ende nuk plotësohen kërkesat vendore.

Mesatarja e rendimentit të grurit në Kosovë sillet ngjashëm me mesataren e

vendeve të Evropës Jug lindore (4.4 t për hektar në vitin 2013), por kjo është ende nën mesataren e rendimenteve të drithërave të regjistruara në Kroaci (5.4 t për hektar) dhe Shqipëri (4.6 t për hektar). Megjithatë produktiviteti i ulët i drithërave është kryesisht i madh për shkak të madhësisë së fermave që prodhojnë drithëra dhe që vlerësohet me mesataren prej 2.00 – 3.00 hektarë.

Tabela 10: Sipërfaqja e kulturave bujqësore në vitet 2005-2013

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010 ¹⁾	2011 ¹⁾	2012	2013
Kulturat	Sipërfaqja në hektar								
Grurë	69,349	68,612	61,222	71,131	77,938	78,420	79,92	102,918	101,84
Misër	36,959	36,138	35,214	36,119	35,854	35,424	35,20	31,181	36,121
Patate	3,807	3,089	4,952	3,746	3,376	3,759	3,746	3,198	2,777
Domate	741	787	923	903	821	935	967	1,271	950
Spec	2,621	2,733	2,231	2,523	2,955	2,914	2,993	3,153	3,686
Lakër	775	921	620	703	962	836	842	568	851
Qepë	852	810	1,059	1,205	798	1,043	1,074	881	1,060

Burimi: Vjetari statistikor 2015

Misri është kultura e dytë për nga sipërfaqja mbjellëse (36,122 ha), sepse shërben si kulturë rrotative me grurin. Kohëve të fundit është duke u kultivuar në sipërfaqe të vogël. Në këtë ka ndikuar zvogëlimi i sipërfaqeve të mbjella me grurë, por ka ndikuar edhe zvogëlimi i fondit të blegtorisë dhe mbyllja e fabrikave për përpunimin e ushqimit të kafshëve. Nuk ka treg të vërtetë për misër, ai kryesisht përdoret si ushqim për bagëti në fermën e prodhuesit të misrit (misër kokërr dhe për silazh). Elbi është kulturë lavërtare, me një traditë të gjatë kultivimi, që është kultivuar (1,363 ha) për nevoja të sektorit të blegtorisë, pasi që është shfrytëzuar për ushqim të bagëtisë në formë kokrre, por edhe si përbërës i koncentreve. Krahasuar me vitin 2012 kemi një rritje të sipërfaqes së elbit për 140%.

Tabela 11: Prodhimi i kulturave bujqësore sipas viteve 2005-2013

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010 ¹⁾	2011 ¹⁾	2012	2013
Kulturave bujqësore	Prodhimi në ton								
Grurë	273,376	239,464	207,18	293,064	271,37	294,54	300,20	345,02	391,72
Misër	142,139	138,248	74,450	126,919	125,86	120,46	119,69	86,304	136,63
Patate	87,316	71,244	95,125	103,958	58,687	87,354	87,036	33,407	50,847
Domate	15,020	15,195	14,696	20,587	15,107	60,318	62,358	13,693	17,291
Spec	54,988	62,925	35,959	51,274	46,669	93,924	96,322	50,744	72,928
Lakër	18,938	25,012	15,424	19,041	27,895	22,988	23,154	13,975	21,924
Qepë	11,033	11,376	10,936	15,987	8,697	13,257	13,655	8,601	15,308

¹⁾ Vlerësim

Burimi: Vjetari statistikor 2015

Me perime është e mbjellur 3.7% e tokës së punueshme (6 689 ha). Perimet më të rëndësishme janë: specat, qepët dhe bostani. Speci konsiderohet si perimja më e rëndësishme pasi mbulon më shumë se 38% të tokës së mbjellë me perime.

Më shumë se një e treta e sipërfaqeve me perime janë të mbjellura me specat (38,2 % në vitin 2014). Prodhimi vendor mbulon rreth 90 % të konsumit dhe pjesa e mbetur mbulohet nga importi.

Pemëtaria

Spektori i fruta perimeve ka pasur një rritje pozitive gjatë viteve të fundit. Ai po kontribuon shumë në gjenerimin e të ardhurave dhe në rritjen e punësimit në zonat rurale. Megjithatë, Kosova vazhdon të dominohet nga eksporti për periudhat jashtë sezonit, fermerët vendas kanë filluar të bëjnë përpjekje të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të prodhimit dhe shtimit të sipërfaqeve të mbjella me fruta-perime.

Pothuajse të gjitha fermat kanë pemë frutore. Fermerët tradicionalë, të cilët kanë

më pak se 15-20 rrënjë, në më pak se 0.1 ha, përfaqësojnë 99% të prodhuesve dhe përbëjnë 69% të prodhimit lokal. Aktualisht janë mbjellë rreth 4,399 ha pemishte, nga të cilat, 3,520 ha janë plantacione me pemëtore. Numri i ekonomive bujqësore me pemëtore është 11,677, të cilat zënë mesatarisht 0.3 ha të fermës. Shumica e sipërfaqes së plantacioneve të pemëve është e kultivuar me mollë (56.1%) dhe kumbull (19.9%). Në Kosovë, numri i ekonomive bujqësore me vreshta është 6,242. Gjithsej, sipërfaqja e vreshtave është 3,215 ha dhe ekonomitë bujqësore me vreshta kultivojnë mesatarisht 0.52 ha.

Vlen për tu theksuar se kërkesa për fruta perime vitet e fundit është rritur me të paktën 10%.

Përveç mollës, kumbullës dhe rrushit të tryezës, përfshihen edhe dardhat, pemët bërthamore, pemët e imëta dhe dredhëzat. Dardhat kanë një potencial të mirë të kultivimit në Kosovë, dhe atë në rajonin e Ferizajt.

Molla dikur ka qenë prodhimi kryesor për Kosovën, që llogaritej mijëra hektar gjatë kohës së ish-Jugosllavisë. Tani pemishtet e mollës janë rreth 2,000 hektarë dhe kultivimi i përgjithshëm i saj është në rritje. Sipas vlerësimeve rendimentet e mollës mund të ndryshojnë nga 20 t/hektarë deri në më pak se 30 t/hektarë.

Gjithashtu dhe kultivimi i vreshtave zë një vend të rëndësishëm në Kosovë, pjesa më e madhe e prodhimit është e përqendruar në tre komuna në rajonin e Prizrenit, si dhe në Gjakovë me komunën e Rahovecit.

Në vitin 2014, Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë ka pasur 6,242 ekonomi bujqësore të angazhuara në kultivimin e hardhisë. Në përgjithësi është kultivuar 3,215 ha e vreshtave, nga të cilat 58.6% ishin rrush vere dhe 41.4% rrush tryeze.

Blegtoria

Një nën-sektor i cili vazhdimisht është vlerësuar shumë konsiderohet blegtoria. Fermat familjare me prodhimtari të lartë të punës mund të konkurrojnë në mënyrë të qëndrueshme duke e përmirësuar cilësinë dhe sasinë e bagëtive.

Kontributi i vlerës së prodhimit blegtoral në prodhimin bujqësor ka mbetur relativisht i qëndrueshëm me rreth 40% gjatë periudhave 2007-2013. Prodhimi blegtoral është i përbërë me rreth 40% nga mbarështimi blegtoral dhe 60% të produkteve shtazore që rezultojnë nga mbarështimi blegtoral.

Pas konfliktit, u vlerësua se mbi 50% e fondit blegtoral në Kosovë ishte humbur. Po ashtu edhe pjesa dërmuese e infrastrukturës blegtorale ishte dëmtuar. Kjo situatë shkaktoi mungesë të kafshëve dhe prodhimeve të kafshëve dhe importimin e tyre me qëllim të plotësimit të nevojave. Aktualisht situata është përmirësuar si nëpërmjet shtimit të bagëtive vendase, ashtu dhe nëpërmjet importit.

Numri i ekonomive bujqësore që merren me blegtori është 91,227. Ekonomitë bujqësore kanë gjithsej 281,747 Njësi Blegtorale (NjB). Përqindjen më të lartë të NjB-së e përbëjnë gjedhet me 71%, ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë shpezët me 17%, delet me 7%, dhe kafshët e tjera me 5%. Njësia Blegtorale mesatare për ekonomi bujqësore, që merren me blegtori ishte 3 NjB. Konsumi i mishit për kokë në Kosovë, vlerësohet të jetë 40.9 kg për person/vit⁶⁰. Mishi i cili konsumohet kryesisht është mishi i gjedhit, i ndjekur nga mishi i pulës. Për minoritetet jo-myslimane, mishi kryesor është mishi i derrit.

Më shumë se gjysma e gjedheve janë lopë qumështore (51%). Numri mesatar i gjedheve për ekonomi bujqësore është 3.9 krerë. Numri i ekonomive bujqësore, që mbajnë dele ishte 2,466. Gjithsej numri i deleve në Kosovë është 183,584. Numri

⁶⁰ Bazuar në numrin e bagëtive, importet e mishit dhe kafshëve të gjalla për therje

mesatar i derrave për ekonomi bujqësore është 5.4 krerë. Gjithsej numri i ekonomive bujqësore, që mbajnë shpezë ishte 67,150. Gjithsej numri i shpezëve në Kosovë ishte 2,691.831. Nga gjithsej numri i shpezëve, pulat (pulat për vezë, pulat e tjera, brojlerët, zogjtë e tjerë dhe gjelat) përbëjnë 96% të gjithsej numrit të shpezëve. Gjithsej numri i ekonomive bujqësore, që mbajnë bletë ishte 6,018. Ato kishin gjithsej 116,172 koshere bletësh. Numri mestar i koshereve të bletëve për ekonomi bujqësore është 19. Vetëm çdo e dyta ekonomi bujqësore ka në pronësi një traktor. Shumica e traktorëve janë më të vjetër se 20 vjet (73%).⁶¹

Sektori i Qumështit

Konsumimi i prodhimeve të qumështit në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 170 litra për person në vit.

Furnizimi nga fermat e Kosovës plotëson 76% të kërkesës totale për prodhimet e qumështit, importet janë 24%, ndërsa tregtia mbulon zbrazëtirën me djathin e importuar dhe qumështin UHT kryesisht nga Hungaria, por po ashtu edhe nga Bulgaria, Sllovenia dhe Turqia. Nga sasia totale e qumështit të prodhuar në vend (257,500 tonelata), vlerësohet se 117,383 tonelata konsumohen në fermë. 114,000 tonelata shiten në tregun e gjelbër lokal në formë të qumështit të papërpunuar ose djathit të bardhë. Fermerët tradicional dhe gjysmë-komercial kryesisht e shesin qumështin ose djathin e përpunuar shtëpiak në tregun e gjelbër. Vetëm 34,000 tonelata të qumështit të prodhuar shtëpiak përpunohen në industri. Kjo është rreth 10% e kërkesës së përgjithshme të tregut (nga gjithsej 339,500 tonelata). Janë gjithsej 19 qumështore.

⁶¹ Agjensioni i Statistikave të Bujqësisë, Regjistrimi i Bujqësisë 2014 - Rezultatet përfundimtare, 2014

Tabela 12: Tregjet

	Përqindja	Gjithsej (tonelata)	Prodhimi lokal	Importi
Konsumi shtëpiak	34.6%	117,383	117,383	
Tregu i Gjellbër	31,4%	106,598	106,598	
Tregjet e Përpunimit	34.0%	115,614	33,590	82,024
<i>Si pjesë e tregut total</i>	100.0%	339,595	257,571	82,024

Vërejtje: Konsumi shtëpiak i kalkuluar në mesatar të konsumit për banor

Prodhimet Kryesore

Prodhimet kryesore janë qumështi, jogurti, kosi dhe djathi i bardhë dhe kaçkavalli (djathi i fortë).

Aftësia Konkurruese

Kosova është një prodhues me kosto relativisht të lartë të prodhimit të qumështit. Kjo ndodh sepse kostoja e ushqimit për kafshë është e lartë, dhe gjedhet ushqehen kryesisht në stallë më tepër se në kullosa. Ushqimi i kafshëve përbën 70-80% të koston së përgjithshme të prodhimit të qumështit. Fermerët më të mëdhenj kanë një mesatare më të ulët të koston se sa fermat e vogla. Fermerët e vegjël shesin drejtpërsëdrejti në tregun e gjellbër me një çmimi prej 40 deri 50 cts/litër. Fermerët e mëdhenj iu shesin përpunueseve të qumështit dhe marrin rreth 26 cts/litër.

Siç është raportuar aktualisht 35% e kapaciteteve përpunuese të përpunimit të qumështit në Kosovë janë certifikuar nga HACCP. Kjo është konfirmuar edhe nga Shoqata e Përpunuesve të Qumështit në Kosovë (ShPQK), duke marrë parasysh se gjashtë përpunues më të mëdhenj të qumështit ose janë të certifikuar ose janë në procedurë të certifikimit.

Tabela 13: Kostoja e Prodhimit në Fermat Qumështore

	Tradicionale	Gjysmë-Komerciale	Komerciale
Litër/lopë/vit	3,607	4,467	5,000
Litër për lopë/ditë	12	15	16.5
Euro cent për litër (++€ cent)			
Kostoja e ushqimit të kafshëve	23	19	18
Kostot e tjera	4	3	3
Më pak shitje të viçit	-5	-4	-4
Kostoja e Prodhimit para punës	22	18	17
Kostoja e punës	7	5	4
Gjithsej kostoja përfshirë edhe punën	29	23	21

Burimet: Hulumtimi i ASPAUK-t (prill 2004) për fermat tradicionale dhe gjysmë- komerciale, ABU (Jan 2005) për fermat komerciale

Sektori i mishit dhe vezëve

Konsumi i mishit për kokë banori në Kosovë, vlerësohet të jetë 40.9 kg për person/vit⁶². Mishi i cili konsumohet kryesisht është mishi i gjedhit, i përcjellë nga mishi i pulës. Për minoritetet jo-myslimane, mishi kryesor është mishi i derrit.

Kostoja e prodhimit të mishit të gjedhit në fermat komerciale është €1.71 euro për kg të peshës së gjallë. Kjo supozon fitimin në peshë në ditë prej 1.19 kg. Çmimi i tregut është €1.70 deri 1.80 për kg të peshës së gjallë. Fitimi bruto për lopë është €23 pas 6 muajve të majmërisë. Në fermat tradicionale bruto fitimet janë më të ulëta. Prodhimtaria e mishit të gjedhit trajtohet si prodhim anësor i sektorit të qumështit, prandaj lopët për majmëri shiten shumë të reja. Gjithashtu në sektorin e mishit dhe produkteve të mishit, është vetëm një kompani e certifikuar nga HACCP, ndërsa asnjë nga prodhuesit /përpunuesit e vezëve nuk janë të certifikuar nga HACCP.

Sektori agro-përpunues

Megjithëse ekziston një mungesë e të dhënave statistikore dhe ekonomike në përpunimin e ushqimit, vlera e shtuar bruto në industrinë përpunuese të ushqimit është

⁶² Bazuar në numrin e bagëtive, importet e mishit dhe kafshëve të gjalla për therrije.

vlërësuar me rreth 2 % e BPV – së dhe lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e sektorit bujqësor primar.

Sektori i ushqimit në Kosovë ka parë investime të mëdha në objektet për përpunim gjatë dekadës së fundit, mbështetur nga qeveria dhe komuniteti i donatorëve ndërkombëtar. Kompanitë udhëheqëse kanë zhvilluar një gamë të gjerë produktesh. Rreth 800 kompani janë të regjistruara në sektorin e përpunimit dhe janë të punësuar mbi 6,000 njerëz, dhe mijëra të tjerë prodhues të vegjël.

Mundësitë e rritjes së përgjithshme për ushqimin dhe përpunimin e ushqimit në Kosovë janë dhuratë e madhe për tokën bujqësore, kushtet klimatike të favorshme, dhe avantazhet tradicionale krahasuese me hortikulturë, mbarështim të kafshëve, produkte të qumështit, produkte pyjore dhe të rrushit pra sigurojnë bazën e zhvillimit të përpunimit të pemëve dhe perimeve, produkteve të mishit, qumështit dhe verës. Rritja e konsumit për kokë banori në tregjet vendore për këto produkte do të gjenerojë mundësi të konsiderueshme dhe të vazhdueshme të biznesit kështu duke zvogëluar rritjen e importit të këtyre produkteve.

Përveç këtyre mundësive të zhvillimit, sektori i përpunimit të ushqimit pengohet nga strukturat e dobëta të prodhimit primar bujqësor. Pronësia e tokës së fragmentuar, kufizon aftësinë e përpunuesve dhe tregtarëve, për të ofruar mundësi biznesi në sasi të mjaftueshme, të prodhimeve primare bujqësore me standardet uniforme të cilësisë.

Rrushi dhe Vera

Përkundër traditës së gjatë në kultivimin e rrushit dhe prodhimin e verës dhe rakisë, Kosova ka mbetur prapa në mundësinë e saj që të prodhojë verë për tregun rajonal dhe atë ndërkombëtar. Sipërfaqja në prodhim gati është përgjysmuar që nga viti 1990.

Prodhimi i verës është përafërsisht 5-6 milion litra/për vit, nga e cila 20% mbushet

në shishe dhe pjesa e mbetur prej 80% tregtohet me shumicë.

Vreshtat mund të ndahen në ato që kanë varietete të rrushit për ngrënie, dhe ato që kanë varietete të rrushit për verë. Rrushi për ngrënie prodhohet edhe në sektorin privat e edhe në atë të NPSH-ve.

Konsumi për kokë banori i rrushit të freskët për ngrënie është modest, dhe vlerësohet të jetë 5.6 kg për person/vit. Konsumi i verës për kokë banori vlerësohet të jetë 6.5 litra për vit.

Është me rëndësi që vera (duke përfshirë alkoolin me bazë rrushi) kontribuon në masë të madhe në eksportet e Kosovës me 1.6 % të eksportit të përgjithshëm.

Biodiversiteti

Kosova ka një ekosistem dhe biodiversitet të pasur dhe 46,000 ha (4.27% të territorit) të saj janë të mbrojtura. Zonat përfshijnë një park kombëtar, 11 rezervate natyrore, 38 monumente natyrore dhe 2 peizazhe të mbrojtura. Më 1986, Kuvendi i Kosovës krijoi parkun kombëtar “Sharri”, që gjendet në jug të Kosovës, në kufi me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Parku kombëtar nëpërmes të zonave pyjore është i lidhur me Bjeshkët e Nemuna, Durmitorin si dhe Malin e Dinarkut. Këto zona, së bashku me parkun kombëtar, janë qendra endemike e biodiversitetit ballkanik. Ekzistojnë më shumë se 2,000 lloje të specieve endemike në Malin e Sharrit, dhe 26 prej tyre janë përfshirë në Listën e Kuqe të bimëve të kërcënuara të IUCN. Megjithatë në zonë ka shumë probleme në ruajtjen e biodiversitetit dhe sidomos të pyjeve. Kjo vjen për disa arsye:

- ❑ Prerja e paligjshme e drunjve;
- ❑ Personeli i pamjaftueshëm profesional;
- ❑ Dëmtimi i vazhdueshëm i pyjeve dhe tokës pyjore;
- ❑ Shumë ekonomi familjare varen ekonomikisht nga drunjët për djegie;
- ❑ Mundësi të kufizuara për investime kapitale;

- ❑ Gjuetia e paligjshme; dhe
- ❑ Konflikti në mes të prodhimtarisë së trungjeve dhe mbrojtjes së pyjeve.

Pyjet

Në bazë të Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve (IKP), 44.7 % të sipërfaqes së tokës në Kosovë mbulohet nga pyjet (481,000 ha), e cila është një rritje prej 5 % në krahasim me rezultatet nga vitet 2002/2003 IKP. Pyjet janë të përqëndruara në rajonet malore dhe ato kodrinore në perëndim (Pejë) lindje (Gjilan), dhe në Kosovën Jugore (Prizren dhe Ferizaj).

Shuma e përgjithshme prej 180,800 ha (38%) e pyjeve të Kosovës klasifikohet si pronësi private, ndërsa 295,200 ha (62%) klasifikohen si pyje publike.

Kullosat

Kosova është e pasur me burime të kullosave, të cilat sigurojnë një bazë të mirë për zhvillimin e blegtorisë, veçanërisht prodhimtarisë së dhenve. Kullosat paraqesin një bazë të rëndësishme për ushqimin e kafshëve dhe mbrojtjen e balancit në sistemin ekologjikë. Kullosat janë të rëndësishme pasi që ato:

- ❑ paraqesin ushqimin bazë për kafshë, veçanërisht gjatë sezonit veror;
- ❑ prodhojnë sanën si ushqim përmbajtësor i kafshëve;
- ❑ mund të përdoren nga të gjitha kategoritë e kafshëve, veçanërisht dhenve;
- ❑ paraqesin burimin më të lirë të ushqimit të kafshëve;
- ❑ lehtësojnë përdorimin racional të tokës që nuk është e punueshme (në zonat kodrinoro-malore);
- ❑ ofrojnë prodhimtari ekologjike për blegtorinë, që do të kishte potencial të lartë të eksportit; dhe
- ❑ ofrojnë turizmit rural, mundësi për zhvillim, dhe janë burim i disa bimëve të rëndësishme mjekësore.

Gjendja e ambientit

Gjendja e tanishme **agro-mjedisore** është me sa vijon:

- ❑ Nuk ka standarde minimale për “Praktikat e Mira të Bujqësisë” për Kosovën që janë në pajtim me kërkesat e BE-së;
- ❑ Nuk ka skema të certifikimi për bujqësinë organike;
- ❑ Nuk janë zhvilluar strategjitë vendore të bio-masës për bujqësi dhe pylltarin;
- ❑ Nuk ka strategji të qartë për eko-turizimin;
- ❑ Konsultimet në mes të agjencioneve të qeverisë dhe me komunat lidhur me çështjet agro-mjedisore janë të pakta (dobëta);
- ❑ Këshilltarët bujqësor kanë nevojë për më shumë informata mbi çështjet e agro-mjedisit;
- ❑ Nuk ka lidhje zyrtare në mes të këshilltarëve bujqësor dhe OJQ-ve agro-mjedisore vendore, qoftë në Kosovë ose ndër-kufitare;
- ❑ Vetëdije e pamjaftueshme e publikut rreth përfitimeve dhe sfidave të agro-mjedisit, pylltarisë dhe bio-diversitetit; dhe
- ❑ Shkollat nuk kanë material të mjaftueshëm arsimor që lidhet me këto çështje.

Prandaj, strategjia afat-mesme e **agro-mjedisit** 2014-20, është që ta kthej situatën me qëllim që të ndihmoj fermerët, ekonomin familjare rurale dhe konsumatorët.

Zonat e Mbrojtura

Zonat e mbrojtura janë krijuar me qëllim të mbrojtjes së natyrës dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, peizazhit dhe biodiversitetit, duke siguruar balancë ekologjike dhe përdorimin adekuat të burimeve natyrore, dhe duke krijuar kushtet për turizëm dhe hulumtime, si dhe për edukim ambiental.

Tabela 14: Zonat e mbrojtura në Kosovë, sipas IUCN

Lloji i zonës	Shkallëzimi IUCN	Nr. i zonës	Sipërfaqja (ha)	%
Rezervatet Natyrore	I	11	698.4	1,5
Parqet Kombëtare	II	1	39,000	84,5
Monumentet Natyrore	III	38	4,868	10,5
Peizazhet e mbrojtura	IV	2	1,681	3,5
Totali		52	46,247	100

Turizmi rural mund të zhvillohet duke siguruar se objektet kryesore të mbrojtura të rëndësisë historike dhe kulturore janë rehabilituar. Si gjithkund tjetër në Evropë, kjo do të lehtësojë rritjen e shërbimeve industriale të lidhura me turizmin – hotelerisë, restoranteve, udhëtimit, arteve, zanateve, etj. Nga më tepër se 2,800 monumente/lokacione që janë të regjistruara në Kosovë, 422 prej tyre janë të mbrojtura me ligj.

Shërbimet këshillimore

Shërbimet Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural janë themeluar në vitin 2004 dhe kanë funksionuar qysh atëherë. Në Kosovë, shërbimi këshillimor është i organizuar në shërbimet publike dhe private në tre nivele; në nivelin qendror, lokal dhe rajonal. Aktualisht shërbimi këshillimor është duke u riorganizuar për rajone strategjike dhe në sajë të të ligjit për shërbime këshillimore.

Një analizë e ofruesve publik të shërbimeve këshillimore tregojnë se implementimi i shërbimeve këshillimore të MBPZHR – së mbështet projektet e qendrës bazë të fermerëve dhe implementimin e strategjisë së shërbimeve këshillimore që nuk kanë qenë të suksesshme sepse këshilltarët komunal punojnë për ministrinë por paguhet nga komunat, që do të thotë se ata u raportojnë drejtorateve komunale por gjithashtu janë angazhuar me shumë aktivitete së bashku me punët e tyre. Për këtë arsye, sipas Ligjit për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Ligji Nr. 04/L-074-15 Shkurt

2012) 68 e këtyre agjentëve komunal do të transferohen nga kontrolli komunal në një divizion të ri të shërbimit të ekstensionit të vendit të themeluar në MBPZHR.

Shërbimet këshillimore tani janë duke u organizuar në nivel Departamenti me tre divizione dhe 37 Qendra Informative Këshilluese Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me një apo dy këshilltarë për qendër, kështu duke u rrit numri në 68 këshilltarë të trajnuar dhe përgatitur për të mbështetur fermerët me këshilla dhe informacione sipas kërkesave të tyre. Ekziston një plan vjetor në mënyrë që këshilltarët komunal të jenë vazhdimisht të siguruar me informacione të kërkuara për t'i ndihmuar fermerët.

Shërbimet këshillimore janë duke u përforcuar drejt kërkesave të fermerëve të orientuar në treg. Deri më sot shërbimet këshillimore për bujqësi dhe zhvillim rural janë siguruar përmes dy kanaleve kryesore:

- Këshilltarët nga sektori publik (MBPZHR dhe komunat);
- OJQ -të, këshilltarë vendor dhe ndërkombëtar, kooperativat, furnizuesit me inpute, shoqata të fermerëve veterinar, etj.

KAPITULLI IV

4. VLERESIMI I SITUATËS EKONOMIKE TE FERMAVE BUJQËSORE NË RAJONIN E PEJËS, PRIZRENIT DHE GJAKOVËS

4.1. Treguesit kryesorë të ekonomisë bujqësore

Rezultatet e Regjistrimit të Bujqësisë 2014 në Kosovë, tregojnë se janë gjithsej 130,775 ekonomi bujqësore, që merren me aktivitete bujqësore, në vitin bujqësor 2013-2014, nga të cilat 130,436 janë ferma familjare dhe biznese individuale, ndërsa 339 janë subjekte juridike.⁶³

Ekonomia bujqësore - në Kosovë klasifikohet në tre grupe të mëdha që janë:

1. Fermat bujqësore familjare
2. Subjektet juridike
3. Veprimtaritë bujqësore

Fermat bujqësore familjare - është një familje ose komunitet i njerëzve, anëtarët e së cilës janë të angazhuar në prodhimtari bujqësore, si aktivitet të tyre kryesor, kanë një menaxhim të vetëm dhe i përdorin mjetet e përbashkëta të prodhimit, të tilla, si: tokën, makinat, ndërtesat, etj. Një fermë bujqësore familjare prodhon produkte bujqësore kryesisht për vetkonsum (ushqim) dhe tepricat për shitje, për të plotësuar nevojat e familjes për mjete jetese (argëtim, shkollim etj), që nuk prodhohen në fermë si dhe për të blerë inpute për vazhdimin e aktivitetit bujqësor. Këto tipe fermash përfaqësojnë mbi 90 % të ekonomive bujqësore.

Subjektet Juridike - janë kooperativat bujqësore, bizneset individuale dhe format e

⁶³ Regjistrimi i bujqësisë 2014

tjera organizative, me statusin e subjektit juridik, që janë të regjistruara se kanë prodhimtari bujqësore, si aktivitet të tyre kryesor dhe ndërmarrjet, institucionet dhe subjektet e tjera juridike, të cilat janë të regjistruara në një aktivitet tjetër dhe të cilat kanë degë organizative ose pjesë të tjera organizative, ku kryhet prodhimtaria bujqësore si: ekonomitë bujqësore të instituteve kërkimore, komunitetet fetare, shkollat, burgjet, që merren me prodhimtari bujqësore; ekonomitë bujqësore, të cilat janë pjesë e ndërmarrjeve industriale etj.

Tabela 15 : Numri i fermave bujqësore, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, njësia blegtorale dhe njësia e punës vjetore(njpv)⁶⁴, sipas statusit ligjor të ekonomive, Kosovë, 2014

	Statusi ligjor i Ekonomive		
	Ekonomitë bujqësore	Ferma familjare dhe bizneset individuale	Subjektet Juridike
	Numri	Numri	Numri
Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)	130,775	130,436	339
Njësia Blegtorale	413,635	405,429	8,206
Njësia e Punës Vjetore	281,747	270,668	1,078
	86,620	84,221	2,399

Burimi: Regjistrimi i bujqësisë 2014

Subjektet Juridike kanë kontribuar me më pak se 0.2% në numrin e ekonomive bujqësore, ndërsa 2% në sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore, 4% në Njësitë Blegtorale (NjB) dhe 2.8% në Njësitë e Punës Vjetore (NjPV)

Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës për prodhimtarinë bujqësore, në vitin 2014, ishte 413,635 hektarë. Kjo është 41.8% e gjithsej sipërfaqes së tokës në Kosovë. Shumica e fermave bujqësore kanë në pronësi prej 0.5- 1 ha të tokës së punueshme, ato përbëjnë 35.5% të numrit të fermave bujqësore.

Ndërsa ato që kanë 2-3 ha të sipërfaqes të shfrytëzuar të tokës bujqësore janë

⁶⁴ 1800 ore pune = me 1 njësi pune vjetore (NjPV)⁵

23.3%.

Prej gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, pjesa më e madhe i takon livadheve dhe kullotave (54.3%). Një karakteristikë e rëndësishme në Kosovë është shfrytëzimi i tokës së përbashkët, që përfshin livadhet e kullotat.

Nga toka e punuar 43.6% së tokës bujqësore (180,381 ha), kultura që zë pjesën më të madhe të tokës së punuar është gruri (50.3%), i pasuar nga misri (19.4%). Me perime është e mbjellur 3.7% e tokës së punueshme - arave (6,689 ha). Perimet më të rëndësishme janë: speci, qepa dhe shalqiri. Në mesin e perimeve, më shumë se 38% e tokës së mbjellur është me specia. Janë gjithsej 4,399 ha pemishte. Nga kjo, 3,520 ha janë plantacione të pemëve. Numri i fermave me plantacione të pemëve është 11,677. Sipërfaqja mesatare me plantacione të pemëve është mesatarisht 0.3 ha. Shumica e sipërfaqes së plantacioneve të pemëve është e kultivuar me mollë (56.1%) dhe kumbull (19.9%). Në Kosovë, numri i fermave me vreshta është 6,242. Gjithsej, sipërfaqja e vreshtave është 3,215 ha dhe madhësia mesatare me vreshta është mesatarisht 0.52 ha. Nga gjithsej sipërfaqja e kultivuar me vreshta, 58.6% e sipërfaqes është e kultivuar me rrush për prodhimin e verës.

Sipërfaqja e ujitur në Kosovë është 10.5% (43,491 ha). Kulturat më të ujitura në vitin 2014 ishin misri kokërr dhe misri i gjelbër (foragjer), që përbëjnë 27.2% të gjithsej sipërfaqes së ujitur. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore është ujitur nga ujërat sipërfaqësore (përrua, lum, liqe), 38.4%, dhe nga hidrosistemi, 31.7%.

Numri i fermave që merren me blegtori ishte 91,227 dhe kanë gjithsej 281,747 njësi blegtorale (NjB). Njësia blegtorale mesatare për fermë, që merren me blegtori është 3 NjB. Përqindjen më të lartë të NjB-së e përbëjnë gjedhet me 71%, ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë shpezët me 17%, delet me 7%, dhe kafshët e tjera me

5%. Numri mesatar i Njesisë Blegtorale për hektar të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore është 0.7.

Gjithsej numri i fermave që mbajnë gjedhe ishte 66,589. Ato kanë mbajtur gjithsej 261,689 krerë të gjedheve. Më shumë se gjysma e gjedheve janë lopë qumështi (51%). Numri mesatar i gjedheve për ferme është 3.9 krerë.

Numri i ekonomive të fermave që mbajnë dele ishte 2,466. Gjithsej numri i deleve në Kosovë është 183,584. Prej gjithsej numrit të deleve, 146,924 janë dele për mbarështim. Fermat me 200 krerë dele e më shumë përbëjnë 9.7% të gjithsej numrit të fermave, që mbajnë dele. Këto ekonomi marrin pjesë me 44.1% në gjithsej numrin e deleve. Numri mesatar i deleve për një fermë është 63.9 krerë. Gjithsej numri i fermave, që mbajnë dhi është 2,221, të cilat mbajnë 28,430 krerë dhi. Numri mesatar i dhive për mbarsim për fermë është 11.3 krerë.

Gjithsej numri i fermave, që mbajnë derra ishte 6,302 dhe gjithsej numri i derrave në Kosovë ishte 34,188 krerë. Numri mesatar i derrave për fermë është 5.4 krerë.

Gjithsej numri i fermave që mbajnë shpezë ishte 67,150. Gjithsej numri i shpezëve në Kosovë ishte 2,691.831.

Gjithsej numri i fermave që mbajnë bletë ishte 6,018. Ato kishin gjithsej 116,172 koshere bletësh. Numri mesatar i koshereve të bletëve për fermë është 19.

Vetëm një në dy ferma ka në pronësi një traktor. Shumica e traktorëve janë më të vjetër se 20 vjet (73%).


Numri i përgjithshëm i personave të angazhuar në bujqësi në Kosovë është 362,700 persona. Kontributi i përgjithshëm i tyre në punë bujqësore ishte 86,620 Njësi të Punës Vjetore. Vlera mesatare e NjPV për fermë është më e vogël se 1 (0.7 NjPV për EB). Vlera mesatare e NjPV-së për hektar të sipërfaqes së tokës bujqësore është

0.21 NjPV. Vlera mesatare e NjPV-së për Njësi të Blegtorisë është 0.31 NjPV.

Mosha mesatare e kryefamiljarëve që konsiderohen edhe menaxherët e fermës familjare është 52 vjeç, ndërsa në mesin e anëtarëve të familjes që punojnë në fermë dominojnë femrat. Niveli i shkollimit të fuqisë punëtore bujqësore është i ulët, më shumë se 95% e menaxherëve kanë vetëm përvojë praktike në bujqësi.


Fermtat bujqësore në Kosovë karakterizohen nga sipërfaqja e kufizuar e tokës së punueshme dhe nivel të lartë të fragmentimit. Në mesatare fermtat kanë më shumë se katër parcela dhe nganjëherë këto të fundit janë të vendosura edhe larg nga njëra-tjetra. E klasifikuar sipas literaturës ferma me këto tipare është kryesisht fermë familjare bujqësore

Grafiku 5: Paraqitja në % e fermave bujqësore




Burimi: Raporti i Gjellbër, 2015

Grafiku 6: Numri i fermave bujqësore në % ndaj totalit




Burimi: Raporti i Gjellbër, 2015

Grafiku 7: Paraqitja në % e fermave blegtorale



Burimi: Raporti i Gjellbër, 2015

Grafiku 8: Numri i fermave blegtorale në % ndaj totalit



Burimi: Raporti i Gjellbër, 2015

Në kushtet aktuale të zhvillimit të bujqësisë në vendin tonë, ku fermat në kuptimin e mirëfilltë të fjalës sapo kanë nisur të stabilizohen si të tilla, realizimi i studimit “**Tipet e Fermave Bujqësore në Kosovë dhe konkurrueshmëria e tyre në treg**” ka për qëllim futjen e metodave të reja efektive në menaxhimin dhe drejtimin e fermës si një e tërë, me të gjithë sektorët e saj përbërës: prodhime bujqësore (bimët e arave, perime, foragjere, etj), prodhime blegtorale si dhe menaxhimin e punës për të pasur një fermë me aktivitet të qëndrueshëm dhe rentabil.

Ky studim do të mbështes prioritetet e programit të Qeverisë për zhvillimin e bujqësisë, ku drejtim parësor është zhvillimi i zonave rurale dhe zbutja sadopak e varfërisë në këto zona nëpërmjet rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral nga një përdorim më i mirë i burimeve që disponojnë vet fermat.

Studimi do të analizojë tipologjinë dhe karakteristikat e fermave bujqësore në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit e posaçërisht në rajonin e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, të cilët janë prodhuesit kryesorë të produkteve bujqësore në Kosovë

Tabela 16: Ekonomitë Bujqësore sipas statusit ligjor, sipas komunave, Kosovë, 2014⁶⁵

Rajoni/ Komuna	Ekonomitë bujqësore - Gjithsej				Ekonomitë bujqësore dhe familjare individuale dhe bizneset	
	Numri i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)	Njësitë blegtorale	Njësitë e Punës Vjetore	Numri i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)
PEJË	15,543	56,626.37	42,233	11,562	15,492	54,735.32
Istog	5,063	20,653.91	14,745	4,080	5,051	19,940.37
Klinë	4,442	14,947.55	10,588	2,382	4,423	14,175.59
Pejë	6,038	21,024.91	16,900	5,100	6,018	20,619.36
PRIZEREN	23,554	80,647.22	47,562	13,735	23,487	78,686.04
Dragash	2,711	27,662.24	7,029	1,695	2,697	26,642.21
Malishevë	6,583	14,908.73	14,643	3,018	6,571	14,608.42
Mamushë	491	1,229.19	944	622	486	1,036.69
Prizren	6,580	21,777.10	14,477	4,647	6,557	21,656.38
Suharekë	7,189	15,069.96	10,469	3,752	7,176	14,742.34
GJAKOVË	1,515	47,181.96	41,784	16,789	15,120	45,952.60
Deçan	3,936	10,043.88	9,663	2,781	k	9,809.97
Gjakovë	5,483	21,378.34	20,293	5,980	5,467	21,126.23
Junik	343	1,298.16	1,002	413	k	1,254.48
Rahovec	5,390	14,461.58	10,826	7,615	5,380	13,761.92

Burimi: Regjistrimi i bujqësisë 2014

Pra nga total sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 413,635.16 ha sa ka në Kosovë këto rajone përfshijnë (rajoni i Pejës me 56,626.37 ha, rajoni i Prizrenit me 80,647.22 ha dhe rajoni i Gjakovës 47,181.96 ha), apo 184,455.55 ha nga totali.

Ndikimi ekonomik do të jetë i dukshëm në fermën që do të zbatojë këtë sistem menaxhimi sepse të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat do të jenë të planifikuara që në fillim të vitit, plehurat kimike dhe pesticidet do të përdoren në mënyrë rreptësisht të kontrolluar, do të regjistrohen në mënyrë kronologjike dhe do të përdoren ato që janë absolutisht të domosdoshme. Studimi do të ketë një ndikim të veçantë në fushën sociale pasi më pak shpenzime dhe më shumë të ardhura do të ndikojnë në nivelin ekonomik të fermave në veçanti dhe të shoqërisë në përgjithësi.

⁶⁵ Regjistrimi i bujqësisë, 2014

Në vendin tonë janë bërë studime për klasifikimin e fermave bujqësore duke u nisur nga madhësia e saj e mbështetur kryesisht në sipërfaqen e tokës dhe sasinë e prodhimit dhe jo nga mënyra e menaxhimit. Deri më sot, në vendin tonë, nuk janë kryer studime të mirëfillta për menaxhimin e fermave në përgjithësi dhe aq më pak për fermat e vogla (familjare) që janë dominuese në vendin tonë, përveç studimeve të njëanshme, bujqësore apo blegtorale, për shembull për qarkullimet bujqësore, ndikimin dhe përdorimin e plehrave organike dhe kimike, përdorimin e pesticideve, ujitjes etj, por asnjë studim nuk ka pasur objekt të tij studimin e efektivitetit të parë nga tipologjia e saj, nëse janë ferma të cilat prodhojnë për vet konsum, janë gjysmë komerciale apo komerciale, cili është raporti i tyre me mundësitë, tregun, qëndrueshmërinë, ambientin etj

Studimi i tipologjisë së fermave dhe mundësisë së konkurrueshmërisë në treg, na jep mundësin për një menaxhim më kompleks të tokës, produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe vlerave materiale e monetare, ruajtjes së ambientit dhe ushqim të sigurt. Primare në këtë studim do të jenë ferma me një kapacitet financiar të qëndrueshëm. Ndikimi ekonomik do të jetë i dukshëm në fermën që do të zbatojë këtë sistem menaxhimi sepse të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat do të jenë të planifikuara që në fillim të vitit, plehrat kimike dhe pesticidet do të përdoren në mënyrë rreptësisht të kontrolluar, dhe do të kryhen vetëm ato shpenzime që janë absolutisht të domosdoshme.

Në Kosovë askush nuk shqetësohet për këtë, por, nëse në një të ardhme të afërt synojmë të prodhojmë produkte bujqësore dhe blegtorale jo vetëm për tregun brenda vendit, por edhe për eksport, në vendet e Bashkimit Evropian dhe të gjithë botës atëherë dihet përmbajtur standardeve. Këto standarde fillojnë që në fermë, një ndër të cilët është dhe siguria ushqimore, atë mund ta sigurojmë kur punojmë të gjithë bashkë, duke nisur që në fermë. Pasi jo vetëm kafshët, por edhe njerëzit, janë çfarë ata konsumojnë. Në kushtet e fermave të sotme kosovare, kur vendi dhe ekonomia jonë duhet të integrohet me ekonominë evropiane dhe botërore, është shumë e domosdoshme që të ndërmerret një program i tillë në ndihmë të fermave bujqësore dhe të ekonomisë në tërësi. Në kushtet e

sotme, zhvillimi i bujqësisë po merr vlerësimin e duhur nga fermerët të cilët e shikojnë zhvillimin e bujqësisë si një shtysë në rritjen e të ardhurave, në sigurimin e ushqimeve dhe në rritjen mirëqenies së tyre.

4.2. Situata ekonomike e fermave në Rrafshin e Dukagjinit

Kosova ndahet në 7 rajone dhe 34 komuna, me Prishtinën si kryeqytet ndërsa rajonet tjera janë: Ferizaj, Gjakova, Gjlani, Mitrovica, Peja dhe Prizreni. Ekzistojnë tre rajone të mëdha në rrafshin e Dukagjinit: rajoni i Pejës në veri, Gjakovës në mes dhe Prizrenit në jug Rrafshi i Dukagjinit shtrihet në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës, në mes të malit Mokna në veri dhe malit Sharr në jug dhe përfshinë sipërfaqen 4,669 km² do të thotë rreth 42.8 % të sipërfaqes totale të Republikës së Kosovës. Në rrafshin e Dukagjinit ndodhen 13 njësi administrative komunale: Klina, Istogu, Peja, Deçani, Juniku, Gjakova, Rahoveci, Malisheva, Suhareka, Mamusha, Prizreni dhe Dragashi.

Tabela 17: Ndarja rajonale e Rrafshit të Dukagjinit dhe komunat e përfshira në studim

RAJONI	KOMUNA
PEJA	Peja
	Istogu
	Klina
GJAKOVA	Gjakova
	Deçani
	Rahoveci
	Juniku
PRIZRENI	Prizreni
	Dragashi
	Suhareka
	Malisheva
	Mamusha

Burimi: Analizë e autorit

Lidhja komunikative (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore) është mjaft e zhvilluar në të gjitha drejtimet. Rrugët magjistrale më të rëndësishme janë: magjistralla M9 (Prishtinë-Pejë), rruga rajonale (Pejë- Mitrovicë) dhe rruga rajonale Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren. E rëndësishë së veçantë është edhe autostrada “Ibrahim Rugova” Morinë–Merdar. Rrjeti hekurudhor është në drejtimin Fushë Kosovë–Klinë, pastaj në Klinë ndahet drejtimi për Prizren dhe Pejë. Rrafshi i Dukagjinit karakterizohet nga tre njësi themelore: malore, kodrinore – malore dhe tarracat lumore. Në mes të masivëve malorë shtrihet Ultësira e Dukagjinit e cila është elementi më karakteristik, gjeomorfologjik dhe orografik i Rrafshit të Dukagjinit.

Harta 3.Shtrirja gjeografike e Rrafshit të Dukagjinit



Burimi: MAPH-Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

4.3. Rajoni i Prizrenit

3.3.1. Përshkrimi i situatës ekonomike në rajonin e Prizrenit

Rajoni i Prizreni radhitet si rajoni më i madh për nga madhësia në Kosovë pas rajonit të Prishtinës. Prizreni është një qytet historik që shtrihet përgjatë Lumëbardhit, nën malet e Sharrit. Kufizohet me Shqipërinë në perëndim, Dragashin në jug, Maqedoninë në juglindje, Shtërpçën në lindje, Suharekën në verilindje, Rahovecin në veri, Mamushën në verilindje dhe Gjakovën në veriperëndim. Rajoni i Prizrenit përfshinë këto komuna: Mamushën, Suharekën, Dragashin dhe Malishevën.

Prizreni ka një lokacion të mirë dhe të favorshëm gjeografik, afërsia me Shqipërinë dhe lidhja e tij e mirë e transportit përmes autostradës, i kanë dhënë një rol të rëndësishëm në biznesin dhe tregtinë rajonale. Prizreni përfshinë një sipërfaqe prej 63,780.67 ha. Kjo është e barabartë me rreth 5.94% të territorit të përgjithshëm të Kosovës dhe përafërsisht 182,449 banorë⁶⁶ (Profili Komunal i Prizrenit, 2013).

Foto 1: Pamje e bjeshkëve të Prizrenit



Burimi: Faqja zyrtare e komunës së Prizrenit

⁶⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, Vlerësim Popullsia e Kosovës 2014

Prizreni në përgjithësi ka një topografi të valëzuar ku lartësia mbidetare sillet prej 300 m – 2600 m, kurse qyteti i Prizrenit ndodhet në sipërfaqen e rrafshët, topografia kodrinore vërehet në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës. Lartësia mbidetare e qendrës së qytetit është 400 m. Pozita gjeografike e Prizrenit ofron kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrinë e ushqimit dhe turizmin.

Rrafshina e Prizrenit është një sipërfaqe që mbulon 14,000 ha apo 22% të Komunës së Prizrenit. Rrafshina përfshinë edhe fshatrat vijuese: Atmaxha, Caparci, Krusha e Vogël, Landovica, Lutogllava, Malësia e Re, Mamusha, Medveci, Novaka, Pirana, Randobrava, Sërbica e Epërme, Sërbica e Poshtme, Smaçi, Shpenadia, Trepetnica dhe Velezha si dhe qendrën e Prizrenit⁶⁷.

4.3.1. Situata sociale - ekonomike e rajonit të Prizrenit

Komuna e Prizrenit është një nga lokacionet që posedon resurse të mjaftueshme ujore, nëpër Prizren kalon lumi Drini i Bardhë, lumi më i gjatë dhe më i rëndësishëm me gjatësi 111 km, lumi kalon nëpër Prizren duke vazhduar rrugën e tij kah Shqipëria dhe Deti Adriatik.⁶⁸ Po ashtu në Prizren kalon lumi Vardar dhe Toplluha, pra ky rajon llogaritet si pjesë e pellgut ujqor të lumit Drini i Bardhë dhe pellgut ujqor, përkatësisht Detit Adriatik dhe Detit Egje. Prizreni është i pasur me rezervat e ujërave nëntokësore si dhe ujërave sipërfaqësore që formojnë një potencial të rëndësishëm hidroenergjetik.

⁶⁷ Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili I Komunës së Prizrenit)


⁶⁸ Agjensioni i Statistikës së Kosovës, 2013

Harta 4: Shtirirja gjeografike e komunës së Prizrenit




Burimi: Plan i Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Harta 5: Plan i zhvillimor komunal i Prizrenit



Burimi: Plan i Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Harta 6: Rajonet gjeografike të Komunës së Prizrenit



Burimi: Plan i Hapësinor i Kosovës 2010-2020

Zhvillimi socio- ekonomik është njëri prej prioriteteve kryesore të komunës së Prizrenit, ku në bazë të Planit Zhvillimor i Komunës së Prizrenit 2013-2015, (Gusht 2012), organet përfaqësuese vetëqeverisëse kanë përfshirë një planifikim strategjik ku janë paraparë zhvillimet e sektorëve të ndryshëm duke i dhënë prioritet zhvillimit të bujqësisë, industrisë ushqimore, turizmit dhe zhvillimit rural krahas sektorëve tjerë socio-ekonomik.

Zhvillimi ekonomik është njëra nga katër fushat tematike të studiuara në kornizën e procesit të përpilimit të Planit Hapësinor me qëllim të përshkrimit të gjendjes aktuale hapësinore me qëllim të përshkrimit të gjendjes aktuale ekonomike në Kosovë. Çështjet kryesore që kanë të bëjnë me kornizën e zhvillimit ekonomik janë: bujqësia, industria, tregtia dhe turizmi (Profili i Kosovës 2004). Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit është po ashtu i fokusuar në 4 sektorë kryesor: 1. Industria 2. Biznesi Privat 3. Turizmi dhe 4. Bujqësia dhe zhvillimi rural

4.3.1.1 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Studimi i fundit për moshën në Kosovë është kryer nga United Nations Population Fund (UNFPS) në vitin 2003. Sipas këtij studimi, 33 % e popullatës në Kosovë janë në moshën 0-14 vjeç, 61 % i takojnë moshave 15-64 vjet dhe 6 % janë të moshuarit mbi 65 vjet. Dominimi i moshës së re e cila rezulton nga shkalla e lartë e natalitetit është një nga karakteristikat kryesore të Kosovës. Studimi i fundit për grup moshat në Prizren daton nga regjistrimi i vitit 1991 nga e cila del se Prizreni ka karakteristika pak a shumë të ngjashme me ato të Kosovës. Megjithatë, në Prizren del se 36,9 % janë të moshës 0-14 vjet dhe 4.9 % mbi moshën 65 vjeçare

Tabela 18: Popullsia sipas grup moshave në komunën e Prizrenit

Popullsia sipas grup moshave	Popullsia	%
0-14	65,948	36.9
15-64	104,109	58.3
65 dhe mbi	8,685	4.9
Totali	178,723	100.00

Burimi: Plan i Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Në bazë të statusit të punësimit dhe papunësisë dhe të dhënave të fundit lidhur me punësimin në Kosovë që datojnë nga viti 2008, të punësuar 26,5 % e popullatës në moshë pune është e punësuar, kurse 20,4 % është e papunë. Shkalla e papunësisë (përqindja e të papunësuarve në fuqi punëtore) është 43, 6% (Kosova në Shifra, 2008).


Në komunën e Prizrenit, sipas të dhënave të përafërta të ofruara nga Qendra për Punësim (Profili Komunal i Prizrenit, 2007), 21,271 banorë janë të punësuar; 20.40% (4,341) të punësuar në sektorin shoqëror dhe 22.50% (4,787) punëtorë të punësuar në sektorin publik.

Përveç kësaj në bujqësi janë të angazhuar rreth 12,000 persona. Profili Komunal i Prizrenit (2007) thekson se numri i të punësuarve është më i lartë për shkak të punëve sezonale të shitësve ambulant, punëtorëve të ndërtimtarisë, zejtarëve etj. Kjo nënkupton se ekziston fenomeni i punësimit të përkohshëm dhe ilegal.

Tabela 19: Punësimi në bujqësi në komunën e Prizrenit

Njësia Administrative	Nr. i të punësuarve në Bujqësi	Në %
Prizren	146	12,7
Has	89	7,8
Kabash	477	38,9
Lume	86	7,5
Anadrini	214	18,7
Verrini	65	5,8
Zhupa	99	8,6
Totali	1,176	100

Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Grafiku 9: Punësimi në bujqësi në komunën e Prizrenit

Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)


Niveli i lartë i papunësisë rezulton kryesisht për shkak të numrit të madh të të rinjve në tregun e punës. Në Kosovë grup mosha 16-24 vjeç përbën shumicën e të papunëve. Sipas Raportit për Zhvillim, të rinjtë përfaqësojnë 63% të numrit total të papunëve.

Tabela 20: Papunësia e regjistruar sipas gjinisë në Prizren

Grup mosha	Meshkuj	Femra	Totali
15-24	3,630	4,465	8,095
25-39	5,464	6,741	12,205
40-54	3,498	3,478	6,976
55 dhe më të vjetër	1,534	1,766	3,300
Total	14,126	16,450	30,576

Burimi: Qendra Rajonale e Punësimit Prizren, 2009

Të dhënat e fundit të Qendrës Rajonale të Punësimit (2009) theksojnë numrin e lartë të papunëve në Prizren ashtu sikur edhe në Kosovë e përbëjnë grup mosha prej 25-39 vjet përbën rreth 40 % të numrit total të papunëve. Të dy gjinitë kanë numër të madh të papunëve sidomos të gjinia femërore është e theksuar te të gjitha grup moshat.

Grafiku 10. Papunësia e regjistruar sipas grup moshave në Prizren

Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)


Shpërndarja e kualifikimeve të të papunësuarve në Prizren tregon se 71% e të papunëve janë të pakualifikuar. Të papunët e kualifikuar dhe ata me shkollë të mesme përbëjnë afro 25% të totalit prej 30,576 personave. Në përgjithësi meshkujt janë më

shumë në numër në krahasim me femrat duke e pasur parasysh kualifikimin.

Tabela 21, Kualifikimi i të papunëve sipas gjinisë dhe kualifikimit në Prizren

Kualifikimi	Meshkuj	Femra	Totali
Të pa kualifikuar	8,424	13,481	21,905
Gjysmë të kualifikuar	681	331	1,012
Të kualifikuar	1,914	390	2,304
Shkolla e mesme	2,881	2,140	5,021
Shkolla e lartë	94	49	143
Universiteti	132	59	191
Total	14,126	16,450	30,576

Grafiku 11: % e të papunëve sipas gjinisë dhe kualifikimit



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Duke pasur parasysh faktin se gjysma e popullatës së Kosovës është nën moshën 25 vjeçare, arritja arsimore është një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit njerëzor. Mungesa e të dhënave të azhurnuara zyrtare (duke përfshirë grup moshat) e vështirëson matjen e efikasitetit të shërbimeve arsimore.

Treguesit e strukturës ekonomike janë: bujqësia, prodhimtaria, ndërtimtaria, tregtia, turizmi dhe aktivitetet financiare. Komuna e Prizrenit është e pasur sa i përket resurseve natyrore siç janë toka e pëlleshme, kullotat dhe livadhet, resurset ujore dhe klimës të butë. Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës së Prizrenit është 63.986 ha. 53% nga kjo sipërfaqe është sipërfaqe është tokë bujqësore, 39% janë pyjet (Shfrytëzimi i tokës, PZHKP 2009)

dhe 8% të tjera.

Në bazë të analizës së strukturës ekonomike zhvillimi bujqësor dhe rural, më tepër se 50% e popullatës së Prizrenit jeton në viset rurale. Andaj, sektori bujqësor mbetet një nga burimet kryesore të punësimit dhe të ardhurave. Prizreni ka qenë i njohur për kultivimin e pemëtarisë, perimtarisë dhe verërave. Në kuadër të strategjisë afatgjate, Drejtoria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural në vazhdimësi është duke zbatuar politikat sektoriale zhvillimore me projekte investuese kapitale, në ngritjen dhe përkrahjen profesionale të fermerëve nëpërmjet këshillimeve, trajnimeve, seminareve, praktikave dhe metodave të avancuara në lami të caktuara të bujqësisë. I tërë aktiviteti i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural është zhvilluar sipas sektorëve: Sektorit të Bujqësisë, Sektorit të Zhvillimit Rural dhe Sektorit të Pylltarisë. Objektivat kryesore të zhvillimit rural dhe bujqësor brenda zhvillimit të përgjithshëm ekonomik përmes prodhimeve integruese janë:

- ✓ Ulja e varfërisë me rritje të qëndrueshme bujqësore dhe prodhime
- ✓ Rritja e kualitetit dhe sigurisë në ushqim
- ✓ Përmirësimi i marketingut të prodhimeve bujqësore
- ✓ Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve (toka, uji, biodiversiteti)⁶⁹

4.3.2. Zhvillimi i sektorit të Bujqësisë në Rajonin e Prizrenit

Klasifikimi i tokave në bazë të bonitetit është analizuar në pesë fusha si: mbjellja e perimeve, mbjellja e drithërave, mbjellja e frutave, pyjet dhe tokat barishte. Duke pasur parasysh këtë ndarje, rajoni i Prizrenit është i përshtatshëm për kultivimin e perimeve siç janë: domatja, speci, lakra, karota, trangulli, spinaqi dhe kultivimi i perimeve në sera. Toka është po ashtu e përshtatshme për kultivimin e drithërave si luledielli, misri, elbi,

⁶⁹ Profili Komunal i Prizrenit,

tërshëra dhe thekra. Kushtet janë të volitshme për themelimin e parkut botanik dhe kopshtit zoologjik. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë ndarjen e tokës bujqësore të komunës së Prizrenit në tetë kategori në bazë të këtyre karakteristikave: lokacionit, pjerrësisë, thellësisë, cilësisë dhe reaksionit të tokës. Në bazë të kësaj ndarje Prizreni nuk ka tokë të klasit të parë. 30% e sipërfaqes totale i takon klasit të dytë, tretë dhe katërt të cilat ndodhen në rrafshinën e Prizrenit. Këto sipërfaqe janë të pëlleshme. Rrafshina e Prizrenit është e rrethuar me tokën e klasit të gjashtë në lindje dhe klasit të shtatë në jug. Toka e klasit të tetë shtrihen mbi Malet e Sharrit dhe Pashtrikut dhe nuk janë për tu përdorur për tokë bujqësore, por përdoren si kullota.

Tabela 22: Klasifikimi i tokës bujqësore⁷⁰

Klasa bujqësore	Sipërfaqja (ha)	Përqindja (%)
II	6,621	10,37
III	4,973	7,79
IV	8,099	12,68
V	1,108	1,73
VI	15,881	24,86
VII	15,372	24,06
VIII	11,823	18,51
Total	63,877	100,00

Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor


⁷⁰ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Tabela 23: Struktura e shfrytëzimit të tokës bujqësore në rajonin e Prizrenit

	ha	%
Tokë e pëlleshme	16,398,83	25,71
Kopshtet	72.50	0,11
Pemishtet	726,66	1,14
Vreshtat	1,297.11	2,03
Barishtet	4,795.46	7,52
Kullotat	14,096.83	22,10
Pyjet	20,046.71	31,43
Sipërfaqet Bujqësore Sub Totali	57,434.10	90,05

Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Harta 7: Klasifikimi i tokës bujqësore⁷¹



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Roli i bujqësisë në zhvillimin ekonomik të Kosovës është i konsiderueshëm edhe përkundër tokës së dobët bujqësore në krahasim me Evropën. Kontributi i bujqësisë në GDP ndryshon prej 22% (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+) dhe 30% (Profili i Komunës së Prizrenit). Në Profilin e Kosovës vlerësohet se 2/3 e punëtorëve janë të

⁷¹ Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit 2013-2025

angazhuar në bujqësi dhe në vitin 2013 ajo ka marrë pjesë me 18 % në vlerën e eksportit.

Në Prizren, përafërsisht më shumë se 50% e popullatës jeton në viset rurale. Prandaj sektori i bujqësisë është një nga burimet më të rëndësishme të punësimit dhe të hyrave. 25 % e tokës së Prizrenit është e pëlleshme me një sistem të vaditjes që mbulon 3.300 ha (Profili Komunal i Prizrenit, 2007) . Prizreni, në Jugosllavinë e dikurshme ka qenë i njohur për frutat e saja, perimet dhe verën. Në Prizren punojnë katër ndërmarrje për prodhime qumështore me kapacitetet e limituara prodhuese. Prodhimet qumështore, e sidomos djathi i Sharrit është i njohur edhe përtej kufijve të Kosovës. Prodhimi i drithërave në Prizren është në nivel të kënaqshëm, respektivisht janë prodhuar 12.555 tone grurë dhe 15.040 tonë misër mesatarisht në vit.

Meqë ekziston një pjesë e madhe e Komunës që ka tokë të mirë bujqësore, prodhimtaria bujqësore bazohet në kultivimin e bimëve njëvjeçare. Mirëpo, jo të gjitha fshatrat kanë tokë pjellore bujqësore të mjaftueshme për këtë aktivitet. Fshatrat që kanë tokë pjellore por nuk shfrytëzohen për aktivitetet bujqësore, duhen të inkurajohen me projekte të cilat ofrojnë programe të prodhimit bujqësorë. Më pas, fshatrat të cilat kanë topografi malore dhe problemet me qasje të rrugëve, prodhimtaria bujqësore duhet të bazohet në blegtori, aktivitetet pyjore dhe vreshtari. Sipas raporteve kryesore sektoriale dhe vizita në teren (2013) ka treguar se blegtoria është aktivitet i rëndësishëm në fshatrat malore.

Sipas Profilit Komunal të Prizrenit, vreshtaria ka qenë dhe ende mbetet një aktivitet i rëndësishëm i Komunës së Prizrenit. Edhe pse kushtet klimatike për këtë aktivitet janë të shkëlqyeshme dhe Prizreni ka një traditë të lashtë në kultivimin e rrushit, mungon asistenca dhe investimet e duhura. Ndonëse, vreshtaria ka qenë dhe ende mbetet një potencial i rëndësishëm në prodhimtarinë bujqësore, nuk ka prodhimtari në 900 ha të vreshtave në pronësi shoqërore. Kjo lidhet me migrimin e popullatës nga fshatrat në qytete, mungesën e infrastrukturës rurale (rrugët fushore, investimet, pajisjeve bujqësore

etj.) dhe mungesës së kapitalit fillestar për të filluar aktivitetet bujqësore

Posaçërisht Fusha e Prizrenit që ka një pjerrësi prej 0-5% ka kushte të volitshme për prodhimin e kulturave siç janë: domatet, speci, lakra, karota, trangujt, spinaqi dhe drithërat si luledielli, misri, elbi, tërshëra dhe thekra. Cilësia e tokës në rajonin e Kabashit është e lartë dhe e përshtatshme për kultivimin e domateve, specit, patates, misrit, mollëve, dardhave, kumbullave etj, dhe përveç kësaj, ka shumë llojshmëri (kategori) të tokës bujqësore për prodhimin e perimeve edhe në rajonet e Anadrinisë, Vërrinit dhe rajonit të Hasit. Në rajonin e Kabashit mund të kultivohen edhe bimët mjekuese si kamomili, menta, lule Elbasani etj.

Po ashtu edhe struktura e tokës bujqësore në rajonin e Lumës është e përshtatshme për kultivimin e perimeve si lakra, patate, karota, trangujt, lulëlakër, qepë si dhe prodhimin e drithërave dhe bimëve mjekuese. Në lartësinë mbidetare mbi 1000 m në rajonin e Zhupës ka kushte të përshtatshme në rritjen e bimëve mjekuese si menta, kamomili dhe bimët tjera mjekuese, dhe po ashtu mund të kultivohen manaferrat, mjedrat, boronica që kanë vlera ekonomike.

Kultivimi i bimëve një vjeçare


Rritja e bimëve një vjeçare siç janë prodhimi i grurit, misrit dhe perimeve është një nga aktivitetet kryesore bujqësore në Komunën e Prizrenit. Pjesa më e madhe e grurit përpunohet në fabrikat e miellit në Xërxë, Mamushë dhe Lutogllave. Sipas profilin komunal të Prizrenit, Mamusha, Medveci, Krusha e Vogël dhe Pirana janë zonat kryesore për prodhimin e perimeve. Sipas PZHKP 2010- 2020 shpërndarja e aktiviteteve bujqësore tregon se shkalla e lartë e aktiviteteve bujqësore është në rajonin e Anadrinisë, Kabashit dhe Vërrinit, dhe shkalla më e ulët e aktiviteteve bujqësore është në rajonin e Zhupës me 3 fshatra.

Tabela 24: Sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimi në vitin 2013 komuna e Prizrenit

Nr.kulturave	Produkti	Sipërfaqja	Rendimenti	Prodhimi
		ha	Kv/ha	Ton
1	Gruri	3,200	35	11,200
2	Misri	3,700	37	13,690
3	Elbi	230	23	529
4	Tershera	55	21	115.5
5	Thekra	15	22	33
6	Perime	1,700	160	27,200
Gjithsej		7,200		52,767.5

Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Grafiku 12: Sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimi në vitin 2013, komuna e Prizrenit



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Bujqësia në komunën e Prizrenit karakterizohet nga një nivel i ulët arsimor i fermerëve, çka ka sjellë edhe probleme në menaxhimin e fermave bujqësore që janë kryesisht të tipit familjar. Ky nivel i ulët ka sjellë për pasojë mungesën e vizionit nga drejtuesit e fermave për tu përshtatur kërkesave të tregut, në mënyrë që ata të konkurrojnë në treg jo vetëm me sasi por me cilësi të produkteve origjinale e të traditës. Tabela e më poshtme paraqet nivelin arsimor të punonjësve në fermat bujqësore të kësaj komune, por


duhet të theksojmë që dhe pse mund të jetë dikush në familje me arsim të lartë drejtimi i fermës nuk behët nga ai/ajo por nga kryefamiljari (burri). Në këto kushte duhet një punë më e organizuar nga strukturat qendrore të komunës po dhe nga qeveria e Kosovës për krijimin e mundësive dhe lehtësirave për fermerët e kësaj komune për të qenë konkurrent në treg.

Tabela 25: Niveli arsimit të punonjësve në fermë komuna Prizren⁷²

Arsimi	%
Arsim fillor	69
Arsim i mesëm	23,7
Arsim i lartë	7,3
Gjithsej	100

Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)

Grafiku 13: Niveli arsimit të punonjësve në fermë komunën e Prizrenit



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit)


Kultivimi i drithërave në rajonin e Prizrenit

Sipas Raportit të Regjistrimit të Bujqësisë në Kosovë, 2014 dhe analizës së autorit në rajonin e Prizrenit ekzistojnë rreth 23,554 ekonomi bujqësore sipas statusit ligjor të komunave dhe 80,647.22 ha sipërfaqe e tokës së shfrytëzuar bujqësore. Nga kjo sipërfaqe 20,115.02 ha janë të kultivuara me drithëra. Nga sipërfaqja totale 15,770.81 ha (49%) janë drithëra kokërr ku vendin e parë 11,200.44 ha (34%) e ka gruri, misri me 3,867.96 ha (12%) duke vazhduar me kulturat tjera 1-2% si tërshëra 2%, fasulet, patatet, bishtajoret

⁷²Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, (Profili i Komunës së Prizrenit).

kokërr etj.

Grafiku 14: Kultivimi i drithërave në rajonin e Prizrenit



Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Pra siç shihet nga tabela më poshtë gruri për rajonin e Prizrenit është kulturë strategjike, duke vazhduar edhe me kultivimin e drithërave tjera jo kokërr.

Tabela 26. Kultivimi i drithërave në rajonin e Prizrenit


Gruri	11,200.44
Misri	3,867.96
Elbi	122.1
Thekra	111.83
Tërshëra	464.44
Drithërat tjerë	4.04
Bishtajoret kokërr	431.9
Fasulet kokërr	429.75
Bizelet Kokërr	1.77
Bishtajoret e tjera	0.38
Kulturat Industriale	2.97
Bimët A ^M	2.81
Patatet	140.02

Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Perimtaria në Rajonin e Prizrenit

Po ashtu si sektor mjaft me rëndësi në këtë rajon është edhe kultivimi perimeve nga 1,192.26 ha perime të kultivuara në rajon kultivimi i specit mbulon 198.8 ha (17%) të sipërfaqes në raport me kulturat tjera. Kultivimi i perimeve vazhdon me shalqi 205.93 ha (17%), domate 179.62 ha (15%), domatet sidomos me shumicë kultivohen në komunën e Mamushës, ku si kultivues janë të njohur për kultivimin në serra, këta fermer furnizojnë tregun e Kosovës po ashtu edhe eksportojnë në vendet në rajon.

Grafiku 15. Kultivimi i perimeve në Rajonin e Prizrenit



Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014


Kultivimi vazhdon me qepë 12%, lakër 11%, spinaq 7%, pjepër 6%, dredhëz 4%, kungull misiri, preshe, karrotë etj. Rritja e sipërfaqeve të kultivuara është bërë sidomos në vitet e fundit ku kanë ndikuar edhe grantet dhe subvencionet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku pjesa më e madhe e pemëve, perimeve dhe vreshtave tani subvencionohen me pagesa direkte dhe me grante. Këta sektorë ofrojnë mundësi reale dhe të shpejta për zbutjen e varfërisë dhe uljen e shkallës së papunësisë, prandaj politikat strategjike të shtetit janë orientuar në masat dhe instrumentet që mbështesin faktorët e prodhimit, stimulimin e fermerëve, dhe krijimin e kushteve sa më të favorshme për

investitorë, në mënyrë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe t'ju bashkëngjitemi trendëve zhvillimorë të vendeve të Bashkimit Evropian.


Pemëtaria në Rajonin e Prizrenit

Prej sipërfaqes totale të tokës së punueshme të rajonit të Prizrenit rreth 448.88 ha janë me pemishte prej të cilave përqindjen më të madhe e zënë me kultivimin e mollës 51% (226.32 ha), duke vazhduar kultivimin e kumbullës me 11 % (50.91 ha), dardhës me 8% (37.16 ha), vishnjës 7% (30.7%), mjedrës 7 % (32.29 ha) duke vazhduar me kultivimin e pemëve tjera me përqindje rreth 1% ftoit, qershisë, boronicës, arrës etj.

Grafiku 16: Përshkrimi i gjendjes së pemëtarisë në rajonin e Prizrenit



Burimi: Analize e autorit bazuar ne Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Grafiku 17: Përshkrimi i gjendjes së pemëtarisë në komunat e Rajonin të Prizrenit

Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Bazuar në grafikonet mund të themi se në rajonin e Prizrenit në pesë komunat kemi përqindje të ndryshme të kultivimit të pemëve. Komuna e Dragashit ka 31.45 ha sipërfaqes me pemë prej të cilës molla kultivohet në përqindje më të madhe, komuna e Malishevës ka 142.58 ha sipërfaqe me pemë ku kultivimi i mollës udhëheq me 96.58 ha,

kumbulla 23.11 duke vazhduar me dardhën dhe pemët tjera në përqindje më të vogël. Komuna e Mamushës ka 10.05 ha, pra ka sipërfaqe shumë të vogël të kultivimit të pemëve ku dallohet sa i përket mollës, dhe të cilat zakonisht përdoren për konsum familjar. Komuna e Prizrenit ka 118.99 ha me pemë ku 44.92 ha janë me mollë dhe duke vazhduar me vishnje dhe kumbull si kultura që kultivohen me tepër. Po ashtu në grafikonin e mësipërm shohim se komuna e Suharekës ka sipërfaqe prej 145.81 ha me pemë ku po ashtu kultivimi i mollës udhëheq me 78.3 ha duke vazhduar me sipërfaqet e kultivuara me dardhë 11.51 ha dhe kumbull me 10.87 ha. Kultivimi i mollës sikurse edhe në gjithë Kosovën edhe në rajonin e Prizrenit është kulturë që udhëheq në kultivim, pra është sektor me ndikim strategjik në zhvillimin ekonomik të këtij rajoni.

Blegtoria në Rajonin e Prizrenit


Ky rajon është i njohur për kultivimin e bagëtisë duke pasur parasysh kullosat dhe livadhet të cilat i posedon dhe pozitën strategjike, nga gjithsej numri i njësive blegtorale⁷³ që janë 47,562 dhe ekonomive bujqësore 12,912 që merren me blegtori në vitin 2014, prej të cilëve në komunën e Dragashit ishte 7,029 njësi blegtorale ku prej tyre zakonisht dominonin gjedhet me 92% (5008), 4% (411) janë shpezë, bletë 2% dhe kafshë tjera. Falë pozitës gjeografike dhe florës shumë të pasur kemi një shtirje të kultivimit të bletarisë në një intensitet të lartë.


Kurse në komunën e Malishevës po ashtu shihet se kultivimi i gjedheve dominon, prej 14,443 njësi blegtorale 48% janë gjedhe (11,684) duke vazhduar me shpezëtari 47%(1,884) dhe duke vazhduar me kafshë tjera me dhi, dele etj me 1-2%. Komuna e Mamushës po ashtu merret me rritjen e gjedheve ku prej 944 njësive blegtorale 806 njësi

⁷³ Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë, 2014

blegtorale janë me gjedhe pra 56 % në raport me rritjen e shpezëve e cila po ashtu ka një përqindje të madhe rreth 47%, kurse pjesa tjetër është me kafshë tjera si dele, bletë etj. Komuna e Prizrenit si komuna më e madhe në këtë rajon udhëheq po ashtu me kultivimin e gjedheve ku prej total njësive blegtorale që është 14,477, prej tyre 9,637 janë gjedhe (57%), duke vazhduar po ashtu me rritjen e deleve dhe të shpezëtarisë dhe kafshëve tjera në përqindje shumë të vogël për nevoja familjare e jo për treg. Po ashtu edhe në blegtorinë e komunës së Suharekës nga total njësitë blegtorale 10,469, prej tyre 8,048 janë njësi blegtorale që merren me rritjen e gjedheve, në këtë komunë shpezëtaria është më e theksuar ka një numër më të madh të ekonomive shtëpiake, dhe po ashtu vazhdon me rritjen e kafshëve tjera.

Grafiku 18: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunat e rajonit të Prizrenit





Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Pa marrë parasysh kushtet shumë të volitshme për zhvillimin e këtij sektori, fermat janë ekzistenciale apo gjysmë komerciale me një përqindje të vogël të fermave komerciale që merren me rritjen e gjedheve.

Bazuar në kushtet klimatike dhe tokësore në rajonin e Prizrenit i cili është një rajon i njohur bujqësorë, modelet e shfrytëzimit të tokës tregojnë se karakteri rural është mbizotërues. Në rajonin e Prizrenit edhe pse kemi sasi të mjaftueshme të ujërave dhe lumenjve si dhe ujërave nëntokësore nuk kemi mbulesë të tërësishme me ujë dhe ka nevojë për intervenime dhe investime në orientimin e shfrytëzimit të resurseve ujore si dhe orientimin e tyre në kahjen e duhur duke e ruajtur tokën nga vërshimet dhe erozioni.

Tabela 27: Situata e ujitjes në këtë rajon

Gjithsej sipërfaqja e ujitur në ha	2,216.35
Më shumë se 0 dhe më pak se 0.25	253.59
Nga 0.25 deri në më pak se 0.5	242.34
Nga 0.5 deri në më pak se 1	367.79
Nga 1 deri në më pak se 2	435.12
Nga 2 deri në më pak se 5	554.29
Nga 5 deri në më pak se 10	214.55
10 e më shumë	148.67

Burimi: Regjistrimi i bujqësisë së Kosovës, 2014.

Komuna e Suharekës⁷⁴

Sektorët kryesorë për zhvillim ekonomik në këtë komunë janë: agrobiznesi, turizmi, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe energjia. Agrikultura ka një traditë të gjatë në Suharekë, posaçërisht histori të gjatë ka kultivimi i rrushit dhe prodhimtaria e verës.

Harta 8: Pozita gjeografike e Suharekës



Burimi: Plani Zhvillimor i Suharekës, 2008 – 2018

E ardhmja e Suharekës varet prej rritjes së kualitetit dhe vlerave të prodhimeve rajonale krahas zhvillimit të markave të njohura rajonale. Një prioritet shtesë për agrikulturë është biomasa, duke mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të energjisë ripërtrirëse. Në strategjinë zhvillimore janë përcaktuar lokacionet me prioritet për zhvillim varësisht prej potencialeve të burimeve natyrore.

⁷⁴ Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Instituti për Planifikim Hapësinor, Kuvendi komunal – Suharekë - Korrik 2005

Komuna e Mamushës

Komuna e Mamushës shtrihet në rajonin e Prizrenit, është komunë e re e krijuar me procesin e decentralizimit të komunave të Kosovës. Sipas regjistrimit të popullsisë, të kryer nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, 2011 është një vendbanim që ka rreth 5,507 banorë, Mamusha është e përbërë nga nëntë lagje që përbëhen nga 93% nga turqit, shqiptarët dhe REA. Sipërfaqja e Mamushës është 10.49 km².

Situata e sektorit të bujqësisë në komunën e Mamushës⁷⁵

Territori i komunës përbëhet nga pesë kategori të tokës (kategoria 1, 2, 3, 4 dhe 5) e cila përdoret për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore siç janë: domatja, trangulli, lakra, spinaqi, pjepri, shalqiri dhe të tjera në sasi të vogla.

Kualiteti dhe sasia e prodhimit të domateve dhe perimeve tjera dita ditës po rritet, sidomos kultivimi në serra, i cili siguron kultivimin e perimeve në ambiente të mbyllura edhe gjatë dimrit kultivohen spinaqi, marulla, dhe qepa.

Mamusha numëron mbi 180 ha me serra që kryesisht janë investime private të fermerëve, të cilat janë serra në formë tuneli. Madhësia mesatare e parcelave është 1.34 ha, pjesa më e madhe e sipërfaqes është pronë e sektorit privat. Mamusha posedon 203 ekonomi familjare që posedojnë bagëti të cilat në përgjithësi i mbajnë për nevojat familjare. Rreth 92% e familjeve posedojnë gjedhe, 26% shpezë, 6% koshere bletësh dhe 3.4% dele.

Komuna e Dragashit

Komuna e Dragashit shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Kosovës, në një lartësi mbidetare 1,100 m. Në bazë të regjistrimit të bujqësisë në vitin 2011 kanë qenë 33,997 banorë. Kjo komunë po përjeton zvogëlim të popullsisë për shkak të dukurisë së migrimit

⁷⁵ Raporti i vlerësimit strategjike mjedisor për planin zhvillimorë komunal, Komuna e Mamushës.


sidomos ka rënie të theksuar të popullsisë në fshatra të thella (Baçkë, Dikanc, Orçushë, Plajnik, Xërxë).

Situata socio-ekonomike në qytetin e Dragashit⁷⁶

Sektorët me perspektivë të zhvillimit janë sektori i bujqësisë, turizmit, ndërmarrjeve, pylltarisë etj. Edhe pse sektori i bujqësisë është njeri prej sektorëve më të vjetër në këtë komunë ende karakterizohet me ferma të vogla të cilat janë në zhvillim e sipër dhe që shumica prodhojnë për nevoja familjare. Kjo komunë ka në total 3,500 ekonomi familjare (ferma), nga të cilat 90% janë ferma që prodhojnë për nevoja të familjeve, 3.5% prodhojnë si për nevoja familjare ashtu edhe për shitje në treg dhe vetëm 6.5% të fermave janë komercialisht të fokusuara. Sektori bujqësorë ka mungesë të mekanizimit, mungesë të infrastrukturës për mbarështim, mungesë të plasmanit dhe mungesë të njohurive në fushën e bujqësisë dhe përpunimit. Në Dragash ekzistojnë 5 pika lokale të grumbullimit të qumështit: nga 1 në Kuk, Kosavë dhe Bresanë ndërsa 2 janë në Buzez, si dhe 6 thertore, 1 fabrikë e përpunimit të mishit, dhe 3 mini fabrika. Komuna e Dragashit përmban një larmi të madhe të llojeve të bimëve dhe të kafshëve. Ka rreth 1,500 lloje të bimëve vaskulare, prej të cilave 150 lloje endemike, në këtë komunë janë të përfshira rreth 20% të florës së Ballkanit. Pra bazuar në pasuritë natyrore, kjo komunë është e njohur edhe për sektorin e bimëve aromatike dhe mjekësore, sidomos mbledhjen e kërpudhave, bimëve mjekësore, frutave të egra për grumbullim, ruajtjen dhe gjysmë përpunimin e tyre. Në këtë komunë ekziston një pikë grumbulluese ku ju mundëson fshatarëve të shesin bimët e grumbulluara nga të cilat krijojnë të hyra për familje. Pra ky sektor është një potencial i pashfrytëzuar dhe eksploruar totalisht dhe llogaritet si sektor me potencial strategjik për zhvillimin ekonomik të kësaj komune. Po ashtu sektori i bletarisë është veprimtari dhe një karakteristikë e shquar e shumicës së fshatrave të Dragashit.

⁷⁶ Komuna e Dragashit - Plani Zhvillimor Komunal (PZhK)

Harta 9 :Shtrirja gjeografike e komunës së Dragashit



Burimi: Komuna e Dragashit - Plani Zhvillimor Komunal (PZhK), 2013

Objektivat e komunës së Dragashit për zhvillimin e sektorit të Agrobiznesit⁷⁷

Krijimi i kushteve më të mira për aktivitete bujqësore dhe blegtorale si përgjegjësi e Komunës, është paraparë që të punohet në vetëdijësimin e autoriteteve lokale dhe koordinimin e aktiviteteve në mes sektorit privat dhe publik.

- Koordinimi: Në nivel të qeverisë (në mes të departamenteve komunale të ekonomisë, arsimit, etj.)
- Në nivelin lokal të shoqërisë civile (nëpërmjet asociacioneve dhe rrjetëzimit të shoqërisë civile dhe të institucioneve publike),
- Në nivel ndërkomunal (ndërmjet komunave fqinje), në nivel vertikal (koordinimi me qeverinë kombëtare).
- Të përmirësohet performanca ekonomike dhe konkurrenca.

⁷⁷ <http://kk.rks-gov.net/dragash/municipality/plani-zhvillimor-komunal/prezantimi-shq.aspx> (parë me 16.05.2016).

- Përpunimi i përmirësuar dhe marketingu i produkteve bujqësore
- Të mbështetet përmirësimi i kualitetit të produkteve
- Të krijohen të hyra shtesë për fermerët dhe fshatarët, posaçërisht për gratë
- Të përmirësohet performanca e zinxhirit të vlerës së bletarisë, pylltarisë, barishteve, mishit dhe qumështit si dhe e tekstilit dhe konfeksionit dhe të sistemit lokal të turizmit


Komuna e Malishevës

Komuna e Malishevës është qytet në qendër të Kosovës që i takon rajonit të Prizrenit, e që njihet edhe me emrin Rajoni i Llapushës dhe zë hapësirë prej 306.3 km². Malisheva ka qenë vendbanim i hershëm ilir bashkë me vendbanimet tjera në këtë komunë, që janë shtrirë përgjatë lumit Mirusha. Kjo zonë e Kosovës ka filluar të popullohet dy shekuj më parë nga popullata dominante shqiptare dhe një pakicë rome. Tokat e kësaj komune janë dallueshëm pjellore andaj edhe sot një nga aktivitetet kryesore është bujqësia dhe agrobiznesi. Komuna e Malishevës formalisht u riemërua komunë në vitin 2000. Në këtë territor jetojnë 65,000 banorë ku 60-65% e popullatës është e moshës së re. Njëra prej sfidave kryesore të kësaj komunë është papunësia, ndërsa sipas Planit për Zhvillim Komunal⁷⁸ llogaritet se shkalla e papunësisë sillet rreth 52.25%

Territori i komunës është kryesisht kodrinor-malor. Atë e përshkon pellgu i lumit Mirusha, me toka të rrafshëta e pjellore në të dy brigjet e saj. Komuna rrethohet edhe me masivin malor të Drenicës, me pikën më të lartë mbidetare të saj prej 1,057 m tek Maja e Kosmaqit dhe 1,006 m tek maja e Koznikut.


⁷⁸ Plani për zhvillim komunal, Malishevë

Harta10:Struktura e tokës sipas bonitetit dhe shfrytëzimit në komunën e Malishevës



Burimi:Plani për Zhvillim Komunal

Harta 11. Harta e komunës së Malishevës



Burimi:Plani për Zhvillim Komunal

Situata e sektorit të bujqësisë në qytetin e Malishevës

Sektori i agrobiznesit është njëri prej sektorëve me potencial për zhvillim ekonomik. Sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural ka potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, kjo komunë ka tokë bujqësore, kullosa, livadhe, pozitë të mirë lidhëse me qytetet tjera, traditë në kultivimin e pemëtarisë, blegtorisë, traditë në kultivimin e zejeve tradicionale etj. Bujqësia si sektor mbulon 38% (11,735 ha) tokë bujqësore, ku kryesisht kultivohen: gruri, misri, thekra, elbi tërshëra, si dhe drithërat e bardha (që kanë rendimente të ulëta pa sistem të ujitjes), vreshtaria nga 1,388 ha sa kishte para viti 1999, vetëm 51.5 ha janë në kultivim, në sektorin e pemëtarisë ka 37 ha (mollë, dardhë, ftoi kumbull, pjeshkë, qersh dhe vishnjë, mjedër, manaferrë, dredhëz), kurse në perimtare ka 235 ha (spec, domate, qepë, hudhër, majdanoz, lakër, trangull, spinaq etj). Falë pozitës gjeografike dhe posedimit të kullosave dhe livadheve me rreth 4,000 ha kullosa, kjo komunë ka të zhvilluar po ashtu edhe sektorin e blegtorisë, pra ka rreth 17,800 krerë.

Sipas planit për zhvillim komunal⁷⁹, komuna e Malishevës ka këto sfida zhvillimore:

1. Stimulimi i prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale
2. Krijimi i kushteve për zhvillimin e agro-industrisë dhe industrisë së mineraleve
3. Zhvillimi dhe promovimi i turizmit
4. Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Qëllimet dhe objektivat

1. Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur produktivitetin dhe duke zhvilluar kapacitetet përpunuese
2. Stimulimi i kultivimit të kulturave të vreshtarisë dhe pemëtarisë
3. Rritja e fondit blegtoral dhe modernizimi i infrastrukturës
4. Krijimi i kushteve për zhvillimin e agro-industrisë
5. Ngritja e infrastrukturës fizike bujqësore

⁷⁹ Draft profile për planin zhvillimor të komunës, Malishevë 2013

3.4. Rajoni i Gjakovës

3.4.1. Situata sociale - ekonomike e rajonit të Gjakovës

Rajoni i Gjakovës përfshin këto komuna: Gjakovën, Deçanin, Junikun dhe komunën e Rahovecit. Komuna e Gjakovës shtrihet përgjatë hapësirës tektonike të rrafshit të Dukagjinit⁸⁰, e cila gjendet në mes të bjeshkëve të: Pashtrikut, Mokra Gorës dhe Sharrit, në lartësi nga 360 m deri në mbi 2,650 m mbi nivelin e detit. Luginat e lumenjve Drini i Bardhë, Ereniku, Krena, Trava dhe Trakaniqi, si dhe të disa përroskave, krijojnë në Komunën e Gjakovës rrafshina, shumica e të cilave me tokë të punueshme e shumë pjellore. Nisur nga këta faktorë dhe nga kushtet e përshtatshme agro- klimatike, bujqësia përfaqëson një potencial të madh zhvillimi për ekonominë e komunës. Mundësi të riaktivizimit ka edhe industria ushqimore e cila ka qenë shumë e zhvilluar në të kaluarën dhe disponon me resurse të mjaftueshme humane. Në zonat rurale, bujqësia është 70% si burim i jetesës. Gjithsej janë 55,684 ha tokë, prej të cilës 29,445 ha në sektorin shoqërorë dhe 26,239 ha në atë privat. Sipërfaqet pyjore në Komunën e Gjakovës janë 26,264 ha prej tyre 17,435 ha në sektorin shoqëror dhe 8,829 ha sektorin individual.

Gjakova është e njohur për traditë pune në industri dhe bujqësi dhe për punonjës të zellshëm në zejtari, tregti dhe shërbime. Ajo ka një strukturë të popullsisë mjaft të re dhe me vullnet shumë të spikatur e të përkushtuar në punë. Të gjitha këto përfaqësojnë një potencial të madh zhvillimi për të ardhmen.

3.4.2. Zhvillimi i Bujqësisë në rajonin e Gjakovës

Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të bujqësisë në rajonin e Gjakovës

Në bazë Raportit të Regjistrimit të Bujqësisë në Kosovë, 2014 konstatohet se rajoni

⁸⁰ Raporti i punës 2015, Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural


i Gjakovës ka 15,152 ekonomi bujqësore, prej të cilave komuna e Gjakovës 5,483 me sipërfaqe të shfrytëzuar të tokës bujqësore prej 21,378.34 ha, duke vazhduar me komunën e Rahovecit e cila ka 5,390 ekonomi bujqësore dhe sipërfaqe rreth 14,461.58 ha.

Tabela 28: Ekonomitë Bujqësore sipas statusit ligjor, sipas komunave, Kosovë, 2014⁸¹

Rajoni/ Komuna	Ekonomitë bujqësore - Gjithsej				Ekonomitë familjare bujqësore dhe bizneset individuale	
	Numri ekonomive bujqësore	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)	Njësitë blegtorale	Njësitë Punës Vjetore	Numri ekonomive bujqësore	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)
KOSOVË	130,775	413,635.16	281,747	86,620	130,436	405,428.90
GJAKOVË	15,152	47,181.96	41,784	16,789	15,120	45,952.60
Deçan	3,936	10,043.88	9,663	2,781	k	9,809.97
Gjakovë	5,483	21,378.34	20,293	5,980	5,467	21,126.23
Junik	343	1,298.16	1,002	413	k	1,254.48
Rahovec	5,390	14,461.58	10,826	7,615	5,380	13,761.9

Prej sipërfaqes totale të tokës së punueshme, komuna e Gjakovës ka 332.53 ha me pemishte prej të cilave përqindja më e madhe është e zëne me kultivimin e mollës 53% (176.7 ha), duke vazhduar kultivimin e kumbullës me 23% (77.06 ha), dardhës me 5% (14.99 ha), vishnjës 3% (10.41%), mjedrës 12.75% (4 ha) duke vazhduar me kultivimin e pemëve tjera me përqindje rreth 1% ftoit, qershisë, boronicës, arrës etj

⁸¹ Burimi - Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë, 2014

Grafiku 19: Sipërfaqja e kultivimit të pemëve në ha në komunën Gjakovës

Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Siç shihet edhe nga statistikat e dhëna pemëtaria edhe në këtë komunë sikurse në gjithë Kosovën është në rritje e sipër dhe ka një ekspansion shumë të madh si një sektor shumë profitabil që ju sjell të mira materiale fermerëve në viset rurale. Nga shpërndarja e tyre në katër komunat shihet se ndër të gjitha komunat, Gjakova dhe Rahoveci udhëheqin për nga numri i hektarëve e cila po ashtu bazohet edhe në përvojën shumëvjeçare të këtyre komunave në këtë sektor. Këto komuna para vitit 1998 kanë qenë qendër e kultivimit dhe përpunimit të pemëve ku kanë ekzistuar edhe fabrika për përpunim si fabrika Ereniku në Gjakovë.


Kultivimi i perimeve në rajonin e Gjakovës ka një rëndësi të veçantë, e sidomos kultivimi i disa perimeve të cilat për nga rëndësia e kultivimit llogariten perimet kryesore siç janë: speci, shalqiri, domatja, qepa, kungulli i misirit, dredhëza etj.

Tabela 29: Struktura e kultivimit të pemëve në rajonin e Gjakovës

Plantacionet e pemëve në ha	Deçan	Gjakovë	Junik	Rahovec
	90.77	109.72	49.8	82.24
Mollë	68.22	60.9	18	29.49
Dardhë	4.59	6.82	0.19	3.39
Ftua	0.27	1.2	0	0
Mushmollë	1	1.42	0	1.3
Kumbull	8.72	28.79	0.42	39.13
Qershi	0.49	1.42	0	0
Vishnje	0.57	0.56	9.09	0.19
Pjeshkë	0.17	0.4	0	0
Kajsi	0.14	0.39	0	0
Arrë	2.61	2.61	0.06	1.2
Lajthi	0.11	1.3	0	0.32

Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Nga 2,800.77 ha perime të kultivuara në rajon kultivimi i specit mbulon 1,527.12 ha (50%) të sipërfaqes në raport me kulturat tjera, sidomos speci kultivohet në Komunën e Rahovecit ku kjo komunë është e njohur në gjithë Kosovën për kultivimin e perimeve e sidomos njihet edhe jashtë Kosovës për kultivimin e disa varieteteve tradicionale siç është speci i varietetit kurtovska. Kultivimi i perimeve vazhdon me qepët 382.48 ha (13%), shalqirin 374 ha (12%), domate 3%, kungull misiri, preshe, karota etj. Rritja e sipërfaqeve të kultivuara është bërë sidomos në vitet e fundit ku kanë ndikuar edhe grantet dhe subvencionet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pjesa më e madhe e pemëve, perimeve dhe vreshtave tani subvencionohen me pagesa direkte dhe me grante.

Grafiku 20: Kultivimi i perimeve në rajonin e Gjakovës⁸²


Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Rajoni i Gjakovës dallohet prej rajoneve tjera sa i përket kultivimit të vreshtave, bazuar në regjistrimin e Bujqësisë së Kosovës, 2014 komuna e Rahovecit ka qenë komuna që më së shumti ka kultivuar vreshta. Vreshtat e kultivuara kanë qenë të tryezës me rreth 41% dhe verës rrethe 59%. Rajoni me sipërfaqen më të madhe të vreshtave është Gjakova, me 73.4% të gjithsej sipërfaqes së vreshtave, ku 2,855 ekonomitë bujqësore janë marrë me vreshtari dhe shumica prej tyre gjenden në komunën e Rahovecit. Komuna e dytë më e rëndësishme në kultivimin e hardhisë së rrushit është Suhareka.

Ekonomitë bujqësore sipas sipërfaqes së drithërave në këtë rajon janë rreth 12,068 me 20,115.02 ha sipërfaqe të kultivuara me drithëra në këtë rajon. Nga sipërfaqja totale 12,387.51 ha janë drithëra kokërr ku vendin e parë 26% (6978.54 ha) e nxënë gruri, misri me 18% (4867.74) duke vazhduar me kultura tjera 1-2% si tërshëra, fasulet, bishtajoret kokërr, patatet etj.

⁸² Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Grafiku 21: Kultivimi i drithërave në rajonin e Gjakovës⁸³




Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Blegtoria në komunën e Deçanit

Ky rajon është i njohur për kultivimin e bagëtisë, në komunën e Deçanit nga gjithsej numri i ekonomive bujqësore që merren me blegtori në vitin 2014 ishte 9,663 prej të cilave 57% (2,719) janë gjedhe, 32% (1,516) janë shpezë, bletë 3% dhe kafshë tjera. Falë pozitës gjeografike dhe florës shumë të pasur kemi një shtrirje të kultivimit të bletarisë në një intensitet të lartë në këtë komunë e sidomos është karakteristik mjalti i gështenjës për shkak të kultivimit të gështenjës në këtë rajon

⁸³Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014


Grafiku 22: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Deçanit



Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë ⁸⁴


Në komunën Gjakovës gjithsej nga 20,293 ekonomi shtëpiake që ekzistojnë 3,904 janë gjedhe (45%), 3,006 shpezë (35) dhe 12 derra (1,056) duke vazhduar me kafshë tjera nga 2% delet, gomarët, bletët etj.

Grafiku 23: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Gjakovës



Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë

⁸⁴ Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Grafiku 24: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Junikut


Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Po ashtu edhe në komunën e Junikut nga gjithsej 1,002 ekonomi bujqësore 256 (54%) janë me gjedhe pra kemi 1,113 gjedhe, duke vazhduar me shpezë 145 ekonomi bujqësore (31%) nga totali pra në këtë komunë kemi 2,740, ky qytet është i njohur me kultivimin e bletarisë, falë pozitës gjeografike dhe një flore mjaft të pasur, sidomos është i njohur mjalti i gështenjës që është shume specifik dhe mjaft i kërkuar. Pra kemi 50 ekonomi bujqësore që përbëjnë 10% nga totali pra 2,740 koshere bletësh.

Komuna e Rahovecit si njëra prej komunave që ka një shtrirje më të madhe gjeografike në këtë rajon në bazë të analizës së regjistrimit të bujqësisë posedon 10,826 ekonomi bujqësore blegtorale, ku prej totalit 46% (2030) janë gjedhe pra 7603 krerë, duke vazhduar me kultivimin e shpezëve sikurse edhe në ekonomitë tjera bujqësore blegtorale të komunave tjera.

Në këtë komunë kemi rreth 47% shpezë apo 2,075 ekonomi bujqësore apo 129,413

Grafiku 25: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Rahovecit




Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Fokusimi i komunës së Gjakovës në sektorin e bujqësisë është si në vijim⁸⁵:

- 1.1 Edukimi i vazhdueshëm / Përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural;
- 1.2 Forcimi i zinxhirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- 1.3 Përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale;
- 1.4 Mbështetja institucionale në riaktivizimin e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në komunën e Gjakovës;
- 1.5 Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe rritje të sipërfaqeve punuese me sistem të ujitjes në funksion të rritjes së rendimentit;
- 1.6 Mbështetja e zhvillimit ekonomik të komunës përmes nxitjes së investimeve në fushat: Pemëtari, perimtari, lavërtari, blegtori, vreshtari, bletari dhe produktet e veçanta (kërpudha, bimë mjekësore dhe aromatike, kërmij etj.).

⁸⁵ Burimi: Raporti i punës 2015, Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural

Harta12: Shtrirja gjeografike e komunës së Gjakovës



Burimi: Raporti i punës 2015, Drejtoria për BPZhR

Situata sociale - ekonomike dhe pozita gjeografike e Komunës së Rahovecit⁸⁶

Vreshtat - Me rreth 2,416 ha, si dhe përpunimin e verës Komuna e Rahovecit dallohet në Kosovë dhe rajon. Kultivohet edhe rrushi i tryezës. Faktorët fiziko natyror janë të përshtatshëm për kultivimin e kësaj kulture. Shtrirja hapësinore e sipërfaqeve të kultivuara është me tepër në viset kodrinore me ekspozicion të kthyer kah lindja. Kualiteti i rrushit është i standardit të lartë. Komuna e Rahovecit me tërë historinë e pasur në prodhim të verës dhe tokën pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillime në të ardhmen. Edhe pse industria e verës është vetëm një pikë në sektorin e bujqësisë së Kosovës, është potencial për të hyrë në tregjet evropiane ku kërkesa për verëra të importuara është e madhe.

⁸⁶ Plani Zhvillimor Komunal-RAHOVEC

Zhvillimi ekonomik në komunën e Rahovecit është orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimekulturë. Afro 65% e popullatës është vlerësuar të sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore. Mesatarja vjetore e të ardhurave për një fermer është përafërsisht 2,500 - 3,000 €. Komuna plotësisht përfiton nga kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike, ku 13,000 ha sipërfaqe është tokë punuese, prej të cilave 3,500 ha janë në sistemin e ujitjes. Numri i fermerëve në komunë është 3,699 (numri i familjeve të cilat kanë më tepër se 0, 50 ha), përderisa gjendja ekonomike paraqitet mjaft e rëndë. Sistemi i Radoniqit i cili mbulon një sipërfaqe prej 3,500 ha, është ngritur në vitin 1989 (Kramavik, Qifllak, Dabidol, Dejn, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gegjë, Xërxë, Bellacërkë, Celinë, Krushë e Madhe) është i një rëndësie të veçantë ngase siguron ujë për ujitje dhe ujë të pijes për popullatën e fshatrave që kanë shtrirje për gjatë Drinit të Bardhë.

Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të bujqësisë në komunën e Rahovecit⁸⁷

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verëtari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin. Rreth 90% e tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare. Toka e punueshme prej total 14,000 ha, është e mbuluar me sistem të ujitjes nga Drini i Bardhë në sipërfaqe prej 3,500 ha. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj.

Vreshtaria është njëri prej sektorëve më të zhvilluar me të cilën edhe identifikohet ky qytet, si për nga sasia e prodhimit e po ashtu edhe për nga cilësia. Rrushi i prodhuar në

⁸⁷ По ату

Rahovec dhe vera e prodhuar kanë qenë të njohura në të gjitha vendet evropiane para viteve '90.

Në vitin 2004 janë prodhuar 2.4 milion kg rrush të kuq dhe të bardhë për verë sikurse dhe të tryezës; 1.1 milion litra verë të bardhë dhe të kuqe (Cabernet Sauvignon, Merlot, Pinot Noire, Game, Kosovo Red, Chardonnay, Italian Riesling, Rhine Riesling, Semignnon); pije alkoolike si raki rrushi dhe Brandy.

Sfidat në sektorin e bujqësisë (agrobiznesit) në rajonin e Rahovecit


Duke u bazuar në analizën e gjendjes së agrobiznesit bazuar në përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet janë përcaktuara masat të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit dhe ruajtjes së prodhimtarisë në këtë komunë

Komuna e Deçanit⁸⁸

Komuna e Deçanit ka një pozitë mjaft të mirë gjeografike. Ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Gjendet pothuajse në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore është larg nga Deti Adriatik 90 km, kurse 220 km larg nga Deti Egje. Komuna e Deçanit ka një sipërfaqe prej 288.40 km² ose 28,840 ha nga e cila janë: 8,940.4 ha tokë pjellore 14,420 ha pyje dhe 5,479.6 ha kullosa.

⁸⁸ Pozita Gjeografike e Komunës së Deçanit në Kosovë,

Harta13: Shtrirja gjeografike e komunës së Deçanit⁸⁹



Burimi: Profili i komunës së Deçanit

Komuna e Deçanit shtrihet në lartësi mbidetare e cila variron nga 412m lartësi mbidetare, kurse fshati Maznik deri në 2530 m lartësi mbi detare në Marjash, që d.m.th. në saje të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë: në ultësi që është pjesa e rrafshit të Dukagjinit dhe në lartësinë që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nëmura (Alpet Shqiptare).

Bjeshkët e Nëmura apo Alpet Shqiptare shtrihen në pjesën perëndimore të komunës së Deçanit. Lartësia e Bjeshkëve të Nëmura pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpike. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siujdhesës Ballkanike, me ç'rast shkëmbinjtë e bardhë dhe të dhëmbëzuar formojnë pamje imponante.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, kjo komunë ka rreth 40,168 banorë dhe

⁸⁹ Burimi: Profili i komunës së Deçanit

6,141ekonomi familjare. Mbas luftës së fundit në Kosovë komuna e Deçanit sikurse edhe krejt Kosova është përballë me dukurin e migrimit nga viset rurale ne ato urbane dhe po ashtu jashtë vendit.

Sa i përket kushteve klimatike, Deçani ka klimë të butë me ndikim mesdhetar e karakterizuar me elementët kryesorë klimatik të Bjeshkëve të Nëmura me rrezatim të mjaftueshëm të diellit dhe të reshura atmosferike gjatë gjithë stinëve të vitit, me mot të kthjelltë, lartësia e lartë mbidetare e kompleksit të bjeshkëve, temperatura të freskëta gjatë verës dhe mjaft të ftohta gjatë dimrit dhe me shumë reshje.

Deçani është i njohur si rajon turistik, duke përfshirë Bjeshkët e Deçanit, të cilat janë hapësirë kapitale e trashëgimisë natyrore, për zhvillimin e turizmit. Bukuritë natyrore dhe vlerat e këtij territori e posaçërisht Gryka e Deçanit kanë vend të rëndësishëm në vlerësimet e vlerave të peizazhit, dhe bukurive natyrore specifike me florë dhe faunë.

Zona e Deçanit me rrethinë -lokaliteti i luginës së Lumbardhit -lokaliteti i Radoniqit -lokaliteti i Podit të Gështenjave. Komuna e Deçanit është e pasur me një florë dhe një faunë shumë të bujshme, pjesa që shtrihet sidomos në Bjeshkët e Nëmura, sipas shumë studimeve janë mbi 1,500 lloje bimore nga këto: 33 lloje janë endemike dhe subendemike.

Fauna- e Bjeshkëve të Nëmura përbëhet prej:8 lloje të peshqve,13 lloje të ujëtokësorëve, 10 lloje të rrëshqitësve, 200 lloje të shpendëve, 36 lloje të gjitarëve, 129 lloje të fluturave⁹⁰. Deçani ka kushte për zhvillimin e bujqësisë sidomos bimët shumëvjeçare: gështenja, pemët, bletarinë dhe blegtorinë.

⁹⁰ Faqja zyrtare e komunës së Deçanit

3.5. Rajoni i Pejës


3.5.1. Situata sociale - ekonomike e Pejës

Karakteristikë e përgjithshme e komunës së Pejës është se ajo shtrihet në skajin veriperëndimorë të luginës së Dukagjinit. Peja, karakterizohet me klimë të mesme kontinentale të modifikuar me komponentë të klimës mesdhetare që përfshinë përafërsisht 30% të sipërfaqes së përgjithshme, dhe vargmalet e Alpeve Shqiptare në veriperëndim, me një rrjet hidrografik të zhvilluar që ndikon në modifikimin e klimës së Pejës.

Pozita gjeografike, relievi dhe klima, kanë ndikuar në zhvillimin social ekonomik të rajonit të Pejës, sidomos në zhvillimin e ekonomisë bujqësore. Peja është qendra e rajonit të Dukagjinit verior. Komuna e Pejës shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës. Qyteti gjendet rrëzë Bjeshkëve të Alpeve Shqiptare që ngritën mbi Grykën e Rugovës e cila zgjerohet me 13 fshatra dhe disa lagje të tyre, me dëbanishtat verore, pyjet dhe kullotat alpine përkatëse. Komuna e Pejës është e ndarë në 27 bashkësi territoriale që përfshijnë gjithsej 76 fshatra. Në komunë jetojnë rreth 160,000 banorë, pjesa më e madhe e të cilëve jetojnë në qytet apo rrethinën e tij si vendbanime më të përshtatshme të shpërngulur gjatë sezonës dimërore apo në përgjithësi nga zonat e thella rurale me kushte të vështira jetese veçanërisht nga krahina malore e Rugovës. Territori i komunës së Pejës është 60,258 ha⁹¹. Territori i komunës së Pejës përbëhet nga dy tërësi gjeografike: njëra me klimë kontinentale të shprehur klimë mesdhetare që përfshinë përafërsisht 30% të sipërfaqes së përgjithshme, dhe vargmalet e Alpeve shqiptare në veriperëndim, me një rrjet hidrografik të zhvilluar që ndikon si modifikim i klimës në këtë pjesë.

⁹¹ Strategjia për Zhvillimin Ekonomik në Komunën e Pejës, 2013-2017

Harta 14: Shtrirja gjeografike e komunës së Pejës



Burimi: Strategjia për Zhvillimin Ekonomik në Komunën e Pejës, 2013-2017

Komuna si organ përfaqësues i vetëqeverisjes lokale synon që të sigurojë një zhvillimin të qëndrueshëm dhe konkurrencën e lirë duke reduktuar pabarazinë sociale dhe ekonomike si dhe krijimin e një kuadri efikas për planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit rural krahas sektorëve tjerë socio-ekonomik.

Zhvillimi i agrobiznesit në vende të ndryshme është rezultat i zhvillimit të qytetërimit njerëzor me karakteristika mjedisi, kulturore e tokësor të zonës. Rritja ekonomike dhe ajo e popullsisë kërkojnë një filozofi të re marrëdhëniesh në mes natyrës dhe njerëzimit. Burim për pasurimin dhe vërtetësinë e kësaj filozofie është edhe shqyrtimi i ecurisë së zhvillimit historik të agrobiznesit.


Planifikimi në sektorin e agrobiznesit si pjesë e strategjisë zhvillimore ka për qëllim që:

1. Të vendos lidhjen midis objektivave strategjike dhe programeve të hartuara në kuadrin e Strategjisë Zhvillimore të Komunës së Pejës në një perspektivë pesë vjeçare;
2. Të sigurojë koherencën e politikave dhe sensin e orientimit afatgjatë të zhvillimit në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit;

3. Të krijoj qartësi në lidhje me reformat dhe proceset e zhvillimit që ndodhin në sektorin e Agrobiznesit; dhe
4. Tu paraprijë nevojave për mbështetje teknike dhe financiare të agrobiznesit.

Komuna e Pejës disponon resurse të shumta të sektorëve bujqësore dhe pyjore, blegtorale por edhe agropërpunuese dhe tregtare si bazë për zhvillimin e agrobiznesit. Këta sektor ofrojnë mundësi reale dhe të shpejta për zbutjen e varfërisë dhe uljen e shkallës së papunësisë, prandaj politikat strategjike të shtetit janë orientuar në masat dhe instrumentet që mbështesin faktorët e prodhimit, stimulimin e fermerëve, dhe krijimin e kushteve sa më të favorshme për investitorë, në mënyrë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe t’ju bashkëngjitemi trendëve zhvillimore të vendeve të Bashkimit Evropian. Mirëpo edhe për kundër resurseve që Peja posedon situata në këtë komunë lënë shumë për të dëshiruar, mbasi ende kemi një numër relativisht të lartë të papunësisë. Siç shihet në grafikonët në vijim sektori parësor punëson 13.9 përqind, sektori dytësor 21.8 përqind si dhe 64 përqind janë në punë të punësuar në sektor të tjerë, kurse të papunë kemi një numër shumë të madh rreth 25.643 të papunë, ku prej tyre 57.2 përqind janë femra dhe 42.8 përqind janë meshkuj.

Tabela 30: Situata e punësimit në komunën e Pejës



Burimi : Strategjia për Zhvillimin Ekonomik në Komunën e Pejës, 2013-2017

3.5.2. Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të bujqësisë në rajonin e Pejës

Bujqësia e komunës së Pejës ashtu si edhe ajo e Kosovës karakterizohet me potenciale të larta të resurseve të tokës bujqësore, ujore dhe aktiviteteve të fermerëve në sektorët dhe nënsektorët e saj. Perspektiva e agrobiznesit në komunën e Pejës është e bazuar në orientimin e investimeve në pemëtari dhe blegtori, si dhe në kultura me vlera të veçanta si perimet (perimet, bimët mjekuese) duke pasur parasysh burimet natyrore dhe traditën kultivuese lokale, si dhe nevojat e tregut ashtu dhe ndërlidhjen me zhvillimin e sektorëve të tjerë ekonomik si turizmi etj. Në komunën e Pejës fermerët kryesisht kultivojnë misër, patate dhe jonxhe. Gruri është kultura e katërt për nga rëndësia nga që bimët foragjere kanë zëvendësuar shumicën e sipërfaqeve të grurit.


Tabela 31: Struktura e shfrytëzimit të tokës në rajonin e Pejës në ha

	Peja	Klina	Istogu
Toka e punueshme arat	7 141.92	10 214.33	9 091.08
Kopshte	54.51	34.41	50.51
Livadhet dhe kullotat	13 496.83	4 461.54	11 124.83
Kulturat shumëvjeçare	331.65	237.27	387.49
Pemët	287.16	213.86	376.32
Vreshtat	26.39	4.7	3.07
Fidanishtet	18.1	18.71	8.1

Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Siç shihet në grafikonin e mëposhtëm komuna e Klinës ka sipërfaqe më të madhe të tokës së punueshme – arave me 10,214.33 ha duke vazhduar me Komunën e Istogut 9,091.08 ha dhe komuna e Pejës me 7,141.92 ha. Komuna e Pejës dhe Istogut udhëheqin me kultivimin e perimeve, Peja ka sipërfaqe të madhe të kullotave dhe livadheve, për sa i përket kulturave shumëvjeçare /pemëve komuna e Istogut në këtë rajon ka sipërfaqe më të madhe me 376.32 ha pemë dhe 387.49 ha kultura shumëvjeçare.


Grafiku 26: Struktura e shfrytëzimit të tokës në rajonin e Pejës në ha



Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Numri i ekonomive bujqësore ne rajonin e Pejës është mjaft i lartë duke përfshirë 15,535 ekonomi bujqësore me rreth 67,025 ha sipërfaqe të tokës bujqësore, ndërsa në mesin e tre komunave të përfshira në këtë rajon numër më të madh të ekonomive bujqësore ka komuna e Pejës me 6,035 ekonomi bujqësore me gjithsej 2,3443.53 ha sipërfaqe, komuna e Istogut me 5,058 ekonomi bujqësore me 24,823.02 sipërfaqe tokësore dhe komuna e Klinës me numrin më të vogël të ekonomive bujqësore me 4,442 dhe sipërfaqe 18,758.94.

Grafiku 27: Numri i ekonomive bujqësore në rajonin e Pejës dhe sipërfaqja në ha



Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014


Toka në komunën e Pejës variron nga ajo e punueshme deri të pyjet dhe kullotat. Komuna e Pejës posedon 60,289 hektarë tokë. Nga kjo sipërfaqe e përgjithshme e tokës 51.74 % i takojnë tokës bujqësore, 42.66 % janë të përfshira me pyje, ndërsa djerrinat përfshijnë sipërfaqen prej 3,306 ha. ose 5.48 %. Nga grafikonet në vijim shihet që në komunën e Pejës në strukturën e tokës mbizotëron toka bujqësore me 31,253 ha tokë bujqësore , 21,005 tokë e punueshme, komuna dallohet për përqindje të lartë të pyjeve me 42, 66 përqind d.m.th posedon 25,709 ha pyje dhe kullotave 14 përqind, 10,248 ha.

Tabela 32: Struktura e shfrytëzimit të tokës në komunën Pejës

Struktura	%
Tokë bujqësore	51,74
Pyje	42,66
Tokë djerr	5.6

Toka	Njësia (ha)	%
Tokë jo bujqësore	29,037	48.2
Tokë e zhveshur	3,328	5.5
Pyje	25,709	42.6
Të tjera	0	3.7
Tokë bujqësore	31,253	51.8
Tokë e punueshme	21,005	34.8
Kullota	10,248	14
Gjithsej	60,289	

Grafiku 28 Struktura e shfrytëzimit të tokës në komunën Pejës




Burimi: Strategjia për zhvillim ekonomik në komunën e Pejës, 2013-2017⁹²

⁹² Strategjia për zhvillim ekonomik në komunën e Pejës, 2013-2017

Tabela 33: Paraqitja e strukturës së tokës sipas aktiviteteve në komunën e Pejës

Tabela: Sipërfaqja e tokës në Pejë dhe përdorimi		
Përdorimi i tokës	Sipërfaqja Ha	%
Arë	11,401.77	20.1
Kopshte	31.78	0.05
Pemishte	1,484.71	2.55
Vreshta	236.74	0.4
Livadhe	7,849.71	13.7
Kullota	10,247.72	18
Pyje	25,709.79	45.2
Gjithsej	56,962.22	100

Burimi: Agjencia Kadastrale e Kosovës⁹³**Grafiku 29: Paraqitja e strukturës së tokës sipas aktiviteteve në komunën e Pejës⁹⁴**


Burimi: Strategjia për zhvillim ekonomik në komunën e Pejës, 2013-2017

Në komunën e Pejës dhe përgjithësisht në Kosovë, perimet dominante që kultivohen janë speci, domatja, trangulli, qepa, lakra dhe shalqiri. Vlerësohet se rreth 87% e prodhimitarisë së perimeve vjen nga fermat më sipërfaqe më të vogla se 2 ha, ku rreth 25% e kësaj prodhimtarie përdoret për konsum në fermë dhe pjesa tjetër plasohet në treg.

⁹³Burimi: Agjencia Kadastrale e Kosovës⁹⁴Burimi: Strategjia për zhvillim ekonomik në komunën e Pejës, 2013-2017

Në komunën e Pejës në bazë të rezultateve të regjistrimit të bujqësisë, 2014 fermerët kultivojnë 771.37 ha me perime, ku speci përfshinë sipërfaqen prej 350.73 ha apo 46%, kultivimi i qepëve me 11% apo 87.04 ha, domate 9% apo 70.14, me lakër po ashtu 9% apo 70.79 ha, shalqi me 9% 70.63 ha, kungull misiri me 4% apo 29.85 ha, duke vazhduar me perime tjera të cilat zënë hapësirë më të vogël të kultivimit, por të cilat po ashtu janë perime të rëndësishme siç janë trangulli, hudhra, spinaqi, preshi, karota etj. Kjo mund të shpjegohet me faktin se dheu këtu është kryesisht me zall. Shumica e kulturave kanë rendimente më të larta në sipërfaqet e ujitura.

Grafiku 30: Struktura e kultivimit të perimeve në komunën e Pejës




Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014⁹⁵

Ndërsa kulturat me vlera të shtuara (perimet që ujiten mbulojnë rreth 26 % të sipërfaqes së kultivuar, njëra prej sfidave kryesore të fermerëve në komunën e Pejës është kultivimi sezonal i perimeve dhe mungesa e kapaciteteve për ruajtjen e produkteve bujqësore. Për ti ikur kufizimit vetëm me prodhimtari sezonale shihet nevoja për mbështetje me ngritjen e fushave të mbrojtura (serave) por edhe frigoriferëve me kapacitete të mëdha për ruajtjen e produkteve të freskëta për të mundësuar tregun e tyre

⁹⁵ Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

gjatë gjithë vitit, duke i zëvendësuar produktet e importuara nga jashtë. Kultivimi i pemëve përfaqëson potencialin më të lartë zhvillimor në bujqësi. Përgjithësisht në Kosovë në sektorin e prodhimtarisë së pemëve, në çdo vit mbillen rreth 150 hektarë me fidane pemë, ku prej tyre rreth 50 ha (33%) janë kryesisht me mollë. Pra siç shihet edhe në grafikonet në vijim molla në Kosovë është tradicionalisht një kulturë mjaft e kultivuar e kjo si rezultat i kushteve të favorshme klimatike. Aktualisht nuk kultivohet në sipërfaqe të mëdha por me mbështetjen e dhënë nga MBPZHR si dhe nga fondet e projekteve të ndryshme ka filluar rritja e numrit të pemishteve intensive. Përveç kësaj molla kultivohet në bazë të rezultateve të Regjistrimit të Bujqësisë, 2014 njëkohësisht edhe për edhe për nevoja shtëpiake.

Grafiku 31: Struktura e kultivimit të pemëve në Rajonin e Pejës



Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014⁹⁶


Pra kultivimi i pemëve në vitin 2015⁹⁷ ka kapur rreth 749 ha, vetëm në komunën e Pejës kemi 233.02 ha, ku kultivimi i mollës zënë 69% të sipërfaqes apo 523 ha, kumbulla me 14% apo 106.03 ha, lajthi 7% apo 52.17, kultivimi i dardhës me 4% apo 32.52 ha,

⁹⁶ Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

⁹⁷ Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë, 2014

duke vazhduar me përqindje rreth 1% të kultivimit të arrës, gështenjës dhe boronicës. Shikuar nga aspekti ekonomik sektori i pemëtarisë ju sjell fermerëve përfitime të shumta materiale. Molla vendore në Kosovë gjendet në treg nga fillimi i muajit Korrik e deri në fund të muajit Nëntor. Bazuar në çmimet e mollës për vitin 2013 silleshin nga 0.75 € në deri në 0.60 €, në muajin Nëntor duke vazhduar me trend pothuajse të përafërt edhe në muajin Dhjetor me 0.51 €. Në vitin 2014 për dallim nga viti 2013, çmimet në fillimin e sezonës së mollës vendore paraqiten më të larta duke filluar me 1.05 €, për të vazhduar në muajt tjerë me një mesatare të çmimeve rreth 0.60 €/kg. Nëse merret një mesatare e çmimit të mollës vendore 0.60 €/kg ku nga 523 ha me mollë dhe me një rendiment mesatar 40 ton/ha do të arrijë kontributi në ekonomi të fermerëve deri 14 mil euro në vit. Deri më tani vetëm 60 % të mollës vendore përdoret për nevoja shtëpiake ndërsa pjesa tjetër e prodhimtarisë, një pjesë shitet në treg dhe një pjesë shkon për përpunim. Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pasvjeljes, pikave grumbulluese si dhe depove ftohëse do të ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe furnizimin me pemë gjatë gjithë vitit.

Grafiku 32: Plantacionet e pemëve në komunën e Pejës sip/ha




Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014⁹⁸

⁹⁸ Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Kultivimi i drithërave në rajonin e Pejës luan një rol të rëndësishëm për sigurimin e ushqimit për njerëz dhe për kafshë. Gruri është kultura më e rëndësishme, rendimenti mesatar i arritur në vitin 2011 ka qenë 4,600 kg/ha, aktualisht ky rajon i plotëson nevojat me grurë 70-80%. Drithërat me kokërr nxënë 11,660.2 ha (37%) ku sipërfaqja me grurë zë 11,086.6 ha (35 %) të sipërfaqes së drithërave kokërr. Po ashtu misri si kulturë me rëndësi kultivohet në 5,730.04 ha (18%). Në bishtajoret kokërr dominon fasulja kokërr me 504.5 ha të sipërfaqes me bishtajore kokërr. Po ashtu bimët aromatike dhe medicinale zënë një hapësirë prej 166.22 ha, hasim edhe patatet me sipërfaqe 117 ha.

Grafiku 33: Struktura e prodhimit për kulturat kryesore



Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014⁹⁹

Ndërsa një pamje e gjendjes rreth sipërfaqeve të mbjella me bimët e arave dhe prodhimtarisë mesatare vjetore të tyre në komunën e Pejës është paraqitur në tabelat në vazhdim

Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë, 2014

Tabela 34: Sipërfaqet e mbjella dhe prodhimtaria mesatare vjetore


Kulturat	Sipërfaqe(Ha)	%	Prodhimi Kv	%
Gruri	2,450	21.4	102,900	11.5
Elbi	150	1.4	4,200	0.5
Misri	4,200	36.8	201,600	22.6
Fasule	2,110	18.5	75,960	8.5
Perime	1,592	14	238,800	26.7
Jonxh	900	7.9	270,000	30.2
Gjithsej	11,402	100	893,460	100

Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Sektori i blegtorisë

Prodhimtaria blegtorale konsiderohet sektor me mundësi të mëdha për zhvillimin socio ekonomik të Kosovës. Vlerësohet se në Kosovë ekzistojnë mbi 120,000 ferma që mbarështojnë kafshë blegtorale, mirëpo shumica e tyre janë të vogla, kryesisht ekzistenciale dhe gjysmë-ekzistenciale.

Kultivimi i gjedheve zë rreth 60% (gjysma e së cilave janë lopë qumështore) duke u pasuar nga kultivimi i kafshëve të imëta (dele dhe dhi) me rreth 30%, ndërsa në sektorin e shpezëve. Aquakultura (kultivimi i peshqve) dhe bletaria kanë pjesëmarrje më të vogël (DPB, 2009). Bazuar në rezultatet e Regjistrimit të Bujqësisë të Kosovës, 2014 komuna e Pejës ka 14,745 njësi blegtorale prej të cilave përqindjen kryesore e zënë gjedhet me 50%, shpezët me 37%, derrat 2%, delet 3%, dhi 2% si dhe 2% gomarë, mushka, kuaj etj.

Grafiku 34: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Pejës

Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014¹⁰⁰

Prodhimtaria e qumështit tradicionalisht ka luajtur rol të rëndësishëm. Si rezultat i përmirësimit të racave të lopëve qumështore, përmirësimit të metodave të të ushqyerit të kafshëve dhe praktikave të mbarështimit, llogaritet se mbi 70% të kërkesave të konsumit lokal për qumësht të freskët përmbushen nga prodhimi vendor, ndërsa rreth 25% importohet nga rajoni dhe BE-ja

Rëndësia e industrisë agropërpunuese si hallkë kryesore e zhvillimit të sektorit të blegtorisë qëndron në qëndrueshmërinë e furnizimit dhe në absorbimin e prodhimitarisë primare për nevoja të përpunimit. Prodhimet e qumështit duke përmbushë standardet higjienike, mjedisore, të mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë së ushqimit, mundësojnë që të prodhohen dhe paketohen si të fermentuara: jogurti, kosi, ajrani, djathi i bardhë dhe produkte të tjera. Në ekonomitë familjare, numri mesatar i lopëve qumështore është 1-5 krerë lopë. Vlerësohet se rreth gjysma e sasisë së qumështit të prodhuar përdoret për nevoja familjare (në fermë), sasia tjetër me rreth 40% shitet në tregje dhe vetëm 10%

¹⁰⁰ Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

përpunohet. Supozohet se ekzistojnë rreth 100,000 krerë dele qumështore me kapacitet prodhimi 8,000 tonë qumësht në vit. Kosova ka rreth 14,600 krerë dhi me kapacitet prodhues rreth 3,900 tonë qumësht. Gjithashtu kjo komunë ka 42,233 njësi blegtorale dhe rreth 11,562 njësi pune, Peja prinë me prodhimtarinë e qumështit në Kosovë duke u shndërruar kështu në komunë model për këtë prodhimtari. Kapaciteti ditor është 11,050 litra, me 16 pika grumbulluese të qumështit të freskët

Situata e ujitjes në rajonin e Pejës

Ujitja është ndër faktorët kryesor që mundëson zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore. Nën sistemin e ujitjes gjithsej janë të përfshira 8,501 ha. Me sistemin e kanaleve të ngritura (të betonuara) janë të përfshira 4,392 ha, kurse nga pendat primitive që ngriten për çdo vit nëpër lumenj dhe në burimet e ndryshme të ujit janë të përfshira 4,108 ha.

Për shkaqe të ndryshme, dëmtimi i kanaleve, mbyllja e vijave, presave, pendave si dhe për shkaqe të tjera, mund të thuhet se ujitet vetëm afër 40 % e sipërfaqes që është nën sistemin e ujitjes. Vetëm 67.5% është tokë e kultivuar.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur ndryshimet e rendimenteve të fituara në sipërfaqet e ujitura në krahasim me ato të pa ujitura .

Tabela 35: Sipërfaqja e ujitur për kulturat kryesore¹⁰¹

Kulturat	% e sipërfaqes se ujitur/totalit	Rendimenti Në ton	
		ujitur	Pa ujitur
Misër	46.9	4.43	3.84
Patate	14.1	32	21
Domate	1.9	30	28
Specat	2.2	18	12
Pjepër	3	17	12
Lakër	1.8	40	18
Marulla	1	5	3
Qepa	3.9	20	8
Fasule	2.8	1.9	1.5
Jonxha	18.9	4.8	2.9

Burimi: Drejtoria e bujqësisë në Pejë

Pamjaftueshmëria e mirëmbajtjes ka reduktuar edhe më tej, kapacitetin e kanaleve tradicionale. Efikasiteti i përgjithshëm tepër i ulët, ka reduktuar sipërfaqen nën ujitje dhe ka sjellë fermerët që të rrisin periudhën e rotacioneve gjatë sezonës kulmore, prej tre në katër javë. Madje edhe kulturat me rrënjë të thella si gruri, misri dhe jonxha vuajnë nga mungesa e ujit. Perimet nuk mund të përballen më këto kushte. Si rezultat, rendimentet janë të kufizuara dhe fermerët janë detyruar të ndërrojnë perimet me jonxhë dhe misër. Në tabelën në vijim shohim se në rajonin e Pejës kemi 6,333.25 ha të sipërfaqes që ujiten, ku madhësia e klasave të sipërfaqes së tokës bujqësore të ujitur në rajonin e Pejës është e ndryshme ku sipërfaqet nga 2 deri më pak se 5 ha ujiten 1,850.63 ha, nga 1 deri më pak se 2 ha ujiten 1,324.63 dhe po ashtu sipërfaqet e ngastrave nga 5 deri më pak se 10 ha ujiten me 816.96 ha.

¹⁰¹ Burimi: Drejtoria e bujqësisë në Pejë

Tabela 36: Sipërfaqja e ujitur për kulturat kryesore në rajonin e Pejës,¹⁰²

Madhësia e ngastrave	Ujitja në sip/ha
Gjithsej sipërfaqja e ujitur në ha	6,333.25
Më shumë se 0 dhe më pak se 0.25	202.93
Nga 0.25 deri në më pak se 0.5	361.98
Nga 0.5 deri në më pak se 1	873.21
Nga 1 deri në më pak se 2	1,324.63
Nga 2 deri në më pak se 5	1,850.73
Nga 5 deri në më pak se 10	902.81
10 e më shumë	816.96

Burimi:Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë,2014

Situata sociale - ekonomike dhe pozita gjeografike e Klinës¹⁰³**Zhvillimi Social-Ekonomik i Komunës së Klinës**

Komuna e Klinës është përcaktuar që të favorizoj zhvillimin e sektorëve me rëndësi strategjike për zhvillimin ekonomik të saj përmes shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe kapitalit human. Sektorët me rëndësi strategjike janë: agrobiznesi, turizmi, pasuritë nëntokësore, tregtia dhe shërbimet. Agrobiznesi përfshinë sektorin e prodhimit, arat, pemishtet, prodhimtarinë në serra, blegtorinë si dhe sektorin e agro përpunimit industrial.

Sektori i turizmit, Klina është një komunë që përfshinë zonat të cilat për vlerat që i kanë ose shërbimet që i ofrojnë janë më interes të posaçëm në nivel kombëtar. Monumenti i natyrës “MIRUSHA”, që është vlerë natyrore me interes kombëtar, resurs me potencial për zhvillimin e turizmit, speleoturizmit, poashtu i rëndësishëm për zhvillimin e eskurzoneve hulumtuese si për nevoja shkencore ashtu edhe ato arsimore.

¹⁰² Burimi:Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë,2014¹⁰³ Vlerësimi strategjike mjedisorë (VSM),Planin zhvillimor komunal të Klinës, 2013-2014

Gryka e lumit Klina është po ashtu vlerë natyrore e çmuar me potencial zhvillimi për shkak të karakteristikave gjeomorforlogjike, hidrologjike dhe botanike. Klina njihet po ashtu për pasuri nëntokësore: mihje të thëngjillit, rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjilës, pllakave për prodhimin e gurit si shenjë identifikuese e Komunës së Klinës.

Situata sociale - ekonomike dhe pozita gjeografike e Istogut

Komuna Istogut mbulon një sipërfaqe prej 454 km² dhe përfshin qytezën e Istogut dhe 50 fshatra. Istogu ka 39,289 banorë¹⁰⁴. Istogut shtrihet në pjesën më veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Nga veriu e kufizohet me malet e larta të Moknës, maja më e lartë e të cilave, Maja e Zezë, shtrihet në lartësi deri në 2,155 metra. Istogu karakterizohet me toka pjellore që përshkohen me tre lumenj relativisht të mëdhenj për kushtet e Kosovës. Lumi më i madh që kalon nëpër këto anë është Drini i Bardhë, burimi i Lumit të Vrellës. Pos këtyre lumenjve, në kohë të shirave janë të pasur me ujë edhe lumenjtë më të vegjël, si Bujena, Kujafçi, Shushica, Përroni i Sudenicës. Istogu ka një florë dhe faunë të pasur, kjo komune ka klimë, mezokontinentale që është e përshtatshme për kultivimin e drithërave, të perimeve dhe të pemëve. Fusha shtrihet në kuotat më të ulëta të lartësisë mbidetare në Kosovë, vetëm afër 350-400 metra.

Qëllimet afatgjata të zhvillimit:

- Zhvillimi i një agrikulture me prodhimtari primare, përpunim të produkteve kualitative bujqësore
- Zhvillimi i turizmit shëndetësor, malor dhe rural
- Përkrahja e ekonomisë së tregut përmes zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Arritja e një zhvillimi social të balancuar, me mundësi të barabarta të qasjes në shërbime për të gjithë

¹⁰⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

- Zhvillimi i qëndrueshëm hapësinor, një mjedis të gjelbër natyror duke i mbrojtur resurset - trashëgiminë natyrore dhe kulturore të komunës, si dhe të komunave dhe shteteve fqinje
- Zhvillimi i një infrastrukture të integruar, funksionale dhe shërbimeve të përshtatshme publike të zonës urbane

Bujqësia dhe zhvillimi rural në komunën e Istogut¹⁰⁵

Istogu karakterizohet si një vend i potencialit dhe traditës bujqësore me prodhime bujqësore kualitative, prodhime blegtorale kualitative, aquakulturë të zhvilluar si dhe sektorin e bletarisë dhe pylltarisë e ka të zhvilluar. Komuna e Istogut është e njohur si qendër me vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, atraktive për zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit: shëndetësor, malor, rural dhe kulturor.

Bizneset në sektorin e agrobiznesit janë kryesisht të orientuara në hurdat e peshqve, plantazhet e mollës, kultivimin e perimeve, industria për përpunimin e peshkut etj.


Vizioni për të ardhmen e komunës së Istogut bazuar në qëllimet, të definuara me Planin Hapësinor të Kosovës, ku territori i Istogut i takon “Kopshteve të Kosovës”. Tre janë shtyllat kryesore të zhvillimit të kësaj komune: agrobiznesi, turizmi dhe ndërmarrjet të cilat direkt dhe indirekt janë të lidhura me njëra tjetrën. Istogu është qendër me vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, atraktive për rekreacion dhe aventurë në natyrë. Bjeshkët e Nëmura dhe malet e Moknës janë elementet kyçe për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm – ekoturizmit. Infrastruktura turistike zhvillohet paralelisht me tendencat për mbrojtjen e tokës bujqësore, vendbanimit, peizazhit dhe mjedisit në përgjithësi. Koncepti i turizmit fokusohet në potencialet natyrore dhe kulturore të komunës.

Shumëllojshmëria e prodhimeve bujqësore përfshin: frutat dhe perimet, drithërat, bimët mjekësore dhe aromatike. Sektori i blegtorisë: dhentë dhe shpezët dhe prodhimet e

¹⁰⁵Plani zhvillimor komunal dhe rishikimi i planit zhvillimor urban-Istog


bletarisë. Prodhimet bujqësore prodhohen në kuadër të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kultivimi i pemëve në komunën e Istogut në vitin 2014¹⁰⁶ ka qenë rreth 313.59 ha, ku kultivimi i mollës zënë 49% të sipërfaqes apo 272.63 ha, kumbulla me 33 % apo 27.51 ha, kultivimi i dardhës me 12 % apo 4.79 ha, duke vazhduar me përqindje rreth 1% të kultivimit të pjeshkës, arrës dhe ftoit.

Grafiku 35: Plantacionet e pemëve në komunën e Istogut sip/ha



Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014¹⁰⁷

Grafiku 36: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Istogut



Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014¹⁰⁸

¹⁰⁶ Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë, 2014


¹⁰⁷ Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

¹⁰⁸ Po aty

Përshkrimi i gjendjes së përgjithshme të bujqësisë në komunën e Klinës

Rreth 95% e tokës së përgjithshme është tokë bujqësore, ndërsa vetëm 4.9% është tokë jopjellore. Në strukturën e tokave bujqësore, dominojnë arat me 12.734 ha, pyjet me 12.735 ha, livadhet me 2.184 ha, kullosat 2,043 ha etj.¹⁰⁹ Ka një sipërfaqe 308.8 km² me rreth 40,000 banorë. Komuna e Klinës ka një pozitë shumë të favorshme për zhvillimin e bujqësisë në luginën e lumit Drini i Bardhë. Kultivimi i drithërave, frutave dhe perimeve nxënë vendin kryesor. Në komunën e Klinës në vitin 2014¹¹⁰ pemëtaria ka zënë rreth 202.39 ha, prej të cilave kultivimi i mollës zënë 88 % të sipërfaqes apo 73.67 ha, kumbulla me 9% apo 50 ha, kultivimi i dardhës me 2 % apo 18.81 ha, duke vazhduar me përqindje rreth 1% të kultivimit të pjeshkës, arrës dhe ftoit.

Grafiku 37: Struktura e kultivimit të pemëve në komunën e Klinës




Burimi : Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014¹¹¹

¹⁰⁹ Draft PZHK e Klinës

¹¹⁰ Po aty

¹¹¹ Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Grafiku 38: Blegtoria dhe ekonomitë bujqësore në komunën e Klinës

Burimi: Analizë e autorit bazuar në Regjistrimin e Bujqësisë , 2014

Agro-përpunimi, tregu dhe marketingu

Zhvillimi i potencialeve agro-përpunuese do të ketë rol vendimtar për përmirësimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe zonave rurale të komunës së Pejës. Industria agro-përpunuese shërben si një instrument kryesor dhe i qëndrueshëm për prodhimin bujqësor.

Pjesa më e madhe e fabrikave përpunuese janë të vogla dhe marketingu i tyre është zakonisht i lokalizuar. Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë agro-përpunuese do të jetë vendimtar për një lidhje të përmirësuar të fermerëve me tregjet dhe një rritje të vlerës së produkteve lokale.

Fuqia negociuese e fermerëve është e vogël si pasojë e mungesës së informacionit mbi çmimet dhe mundësitë e kufizuara për shitje. Do të jetë e rëndësishme që të përmirësohet infrastruktura e tregjeve, për të funksionuar në mënyrë më efikase, si dhe të garantohet mirëmbajtja e tregjeve. Prodhimi organik po arrin që të zotëroj një segment në treg. Megjithatë, Peja ka infrastrukturë tregu të vjetër që nuk mundëson ruajtjen e cilësisë

dhe pastërtisë së produkteve kështu që edhe standardet e cilësisë duhen të përcaktohen dhe të zbatohen nga organet kompetente si inspektorati etj. Marketingu i produkteve të përpunuara nuk i takon një cilësie të lartë që do të rriste mundësinë që prodhuesit nga komuna e Pejës të konkurrojnë në tregjet rajonale dhe evropiane ku do të gjejnë hapësira tregtare. Peja ka mundësi për të eksploruar disa hapësira tregtare bujqësore, si me bimët mjekësore, produktet e qumështit, mjaltit dhe produkte të tjera të bletës etj. Veçanërisht viset malore janë shumë të pasura me bimët mjekësore, por zhvillimi duhet të orientohet drejt kultivimit të tyre, sesa grumbullimit në gjendje të egër, pasi që rrezikon mirëqenien dhe vijueshmërinë e këtyre burimeve natyrore me vlera dhe potenciale të larta për zhvillim ekonomik.

KAPITULLI V

5. Metodologjia e studimit

Analiza e mjedisit rural, e sistemeve të prodhimit bujqësor, përcakton në mënyrë të drejtpërdrejtë nivelet e ndryshme të organizimit të popullsisë në zonat rurale dhe njëkohësisht na jep mundësitë për zhvillimin të tyre. Në këtë kuadër identifikimi i tipeve të fermave bujqësore do të ndikojë realisht në identifikimin e tipeve të qëndrueshme dhe afatgjata të cilat do të çojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale.

Në mënyrë që kjo analizë e fermave të jetë efikase është e rëndësishme që ti japim përgjigje një sërë pyetjesh që shtrohen në këtë drejtim:

1. A çon funksionimi i sistemeve të prodhimit ekonomik në një shfrytëzim të qëndrueshëm të të gjitha aseteve të fermës bujqësore
2. A janë këto sisteme ekonomikisht të qëndrueshme
3. Cilat janë potencialet e fermave për treg

Zgjedhja e një metodologjie analitike është e lidhur me objektin dhe objektivat e studimit, ku qëllimi i saj është verifikimi i hipotezave të studimit. Për të realizuar një analizë sa më efikase, metodologjinë e studimit e kemi realizuar në katër etapa:

1. Paradiagnostika;
2. Mbledhja e të dhënave;
3. Analiza e të dhënave dhe përpunimi i informacionit;
4. Interpretimi i të dhënave dhe konkluzionet.

4.1. Paradiagnostika

I gjithë procesi i paradiagnostikës u zhvillua në katër faza kryesore të cilat po i analizojmë më poshtë.

4.1.1. Grumbullimi dhe analizimi i dokumentacionit të disponueshëm

Faza e parë e studimit tonë ka të bëjë me hulumtimin e të gjitha botimeve brenda dhe jashtë Kosovës në lidhje me analizën e tipologjisë së fermave bujqësore brenda dhe jashtë vendit.

Burimet kryesore të informacionit mbi të cilat jemi mbështetur i kemi listuar si më poshtë:

- Informacionet e përgjithshme rreth zhvillimit të bujqësisë dhe veçorive sociale dhe ekonomike të zonave të studimit. Këto informacione janë grumbulluar nga dokumentet e disponueshme të Ministrisë së Bujqësisë, Agjencioni i Statistikave etj;
- Strategjitë zhvillimore të tre rajoneve të studimit: Pejë, Gjakovë dhe Prizren.
- Informacione teorike mbi tipologjinë e fermave, me qëllim përcaktimin e modelit ku duhet të mbështetemi.

Gjithashtu faza e parë e doktoraturës na shërbeu për të nxjerrë në pah problemet kryesore të zhvillimit të zonave rurale në Kosovë dhe njëkohësisht për të përcaktuar hipotezat mbi të cilat do të fokusohet puna jonë si dhe për formulimin e pyetjeve kryesore të cilat do të shërbenin si piketat e para të studimit dhe formulimit të pyetësorit

4.1.2. Përcaktimi i zonës së studimit

Zgjedhja e zonës së studimit nuk mund të jetë e rastësishme, sepse duhet të marrim në konsideratë kritere të cilat në pamje të parë duhet të kenë efekt në mënyrat e funksionimit të fermave bujqësore dhe në administrimin e mjedisit të përgjithshëm.

Pra në këtë këndvështrim, ne zgjodhëm zonat e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit duke u nisur nga një sërë kriteresh.

- ✓ Elementet që lidhen me mjedisin fizik. Të tre zonat shtrihen në rrafshin e Dukagjinit dhe kanë kështu karakteristika pak a shumë të ngjashme mes tyre;
- ✓ Përbërësit social-ekonomike;
- ✓ Potencialet e zhvillimit lidhen me njohuritë tradicionale që ka popullsia e zonave për prodhimin e një sërë kulturash bujqësore e blegtorale;
- ✓ Produktiviteti i tokës (euro për hektar) -një tregues i intensifikimit të tokës në rajon;
- ✓ Rajone të njohura për bujqësi.

Tabela 37 : Variablat kryesore në FADN sipas rajoneve në euro/fermë¹¹²


Rajonet	Outputi total	Të hyrat e përgjithshme	Vlera e shtuar neto në fermë	Të hyrat familjare
Prishtina	14,607	11,595	10,544	10,143
Mitrovica	18,782	14,713	13,783	10,543
Peja	14,821	12,273	11,331	10,889
Gjakova	15,640	12,440	11,259	10,975
Prizreni	13,271	10,741	9,989	9,570
Ferizaji	10,164	9,370	8,597	8,313
Gjilani	10,663	9,180	8,428	8,421

Burimi:MBPZHR, bazuar në FADN

¹¹² Burimi:MBPZHR, bazuar në FADN


Arsyet e mësipërme na shërbyen për të përcaktuar qartë se cilat do të ishin saktësisht zonat e studimit dhe cilat do të ishin fermat ku do të realizonim anketimet.

Harta15: Zonat e studimit¹¹³



¹¹³ Regjistrimi i bujqësisë 2014 & ASK 2015

Harta16: Rajoni i Pejës



Harta 17: Rajoni i Gjakovës



Harta 18: Rajoni i Prizrenit



Përzgjedhja e mostrës

Për të përzgjedhur tipet e fermave që do të studiojmë jemi mbështetur tek metoda e Rrjetit të Kontabilitetit në Fermë (FADN). Ky është një instrument për vlerësimin e të ardhurave të fermave bujqësore e cila u përdor për herë të parë në vitin 1965, kur Këshilli Rregullator 79/65 përcaktoi bazën ligjore për organizimin e këtij rrjeti. Kjo metodë ka për qëllim gjetjen e një mostre përfaqësuese e cila mbështetet në tre aspekte kryesore:

1. Rajoni 2. Vlera ekonomike e fermës dhe 3. Tipi i fermës.

Të gjitha vendet anëtare të BE-së duhet të ndjekin të njëjtat rregulla të mbajtjes së të dhënave me qëllim krijimin e një baze të dhënash mikroekonomike unike dhe të harmonizuara (European Commission, 2013¹¹⁴). Vitin e fundit këtë metodologji e ka adaptuar dhe Republika e Kosovës. Në vendin tonë kjo bazë të dhënash sapo është krijuar dhe kështu nuk të krijon mundësinë e shfrytëzimit të saj, apo të përdorimit të modeleve të ndryshme statistikore. Gjithashtu në të nuk ekzistojnë të dhëna disa vjeçare të cilat mund të na jepnin mundësi për analiza të thelluara në drejtim të të ardhurave, apo tipit të fermave bujqësore që ekzistojnë në Kosovë. Për këtë qëllim ne kemi përdorur metodën e FADN-së vetëm për klasifikimin e të ardhurave që vijnë nga fermat bujqësore, me qëllim identifikimin e atyre që janë të përshtatshme për analizën tonë.

Brenda fushës së hulumtimit të FADN-së, ekziston një diversitet i madh i aktiviteteve bujqësore. Disa ferma janë shumë të mëdha (në aspektin e madhësisë së tyre ekonomike), ndërsa të tjerat mund të jenë shumë të vogla. Disa ferma janë të përqendruara në prodhimin e kulturave të ndryshme, disa të tjera janë të specializuara në rritjen e bagëtive, si dhe ferma tjera që janë të përziera dhe kanë si aktivitet prodhimtarinë bimore dhe shtazore.

¹¹⁴ European Commission, 2013

Pra nëpërmjet kësaj metode ne kemi përcaktuar intervalet e përzgjedhjes së tipit të fermave pasi nuk mund të merren në konsideratë të gjitha fermat bujqësore, por vetëm ato që kanë një vlerë ekonomike dhe që si pasojë mund të konsiderohen si komerciale. Gjithashtu kjo metode krijon mundësinë e analizimit jo vetëm të fermave që merren me aktivitet bujqësor, por dhe të atyre që merren me agro-turizëm apo pylltari.

Përpara se të përcaktojmë mostrën e studimit duhet të identifikojmë fermat kosovare në bazë të tipologjisë së Bashkimit Evropian. Për të mundësuar klasifikimin e fermës, përcaktojmë Outputin Standard që është vlera mesatare monetare e prodhimit bujqësor me çmime të produkteve në fermë për çdo produkt bujqësor në një rajon të caktuar.

Ai llogaritet në vendet e BE-së për hektar ose për kokë bagëtish duke përdorur të dhëna themelore për një periudhë 5 vjeçare. Koeficientet e Outputit Standard të aplikuar në Kosovë i janë referuar të dhënave të përlllogaritura nga MBPZHR për vitin 2014 (Tabela 38).

Shumëzimi i koeficientit specifik të Prodhimit Standard (apo siç përdoret në terminologjinë e FADN-së Standard Outputi-SO) të fermës, me madhësinë e fermës së caktuar të përmbledhur në nën totalin e shumëzimit, fitojmë vlerën SO të një ferme, që pasqyron kapacitetet e përhershme të gjenerimit të të ardhurave varësisht nga struktura e prodhimit e cila kushtëzohet nga karakteristikat agro-ekologjike. Në këtë rast SO është përdorur për të përcaktuar madhësinë ekonomike të një ferme. Pjesëmarrja e vlerës së Prodhimit Standard (SO) të fermës së caktuar në prodhimin e përgjithshëm të një ferme karakterizon llojin ose tipologjinë e fermës (përcaktimi i të dhënave të Outputit Standard është përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë).

Tabela 38 :Koeficientët e Outputit Standard për Kosovë

Produkti	Outputi Standard (€/ha, €/krerë)
Grurë	482
Patate	4,722
Misër kokërr	815
Tërshërë	351
Elb	425
Fasule	460
Perimet në fushë të hapur	3,454
Perimet nën strehë-sera	36,767
Misër për sillazhë	1,653
Drithërat tjera për sillazhë	221
Pemë të ndryshme	2,183
Pemë të imëta (manore)	2,211
Arra	885
Rrush	1,496
Lopë gumështore	584
Delet ³	19
Delet tjera ⁴	21
Dhitë ⁵	25
Dhi të tjera ⁶	32
Dosat për mbarështim	151
Derrat për trashje	69
Pula ferme	3
Pula kllloçkë	5
Shpezë të tjera	10
Bletë	24

Burimi: MBPZHR

Të gjitha fermat që nuk kalojnë pragun minimal të përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë, në nivelin 2,000 Euro në vit nuk mund të jenë pjesë e mostrës së studimit. Ky përcaktim është bërë në bazë të rregullores evropiane si dhe në bazë të të ardhurave të fermës e cila duhet të jetë në nivel të tillë që fermeri të përballojë shpenzimet e tij dhe të familjes.

Kufijtë e zbatuar nga disa shtete anëtare të BE-së mund të shihen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 39 :Kufiri i SO në disa vende të BE-së (000 €)

Vendi	Kufiri i SO (000 €)
Holanda	25
Austria	8
R. Çeke	8
Estonia	4
Hungaria	4
Italia	4
Portugalia	4
Sllovenia	4
Bullgaria	2
Kosova	2
Rumania	2

Burimi: EU FADN 2014

Pragu ose kufiri i përzgjedhjes së madhësisë së fermave është i lidhur me madhësinë mesatare të fermës së një vendi: sa më e madhe të jetë madhësia mesatare e fermave aq më i lartë është pragu i aplikuar. Në këtë mënyrë, ne kemi përzgjedhur fermat të cilat kanë një aktivitet të qëndrueshëm ekonomik. Ndërsa fermat me të ardhura shume të larta, të quajtura ferma të mëdha, nuk janë përfshirë në kampionin pasi konsiderohen si vlera skajore sepse e prishin mesataren. Për të anketuar fermat të cilat plotësojnë kriteret e vendosura i jemi referuar të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Me pas përzgjedhja e fermave që plotësonin kriteret u bë në mënyrë të rastësishme në bashkëpunim me drejtoritë për bujqësi në komunën e Gjakovës, Prizrenit dhe Pejës.

Nisur nga kriteret e FADN-së, ne kemi realizuar një tipologji të fermave mbi bazën e aktivitetit të tyre. Analizimi i këtij të fundit do të na japë mundësi të evidentojmë jo vetëm potencialet e tyre në tregun vendas por dhe ato që kanë mundësi eksportuese. Kjo analizë në mënyrë të logjikshme do të na çojë në një analizë krahasuese mes tipeve të fermave dhe efektivitetit ekonomik për të gjetur ato që janë më të suksesshme.

Sigurisht nëse do të nisemi thjesht vetëm nga kriteri i fitimit nuk do të kishte asnjë dyshim që pemëtaria dhe vreshtaria do të ishin çelësi i suksesit. Por problemi është shumë me kompleks se kaq dhe për këtë arsye duhet të studiohen të gjitha aspektet e trekëndëshit të qëndrueshmërisë: ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave u bazua te puna në terren dhe tek grumbullimi i të dhënave, pranë njësive të prodhimit bujqësor (fermave), si dhe tek të gjitha palët e interesuara në zonë të cilët kontribuojnë në zhvillimin e saj. Të dhënat e grumbulluara janë sasiore dhe cilësorë. Me poshtë po japim treguesit e marrë në konsideratë për këto dy kategori të dhënash.

Treguesit sasiorë

Treguesit ekonomik të cilët masin :

- Të ardhurat që vijnë nga puna në fermë (të ardhurat e gjeneruara nga burime të ndryshme);
- Shpenzimet në fermë;
- Të dhëna rreth aktivitetit bujqësor e blegtoral;
- Të dhëna rreth efektivitetit ekonomik të fermave;
- Treguesit demografikë me anë të të cilëve shihen tendencat e popullsisë në zonë.

Treguesit cilësorë

- Format e organizimit të shoqërive në zonat rurale;
- Impakti i politikave të përdorura në popullsinë e zonave rurale;
- Përfitimi nga skemat mbështetëse;

- Vizioni për të ardhmen e familjes fermere.

Përgatitja e pyetësorit

Për mbledhjen e informacionit është ndërtuar një pyetësor gjysmë i mbyllur, i zhvilluar në tre zona të ndryshme gjeografike.

Pyetësi përbëhet nga këto pjesë:

- Informacioni përgjithshëm, i cili përmban të dhëna të përgjithshme mbi fermerin dhe anëtarët e familjes si: niveli i punësimit, niveli i shkollimit, zotësitë e fermerit, si dhe të dhëna më analitike për elemente tjerë në lidhje me punën në fermë, shtëpi dhe edukimin e fëmijëve. Me poshtë po paraqesim pyetjet e bëra për kapitalin njerëzor.

Tabela 40: Përmbajtja e pyetësorit, fermeri

Të dhëna për fermerin	Emri, Mbiemri i fermerit Gjinia, mosha, arsimi Numri i personave në familje Numri i anëtarëve në moshë pune Anëtarët që punojnë në fermë Anëtarët që punojnë jashtë saj por jetojnë së bashku Anëtarët që punojnë jashtë saj por kontribuojnë financiarisht në familje Numri i personave të punësuar në fermë (të rregullt, sezonale) Numri i ditëve të punës dhe paga/ditë pune
-----------------------	--

Burimi: Anketa 2015

Ky grup pyetjesh ka pasur si qëllim që të na tregojë mënyrën e organizimit të fermës bujqësore, nivelin e edukimit, numrin e personave në familje. Njëkohësisht nëpërmjet analizimit të aktiviteteve me të cilat merren anëtarët e familjes do të tentojmë të nxjerrim ne pah kontributin e gruas si pjesë e rëndësishme e familjes dhe e aktiviteteve që zhvillohen në fermën bujqësore.

- b. Informacioni për fermën ku u mblodhën të dhëna në lidhje me sasinë e tokës në pronësi, çmimin e tokës, kultivimi, posedimi i mekanizmit bujqësor aksesin në burimet e përbashkëta. Në këtë pjesë gjithashtu kemi bërë një pyetje të rëndësishme në lidhje me regjistrimin në librin kombëtar të fermave bujqësore.

Tabela 41: Përmbajtja e pyetësorit, ferma

Ferma	Sipërfaqja e fermës (në ha) Informacion nëse ferma është pjese e regjistrit të fermave E blerë, e shitur, dhënë me qira, marrë me qira Çmimi i tokës Numri i parcelave, sipërfaqja e parcelave Sipërfaqja në sera, kullota, livadhe, pyje Sipërfaqja e lënë djerrë Niveli i mekanikës bujqësore
-------	--

Nëpërmjet këtij grupi pyetjesh kërkohet të analizohet sipërfaqja e fermës, numri i parcelave, niveli shfrytëzimit të fermës bujqësore si pjesë e rëndësishme e procesit të riprodhimit bujqësor.

- c. Informacioni në lidhje me efektivitetin ekonomik të fermave bujqësore ku kemi analizuar kultivimin e kulturave bujqësore apo mbarështimin e blegtorisë. Këtu jepen me detaje tipet, sasia dhe çmimi i shitjes së produkteve bujqësore e blegtorale. Në këtë pjesë analizohet dhe efektiviteti ekonomik i fermës. Gjithashtu bëhet dhe një analizë e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të gjitha këto informacione do të shërbejnë për më vonë si pikë kryesore në ndërtimin e tipologjisë së fermave në zonat e studimit.

Tabela 42: Efektiviteti ekonomik i fermave bujqësore¹¹⁵

Efektiviteti ekonomik i fermës	Lloji i kulturave bujqësore Sipërfaqja e mbjellë Prodhimi ne vitin e kaluar, rendimenti Aktiviteti blegtoral Prodhimet nga blegtoria Përpunimi i produkteve bujqësore Përfitimet nga shitja e qumështit Shpenzimet në fermë Analiza e të ardhurave dhe shpenzimet
--------------------------------	---

- d. Informacione të përgjithshme në lidhje ndikimi i instrumenteve të politikës bujqësore dhe evoluimi i mundshëm në të ardhmen në favor të zhvillimit të bujqësisë, informimin, përkrahjen me grante, subvencione të fermerëve dhe ekonomive bujqësore etj. në kuadër të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-2014 palët e interesuara në zonë si dhe projektet e zhvillimit¹¹⁶

Përkrahja nga politikat mbështetëse dhe fiskale	Informimi Përkrahja me grante dhe subvencione. Programet shtetërore dhe të BE-së Preferencat e fermerëve për përkrahje të mëtutjeshme me politika mbështetëse.
---	--

Ndërsa pjesa e fundit e pyetësorit është lënë për të kuptuar aspektet institucionale si dhe politikat e strategjitë që mendohen të ndërmerren në zonë në kuadrin e strategjisë ndërsektoriale të zhvillimit rural 2014-2020 si dhe mbështetja që mendohet t'ju jepet fermerëve nëpërmjet Agjencisë së Pagesave.

¹¹⁵ Burimi: Anketat 2015

¹¹⁶ Në aneks do të jetë pyetësori i plotë i realizuar në zonën e studimit

4.2.2. Realizimi i anketës

Anketat në zonën e studimit, janë zhvilluar në muajt Prill – Tetor 2015. Realizimi i anketës u bë në dy faza. Në muajin Prill u bë testimi i anketës në zonë nëpërmjet të një vëzhgimi pilot. Numri i pyetësorëve test ishte 21. Në çdo rajon u zhvilluan nga 7 anketa. Nga ky testim rezultoi se nuk ishin marrë në konsideratë disa elemente në lidhje me të ardhurat që vinin nga aktiviteti bujqësor, si dhe u vunë re disa gabime në kodimin e pyetësorit. Si përfundim, mund të themi se realizimi i anketës pilot ishte shumë i vlefshëm sepse bëri të mundur kryerjen e një sërë modifikimesh të cilat ishin të nevojshme për pyetësin përfundimtar.

Gjatë muajve në vijim u realizua anketimi përfundimtar, ku u zhvilluan 444 pyetësorë nga 500 pyetësorë në total. Gjashtë pyetësorë rezultuan të pavlefshëm për shkak të gabimeve në plotësim apo shifrave jo reale. Si përfundim u realizuan 135 pyetësorë në rajonin e Pejës, 149 pyetësorë në rajonin e Prizrenit dhe 160 pyetësorë në rajonin e Gjakovës.

Përcaktimi i madhësisë së kampionit u bë duke u mbështetur në kriteret për përzgjedhjen e fermave sipas aktiviteteve nisur nga të dhënat e FADN-së në Kosovë. Zakonisht përzgjedhja e fushës së FADN-së në EUROSTAT ose vendet e BE-së bëhet nga Anketa e Strukturës së Fermës (FSS) (European Commission 2014¹¹⁷). Meqenëse kjo lloj ankete nuk zhvillohet në Kosovë, ka qenë e domosdoshme të zëvendësohet me të dhëna të përafërta nga Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore (Raporti FADN-së Kosovë 2014¹¹⁸). Sistemi i peshimit apo faktori rritës ka shërbyer për përlllogaritjen e rezultateve standarde, të cilat janë grupe statistikore të nxjerra nga libri i fermës që prodhohen dhe publikohen në forma të rregullta kohore. Ato përshkruajnë detaje të

¹¹⁷ European Commission 2014

¹¹⁸ Raporti FADN Kosovë 2014

konsiderueshme të situatës ekonomike të fermave të grupuara në grupe të ndryshme stratifikimi (Raporti FADN Kosovë 2014¹¹⁹).

Tabela 43 Treguesit e fermes në tre rajonet e studiara

Komunat	Numri i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha) Gjithsej	Numri i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha) Per token e shfrytezueshme	Numri i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha) Per token e punueshme
Pejë	15,535	67,025.48	15,476	56,626.37	13,840	26,447.33
Prizren	23,534	97,597.08	23,425	80,647.22	18,483	22,210.12
Gjakovë	15,145	60,121.19	15,067	47,181.96	12,068	20,115.02

Burimi; Regjistri i Bujqësisë së Kosovës 2014

Analiza jonë për zgjedhjen e mostrës së kërkimit u mbështet në treguesit e fermës në tre rajonet e studiara. Kriteri kryesor ka qenë madhësia e fermës në këto rajone. Gjithashtu kemi shfrytëzuar jo vetëm vlerën në madhësi mesatare e cila rezulton si një veprim i thjeshtë por edhe vlerat e outputit standard për fermë. Nga përpunimi i të dhënave në tabelën e mësipërme, në rajonin e Pejës rezulton se sipërfaqja mesatare është 4.3 ha për fermë, në rajonin e Prizrenit rezulton 4.1 ha dhe në atë të Gjakovës 3.9 ha. Nga ana tjetër në qoftë se analizojmë vetëm tokën e shfrytëzueshme, mesataret e sipërfaqeve të fermës për të tre rajonet ndryshojnë dhe më konkretisht: për rajonin e Pejës me 3.6 ha për fermë, atë të Prizrenit në 3.4 ha për fermë dhe rajonin e Gjakovës në 3.1 ha për fermë. Dukshëm kemi një mesatare më të lartë në rajonin e Pejës. Gjithsesi, për të qenë sa më përfaqësues kemi krahasuar edhe mesataren për tokën e punueshme për fermë dhe ka rezultuar se në rajonin e Pejës është 1.9 ha për fermë, rajonin e Prizrenit 1.2 ha dhe rajonin e Gjakovës 1.6 ha për fermë. Në përllogaritjen e fundit rezulton një rënie shumë e madhe e sipërfaqes së fermës për rajonin e Prizrenit kjo për shkak se aktiviteti kryesor i zonës dhe fermat

¹¹⁹ Po aty

kryesore në rajon janë ato blegtorale. Nisur nga analiza e mësipërme mbi mesataren tokës për fermë dhe asaj të punueshme, rrjedhimisht jemi përpjekur që numri i pyetësorëve për çdo rajon të jetë në proporcion me madhësinë totale të fermave në rajon, dhe jo me një numër të barabartë për çdo rajon. Përfaqësueshmëria është më e ulët në Rajonin e Pejës me 135 pyetësorë pasi mesatarja e fermës është më e madhe dhe outputi është më i madh dhe si pasojë këto ferma kanë konkurrueshmëri më të lartë. Pra për të mos patur diferenca të mëdha në të ardhurat e fermës për rajone të ndryshme dhe për të vlerësuar realisht konkurrueshmërinë mes tyre vlerat i kemi marrë duke u nisur nga outputi total i pritshëm për të gjithë rajonin.

Në zonën e studimit në tre rajonet kemi 54,246 ferma, me ç'rast me largimin nga studimi i fermave të vogla jo komerciale d.m.th me të ardhura nën 2,000 euro, total fermat që kanë qenë të përfshira në studim ishin 24,940 ferma me të ardhura mbi 2,000 euro, ku në analizë është përfshirë kampioni 499 ferma si objekt studimi d.m.th 2% nga totali i fermave .

Gjithashtu mbështetur në të dhënat e FADN-së janë përjashtuar fermat me të ardhura nën 2,000 euro. Për këtë arsye në tabelën e mëposhtme kemi vendosur dhe kufijtë e përcaktuara nga FADN.

Tabela 44: Kufijtë e ulët dhe të lartë të përfshirë në rrjetin e FADN-së

	Kufiri i ulët (numer)	Kufiri i lartë (numer)
Lopë qumështore (nr)	4	40
Bletë (nr. koshereve)	20	100
Serra (ha)	0.02	0.5
Dele, Dhi (nr)	50	300
Perime (ha)	0.5	3
Pemë (ha)	0.3	3
Pula vojse (nr)	1,000	15,000
Tokë punuese (ha)	3	30

Burimi: Anketa e FADN-së

Me kufijtë e fermave të përzgjedhura në mostër është vlerësuar se plotësohen kushtet për përfshirjen e fermave që janë përzgjedhur për të realizuar studimin tonë.

Anketat janë zhvilluar në mënyrë personale me një nga anëtarët e familjes dhe pa pjesëmarrjen e pjesëtarëve të tjerë në mënyrë që informacioni i mbledhur të ishte sa më i saktë dhe i anketuari të mos influencohej nga opinioni i pjesës tjetër të familjes. Gjithashtu është e rëndësishme të thuhet se pjesa më e madhe e informacionit është mbledhur nga të anketuarit meshkuj (87%) për faktin se shpesh herë të anketuarat femra nuk dëshironin të përgjigjeshin, ose nuk kishin informacionin e nevojshëm.

Kontrolli i anketave

Kontrolli i anketave u zhvillua në dy etapa. Kontrolli i parë u krye menjëherë pas mbarimit të anketës, ku u panë gabimet e mundshme ose harresa që mund të ishin bërë gjatë procesit të anketimit. Ndërsa në etapën e dytë u krye kryqëzimi i të dhënave me të dhënat e rajoneve të studimit, për të verifikuar besueshmërinë e informacionit nga ana e të anketuarve.

Analiza e të dhënave dhe përpunimi i informacionit

Anketa është koduar paraprakisht me qëllim mundësimin e përpunimit të rezultateve të grumbulluara nga pyetësorët. Më pas, për të lehtësuar përpunimin e pyetësorëve, kemi ngritur një bazë të dhënash në programin Google format. Përdorimi kësaj baze të dhënash lehtësoi ndjeshëm punën tonë, pasi informacionet shpejtë plotësohen, shumë më lehtë mund të përpunohen dhe analizohen të dhënat. Gjatë programimit të bazës së të dhënave është patur parasysh që të dhënat e hedhura, të kontrolloheshin në mënyrë automatike për të ulur nivelin gabimeve të hedhjes të informacionit në formë elektronike. Njëkohësisht është mundësuar dhe kontrolli logjik i realizuar në mënyrë automatike i

vlerave të disa variablave (kështu për shembull numri i anëtarëve në moshë pune, nuk mund të jetë më i madh se numri total i anëtarëve të familjes, sipërfaqja e shitur nuk mund të jetë më e madhe se sa sipërfaqja totale e poseduar e tokës etj.). Një kontroll i tillë automatik, është përdorur për pyetjet e familjes, sipërfaqes së fermës, sipërfaqes së shitur dhe asaj totale etj. Me anë të këtij kontrolli ulet niveli i gabimit të hedhjes të të dhënave dhe kontrollohet edhe njëherë niveli i plotësimit të anketave.

Përpunimi i tyre është bërë me anë të programit informatik me SPSS 17 i cili kishte si qëllim ndërtimin e një modeli statistikor që në rastin tonë rezultoi metoda Cluster.

Në analizën tonë për të zhvilluar dhe përcaktuar tipologjinë e fermave në Kosovë jemi mbështetur në metodën kërkimore të klasifikimit.

Tabela 45 : Struktura e metodologjisë së studimit¹²⁰

Pjesët përbërëse të metodologjisë	Elementët praktikë të metodologjisë	
Përzgjedhja e metodologjisë praktike	Grumbullimi i informacionit nëpërmjet anketave	Anketa në Rrafshin e Dukagjinit
	Përcaktimi i zonës së studimit	Rajoni Pejë, Gjakovë, Prizren të cilat konsiderohen si rajone tipike bujqësore
	Zgjedhja e fermave përfaqësuese	Metoda FADN
	Pyetësi i përdorur	Pyetësor gjysmë i mbyllur
	Organizmi i anketave	Kryerja e një niveli anketash përfaqësuese
Grumbullimi i informacionit praktik	Zhvillimi i anketave	Anketa personale me drejtuesin e fermës
Përpunimi i informacionit të grumbulluar	Analiza Cluster	Programi SPSS 17 (identifikimi i tipologjisë së fermave nëpërmjet klasterifikimit)

Burimi: Analizë e autorit, 2016

¹²⁰ Burimi: autori

Përcaktimi i metodës Cluster

Në mënyrë që të ndahen fermat sipas rangut të variablave të diskutuara më poshtë, analiza e cluster u zgjodh për shkak të fuqisë së saj në përcaktimin e grupeve homogjene të objekteve, ose fermave në rastin tonë. Me hulumtimet fillestare identifikuam se formimi i grupeve është penguar nga multicollinearity midis variablave. Për t'u marrë me këtë problem, siç sugjerohet nga (Ketchum dhe Shook (1996¹²¹), analiza faktor ishte i punësuar dhe rezultatet përfundimtare të faktorit për çdo vëzhgim përdoren si bazë për clustering.

Klasterat janë grupime në një zonë të caktuar gjeografike të bizneseve/sipërmarrjeve të furnitorëve të specializuar, ofruesve të shërbimeve, firmave në industritë mbështetëse apo institucioneve tjera (si universitete, agjenci që përcaktojnë standardet apo shoqata biznesi), të cilat bashkëpunojnë për të ofruar disa produkte ose shërbime.

Termi cluster analysis ose analiza e grupimit të dhënave (u përdor për herë të parë nga Tryon, 1939¹²²) e cila përfshin një numër algoritmesh të ndryshme dhe metodash për të mbledhur objekte të të njëjtit lloj në kategori respektive.

Njihën disa lloje klasterash të cilat renditen si më poshtë.

- **Klasterat gjeografikë:** janë të ndërtuara për shkak të arsyeve gjeografike, si vendndodhja e atyre burimeve të nevojshme për procesin e prodhimit apo klasterat lokalë, të cilat i shërbejnë kryesisht konsumatorëve të përqendruar në atë zonë, si dhe klasterat tregtarë që ndryshe nga klasterat lokalë i shpërndajnë produktet e tyre edhe jashtë zonës ku është vendosur klasteri, madje dhe i eksportojnë.

¹²¹ Ketchum dhe Shook (1996)

¹²² Tryon, 1939

- ***Klasterat horizontalë:*** nënkupton ndërveprimin e firmave dhe industrive duke ndarë burimet dhe njohuritë.
- ***Klasterat vertikale:*** bashkojnë organizata, të cilat janë të bashkërenduara dhe të vendosura në hallka të ndryshme të zinxhirit të vlerës. Shumë klastera përfshihen në këtë kategori por kanë rezultate të ndryshme në varësi të bashkërendimit mes aktorëve dhe nivelit të shfrytëzimit të potencialit të secilit.
- ***Klasterat sektorial:*** ndërtohen nga organizata që operojnë në të njëjtin sektor dhe ofrojnë një produkt ose shërbim si turizëm, produkte bujqësore, etj. Anëtarët në klaster mund të jenë të ndërlidhur horizontalisht ose vertikalisht.

Krijimi i klasterave përbën një zgjidhje të mirë për sektorin e agrobiznesit duke rritur njëkohësisht konkurrueshmërinë afatgjate brenda sektorit bujqësor. Një rrjet i tillë i rritjes së vlerës është ndërthurje ose bashkim i:

- ***Marrëdhëniet vertikale*** mes furnitorëve të lëndës së parë dhe faktorëve të tjerë të prodhimit, prodhuesve të produkteve bujqësore, përpunuesve dhe eksportuesve, blerësve me shumicë dhe shitësve me pakicë si dhe konsumatorëve
- ***Marrëdhëniet horizontale*** mes prodhuesve, kryesisht të bashkuar në formën e kooperativave përgjegjëse për kultivimin dhe përpunimin e lëndës së parë;
- ***Marrëdhëniet mbështetëse*** mes prodhuesve dhe organizatave mbështetëse, si qeverisja vendore, ofruesit e shërbimeve të biznesit, institucionet kërkimore, universitetet dhe organizatat jo-qeveritare të shërbimeve, të cilat mundësojnë arritjen e treguesve të cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së zinxhirit. Në rastin e klasterave në agrobiznes, një rol të rëndësishëm luajnë edhe qendrat e transferimit të teknologjisë në bujqësi si dhe qendrat e informacionit bujqësor dhe shërbimit këshillimor.

Pjesa më e madhe e fermerëve dhe njësive ekonomike të vogla të agrobiznesit

prodhojnë dhe shesin një produkt të padiferencuar dhe varen nga çmimi i vendosur nga blerësit. Në këtë lloj marrëdhënieje, prodhuesit janë tërësisht të ekspozuar ndaj luhatjeve të tregut dhe kanë pak mundësi për të shtuar vlerën, vetëm nëse arrijnë të zhvillojnë produktin bujqësor duke shtuar disa operacione elementare si pastrimi, tharja, depozitimi/ngrirja, etj., apo më të komplikuar si përpunimi, paketimi dhe shitja. Një shtim i tillë i vlerës mundësohet nga bashkërendimi i aktorëve në klasterat e agrobiznesit që mundëson përbashkëti në mënyrë më efektive me sfidat e përbashkëta dhe shfrytëzimin e mundësive të përbashkëta që shfaqen.

Qëllimi i clustering (grumbullimit) është për të zvogëluar sasinë e të dhënave nga kategorizimi ose grupimi i artikujve të ngjashëm të të dhënave së bashku. Grupimi i tillë është përhapur në mënyrë që njerëzit të përpunojnë informacionin, dhe një nga motivet për të përdorur algoritme Clustering është që të sigurojë mjete të automatizuar për të ndihmuar në ndërtimin kategori ose taxonomi (Jardine dhe Sibson, 1971, Sneath dhe Sokal, 1973¹²³). Metodat mund të përdoren gjithashtu për të minimizuar efektet e faktorit “njeri” në proces.

Metodat Clustering (Anderberg, 1973, Hartigan, 1975, Jain dhe Dubes, 1988, Jardine dhe Sibson 1971, Sneath dhe Sokal 1973, Tryon dhe Bailey, 1973¹²⁴) mund të ndahet në dy lloje themelore: clustering hierarkike dhe ndarëse ose veçuese. Brenda secilit prej llojeve ekziston një pasuri nëntipash dhe algoritme të ndryshme për gjetjen e grupimeve.

Clustering hierarkike vazhdon me sukses nga bashkimi i grupimeve të vogla në ato më të mëdha, ose duke ndarë grupimet më të mëdha. Metodat Clustering ndryshojnë në rregullin me të cilin ajo është e vendosur në të cilën dy grupe të vogla janë shkrirë apo

¹²³ Jardine dhe Sibson, 1971, Sneath dhe Sokal, 1973

¹²⁴ Anderberg, 1973, Hartigan, 1975, Jain dhe Dubes, 1988, Jardine dhe Sibson 1971, Sneath dhe Sokal 1973, Tryon dhe Bailey, 1973

cili grup i madh është i ndarë.

Rezultati përfundimtar i algoritmit është një dru i grupimeve i quajtur një dendrogram, e cila tregon se sa janë të lidhura. Duke i prerë dendrogramin në një nivel të dëshiruar një clustering i sendeve të dhënave në grupe të veçuara është marrë.

Përfitimet nga klasteri ?

Klasterat krijojnë mundësi për përfitime të shumta në disa nivele, të cilat jepen të grupuara më poshtë. Sa më mirë të ndërtohen e drejtohen klasterat, aq më shumë do përfitojnë në nivel individual fermerët që ndërtojnë klasterin dhe aktorët e tjerë, si dhe vetë klasteri në tërësi, sektori, rajoni apo dhe më gjerë.

Në nivel fermeri

- Ulje e kostove si rezultat i bashkimit të përpjekjeve për të punuar së bashku”.
- Rritja e aksesit ndaj faktorëve të prodhimit dhe shërbimeve
- Rritja e të ardhurave si rezultat i uljes së humbjeve, qëndrueshmërisë në tregje dhe çmimit më të lartë që justifikon një cilësi më të mirë
- Përmirësimi i aksesit në tregje dhe i informacionit për sektorin
- Fuqi më e lartë negociimi për çmimin në marrëdhëniet tregtare si rezultat i aksesit dhe informacionit më të lartë në treg dhe i mundësive më të shumta që ofrohen nga bashkimi i fermerëve për të investuar në ofrimin e proceseve të tjera që e rrisin vlerën e produktit si përpunimi, ruajtja, magazinimi, transporti etj.
- Fuqizimi i fermerëve të vegjël, të cilët përfitojnë në aftësi, njohuri dhe përvojë tregu. Duke qenë në grup, fermerët mund të fitojnë besim në treg dhe fuqizohen përmes arritjeve, të ardhurave më të larta dhe pavarësia.
- Zë më i fuqishëm në drejtim të hartimit të politikave të agrobiznesit, i cili fuqizohet sa më tepër që rritet klasteri.

- Përmirësim i marrëdhënieve mes fermerëve si rezultat i punës së bashku dhe ndihma reciproke
- Përfitim i ndërsjellë mes anëtarëve, qoftë ai në mënyrë të organizuar nga palët e tjera që ofrojnë burime, si qeveria, organizata jo-fitim prurëse, biznese, donatorë etj., apo dhe të paparashikuar përmes marrjes së përvojave më të mira.

Analiza Cluster është kryer në dy faza. Së pari, është përdorur një teknikë hierarkike për të identifikuar grupet e veçanta, numrin e grupeve dhe profilin e qendrave të klasterëve. Pastaj, vëzhgimet janë grumbulluara nga një metodë jo-hierarkike në qendrat e klasterëve nga rezultatet hierarkike përdorur si pikë fillestare. Kjo procedurë e kombinuar na lejon së pari për të përfituar nga avantazhet që lidhen me metodat e hierarkike dhe jo-hierarkike, ndërsa në të njëjtën kohë minimizimin e të metave (Punj dhe Stewart, 1983¹²⁵). Algoritmi i përdorur në teknikën hierarkike ishte metoda e Wards bazuar në distanca katrore Euklidiane. Për të vendosë se sa grupe ekzistojnë, kriteret e sugjeruara nga (Fiegenbaum dhe Thomas, 1993¹²⁶) janë aplikuar, të cilat fokusohen në analizën e njëkohshme të arsyeshme të marra brenda secilit grupim dhe përmirësimit që është bërë në këtë përshtatje me përfshirjen e një grupi shtesë. Këto kritere janë:

- (a) përqindja e variancës brenda grupit shpjegohet kur grupimi i marrë është me i lartë se një përqindje minimale të cilën e kemi vendosur në 50% dhe
- (b) se rritja e përqindjes në shpjegim të ndryshimit brenda grupit, është arritur me përfshirjen e një grupi shtesë, që nuk kalon 5 për qind. Kështu, numri i grupeve që ekzistojnë do të përcaktohet kur të dy kushtet janë të kënaqur në të njëjtën kohë.

Që të profilizohen dhe vërtetohen grupimet, secili është vlerësuar në drejtim të dy

¹²⁵ Punj dhe Stewart, 1983

¹²⁶ Fiegenbaum dhe Thomas, 1993

grupeve të performancës të variablave (indeksi i profitabilitetit dhe indeksi i Faktorit Total të Produktivitetit (FTP) të cilat nuk janë përfshirë si ndryshore të përdorura për të krijuar grupimet. Kjo është një pjesë e procesit të vërtetimit, pasi kjo ndihmon për të vlerësuar nëse grupimet e nxjerra janë të rëndësishme (Ketchen dhe Shook, 1996¹²⁷). Nëse tipologjia është domethënëse në ndarjen e grupeve të fermave me trajektoret e ndryshme, këto grupe duhet të karakterizohen nga rezultate shumë të ndryshme të performancës. Treguesit që janë shfrytëzuar për vlerësimin e rentabilitetit dhe të produktivitetit janë përshkruar më poshtë :

Rentabiliteti

Rentabiliteti i fermës vlerësohet në tre raportet e shpenzimeve në të ardhura për çdo fermë. Një raport më i vogël se ai tregon se një fermë është e dobishme sipas një mase të caktuar dhe anasjelltas. Raportet janë preferuar për ta lehtësuar analizën krahasuese të grupimeve kur fermat janë segmentuara në bazë të një sërë variablash. Disa studime të mëparshme kanë përdorur raporte të tilla për të vlerësuar përfitimin ose efikasitetin e kostos në të gjithë grupet divergjente të ndërmarrjeve (Seckler dhe Young, 1978; Jensen, 1984; Davidova et al, 2003¹²⁸).

Së pari, rentabiliteti i fermës është analizuar në lidhje me një raport privat kosto-përfitim (P_{CB}). Për këtë fermë, P_{CB} është llogaritur të jetë:

$$P_{CB_i} = \frac{(C_i^t + C_i^f)}{R_i} \quad [1]$$

ku C_i^t është kostoja e inputeve të tregtueshëm, C_i^f është kostoja e faktorëve të patregtueshëm të prodhimit (në bazë të çmimeve private apo vlerësimet pa pagesë paguar

¹²⁷ Ketchen dhe Shook, 1996

¹²⁸ Seckler dhe Young, 1978; Jensen, 1984; Davidova et al, 2003

për tokën dhe punën) dhe R_i është vlera e prodhimit me përjashtim të subvencioneve direkte neto. Nëse toka nuk merret me qira (pra posedohet toka) dhe inputet e punës në bujqësinë kosovare, vlera e tyre duhet të përfshihet në matjen e performancës. Për të bërë vlerësimin e tokës dhe të punës të papaguar, çmimet janë përdorur duke përdorur mesataret rajonale të punës. Familja është vlerësuar duke përdorur koston mesatare rajonale e punës për njësi fermë për mostër. Sa i përket çmimit të tokës është pak shqetësues, në qoftë se një fermë ka një përzierje të tokës me qira dhe pronësi, qiraja e paguar numërohet në tokën në pronësi, ashtu siç është menduar se me qira dhe tokën në pronësi që janë në afërsi dhe, kështu, janë të një përputhje të cilësisë. Nëse një fermë nuk ka tokë me qira, atëherë qiraja mesatare realisht e paguar nga ferma në mostër është aplikuar në tokën në pronësi. Për mos pagesën e tokës (d.m.th posedimin e tokës) dhe çmimet e punës nuk janë të sakta dhe po përdoren mesataret rajonale. Fuqia punëtore familjare është vlerësuar duke përdorur koston mesatare rajonale të punës për njësi fermë.

KAPITULLI I VI

REZULTATET E STUDIMIT

Për të kuptuar funksionimin e fermave bujqësore në rrafshin e Dukagjinit (Pejë, Prizren dhe Gjakovë) ne kemi ndërtuar një tipologji të fermave bujqësore. Kjo analizë është bërë në nivel ferme. Përgjatë anketave me fermerë ne jemi përpjekur të kuptojmë funksionimin për secilën prej tyre sipas mjeteve që disponojnë (toka, kapitali, fuqia punëtore), raportet sociale që ato vendosin midis tyre, praktikave të tyre (sistemet e kulturave bujqësore dhe blegtorisë), gjithashtu edhe rezultatet ekonomike që ato arrijnë. Duke ju rekomanduar literaturës, zgjedhjen e variablave e kemi bërë për ato variabla që shpjegojnë karakteristikat e fermave ndër të tjera si në aspektin e madhësisë së fermës, strukturës së tokës, kapitalit, punës, modelit të prodhimit, pajisjeve, shpenzimeve, vlerave të prodhimit, etj (Köbrich, Rehman et al. 2003) (Riveiro, Marey et al. 2008).

Autorë të tjerë kanë klasifikuar variablat në tre grupe kryesore në bazë të:

- 1) Burimeve biofizike (zonave bujqësore, modeleve të përdorimit të tokës, burimeve blegtoriale, pemëve frutore etj),
- 2) Aspekteve socio-ekonomike (të punës, kapitalit, etj) dhe
- 3) Pajisjeve (disponueshmërinë në mjetet e pajisjet etj) (Righi, Dogliotti et al. 2011). Castel, W. Madry et al. (2010) kanë përdorur shtatë grupe të variablave për të ndërtuar tipologjinë e sistemeve bujqësore të qumështit në një provincë të Polonisë d.m.th si: i) cilësinë e tokës, ii) kushtet socio-ekonomike, iii) Infrastrukturën iv) strukturën e prodhimit bujqësor, v) inputet në prodhimin bujqësor, vi) të ardhurat nga prodhimi dhe profitabilitetit, dhe vii) indeksin e përfitimeve bujqësore.

Gjatë hulumtimit janë studiuar dy tipologji, një për të gjithë kampionin (tre rajonet) dhe një për secilin rajon. Dallimet mes dy tipologjive janë konsideruar të jenë një tregues përafrues i karakteristikave të ndryshme të sistemeve bujqësore në çdo rajon.

Studimi rezulton se i njëjti sistem prodhimi është i ngjashëm për shumë ferma prandaj jemi përpjekur ti kategorizojmë ato sipas gamës së burimeve që kanë, përdorimit të tyre dhe organizimit social të krahasueshëm. Raporti midis fermës dhe vendndodhjes së saj në hapësirë, është një ndër elementet më të rëndësishëm i cili përcakton të ardhmen e saj dhe strategjitë që ajo do të ndjekë (Guri. F, Dashi E). Ne i kemi grupuar këto kategori në gjashtë tipe të mëdha në funksion të orientimit të prodhimit :

- ✓ Ferma që mbjellin kultura lavértare me drejtim kryesor autokonsumin;
- ✓ Ferma që mbjellin kultura të përhershme;
- ✓ Ferma të specializuara në blegtori (kryesisht në bagëti të imta);
- ✓ Ferma të përziera (polikulturë kryesisht perime);
- ✓ Ferma të përziera blegtorale;
- ✓ Ferma të diversifikuara (me shumë aktivitete).

Fermat në Kosovë kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme dhe kanë pësuar ndryshime me kalimin e kohës, duke filluar nga koha e socializmit, periudha tranzitore dhe deri në situatën e tanishme të fermave bujqësore. E kaluara e fermave flet për kohën e sistemit socialist, ekzistimin e kooperativave bujqësore, kur fermat kanë lulëzuar me një funksionim perfekt të zinxhirit të vlerës si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe një ndërlidhje shumë të fortë mes këtyre sektorëve, faza tjetër është shkatërrimi i fermave gjatë okupimit të shtetit nga okupatori serb si dhe shkatërrimin ekonomisë së Kosovës në tërësi, si dhe periudhën mbas viteve '90 me kalimin e fermave nga sistemi socialist në atë të ekonomisë së tregut të lirë, privatizimin e pronave shoqërore, ndërrimin e destinimit të tokave, parcelizimin e pronave private, migrimin e popullatës etj.


Indikatori 1 - Përshkrimi i familjes fermere

Struktura familjare e fermerëve në rajonin e Pejës

Fillimisht ne kemi analizuar përbërjen familjare të fermerëve të marrë në studim në të gjitha tipet e fermave (klasterave). Familja fermere ka mesatarisht 6.1 anëtarë nga të cilët 5.65 janë në moshë për punë dhe vetëm 4.1 prej tyre punojnë në fermë në zonën e Pejës. Do me thënë që 69 % të anëtarëve të familjeve fermere të marra në studim punojnë në fermë.

Nga analiza në grafikun vijues kemi ardh në përfundim se në cilin tip të fermave (klasterëve) punojnë më shumë anëtarë të familjeve, ku rezulton se në tipin *bagëti që kullosin* dhe në *fermat e përziera bimë dhe kafshë* janë mesatarisht 75% anëtarë të familjeve që punojnë, përcjell me tipin e fermave (klasterëve) *të përziera blegtorale* me rreth 70%. Me pas *fermat me kultura lavërtare* në masën rreth 69% duke vijuar me ato ferma të *kulturave të përziera* me rreth 67% dhe me pas me *kultura të përhershme* në masën rreth 55%.

Grafiku 39: Struktura familjare fermere në rajonin e Pejës




Burimi : Anketat 2015

Në rajonin e Prizrenit mesatarisht rreth 63% e anëtarëve të familjes në moshë punë punojnë në fermë ndërsa anëtarët në moshë për punë janë në masën 85%. Nga analiza në

(grafikun e mëposhtëm) shohim se në cilin tip të fermave (klasterëve) punojnë më shumë anëtarë të familjeve, pra analiza rezulton se tipi i *kulturave lavërtare* dhe asaj me ferma të përziera me bimë dhe kafshë punojnë në masën rreth 71%, përcjell me tipin e fermave (klasterëve) të përziera bimë dhe kafshë 4.1 anëtarë, 3.9 bagëti që kullosin, 3.8 kultura të përziera dhe më së paku anëtarë që punojnë janë kultura të përhershme me 3.2 dhe kultura të përziera blegtorale me 3.2.


Grafiku 40: Struktura familjare fermere në rajonin e Prizrenit



Burimi : Anketat 2015

Në rajonin e Gjakovës mesatarisht në familjen fermere jetojnë 5.9 anëtarë nga të cilët 5.6 janë në moshë punë dhe 4.4 anëtarë punojnë në fermë, do të thotë nga totali i anëtarëve me moshë punë 75 % punojnë në fermë. Nga analiza në grafikonin në vijim shohim se në cilin tip të fermave (klasterëve) punojnë më shumë anëtarë të familjeve, pra analiza rezulton se tipi i fermave – *bagëti që kullosin* në masën 88%, pasuar nga ferma të përziera bimë dhe kafshë në masën 84%, ferma me kultura lavërtare 80%, kultura të përziera 74% dhe të përziera blegtorale me kultura të përhershme me nga 64 % secila.

Grafiku 41: Struktura familjare fermere në rajonin e Gjakovës




Burimi : Anketat 2015

Përshkrimi i familjes fermere është studiuar për secilin rajon si me lartë dhe për të gjithë kampionin - tre rajonet. Dallimet mes dy hulumtimeve janë konsideruar të jenë një tregues përafërues i karakteristikave të ndryshme të sistemeve bujqësore në çdo rajon dhe shifrat tregojnë se familjet fermere në zonat e studiuara janë kryesisht të fokusuar në punët e fermës siç shihet nga analiza e lartshënuar në rajonin e Pejës 69 % të anëtarëve të familjes punojnë në fermë, 63 % në rajonin e Prizrenit dhe 75% në rajonin e Gjakovës.

Indikatori 2 - Niveli i edukimit të fermerëve

Gjatë këtij studimi kryesisht janë intervistuar bartësit e fermave apo menaxherët, ku niveli i shkollimit të bartësve është mjaft i ulët, në veçanti në lidhje me bujqësinë 36.0% e të intervistuarve e kanë të përfunduar vetëm shkollën fillore, më shumë se gjysma e bartësve 57 % kanë përfunduar shkollën e mesme, ndërsa 11% kanë shkollim në shkencat e bujqësisë (shkollë e mesme bujqësore), ndërsa vetëm 6% e bartësve kanë shkollim të lartë, Fakultetin e Bujqësisë/Veterinarisë, Master, PHD në shkencat bujqësore).


Grafiku 42: Niveli i arsimimit të fermerëve në rajonin e Pejës



Burimi : Anketat 2015

Po ashtu edhe në rajonin e Prizrenit dominon shkollimi i mesëm dhe fillor i bartësve të fermave bujqësore apo menaxherëve të tyre me ç'rast nga studimi siç shihet në grafikun vijues me shkollim të mesëm janë 60 %, shkollim fillor 37%, 12.6 % me shkollim bujqësor dhe me një përqindje shumë të ulët të shkollimit të lartë 3.8%.

Grafiku 43: Niveli i arsimimit të fermerëve në rajonin e Prizrenit




Burimi : Anketat 2015

Edhe në rajonin e Gjakovës nga studimi rezulton se kemi të bëjmë me bartës të

fermave/menaxher me nivel të ulët të arsimimit ku kryesisht dominon shkollimi i mesëm dhe fillor me 58% i mesëm, 38.6% fillor, 14.6% arsimim bujqësor dhe 5.6% arsimit të lartë.

Grafiku 44: Niveli i arsimimit të fermerëve në rajonin e Gjakovës



Burimi : Anketat 2015



Në nivelin e tre rajoneve rezultojnë se arsimimi i fermerëve të intervistuar është kryesisht i mesëm dhe fillestar ndërsa arsimi i lartë është vetëm 6% në Pejë, 3.8 % në Prizren dhe 5.6 % në Gjakovë. Ndërsa arsimi i mesëm i profilizuar në atë bujqësor është vetëm 11% në Pejë, 16% në Prizren dhe 15% në Gjakovë.

Niveli i shkollimit të bartësve të fermave /menaxherëve është i përafërt në të gjitha tipet e fermave (klasterave) në gjitha rajonet, i cili kryesisht është i ulët dhe kjo reflekton automatikisht në suksesin e fermave bujqësore sidomos zhvillimin në hap me kohë të teknikave dhe teknologjisë më të avancuar, përdorimin e varieteteve më të reja, përdorimin e masave agro dhe pomoteknike më të avancuara që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe kualitetin, e po ashtu edhe në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve.


Indikatori 3 - Fermat sipas forcës së punës

Nga studimi i fermave për nga krahu i punës që buron nga familja fermere, krahu i punës është i përqendruar kryesisht në bërthamën e fermës fermere. Rajonet e Pejës dhe Prizrenit i kanë fermat me nga 3 deri në 4 krah pune nga familja fermere me masën rreth 44% ndërsa në Gjakovë me rreth 43%. Pra shumica e anëtarëve të familjes arrijnë të punësohen në fermat e tyre. Me mbi 4 krah punë janë 23% të fermave të rajonit të Pejës dhe Prizrenit dhe me rreth 21% rajonit të Gjakovës. Nga 2 deri në 3 punëtor në Pejë kemi rreth 22% të fermave, Gjakovë rreth 26%, dhe në Prizren rreth 20% kurse ferma të cilat kanë më pak se 2 krah punë janë rreth 9-11% të fermave në të tre rajonet.

Grafiku 45:Krahu i punës në fermë-Pejë **Grafiku46:Krahu i punës në fermë -Gjakovë**




Grafiku 47: Krahu i punës në fermë -Prizren




Burimi : Anketat 2015

Indikatori 4 - Llojet e punës në fermë

Nga analiza e përgjigjeve rezulton se në rajonin e Pejës tek të gjashtë klasterat puna kryesore në fermë bëhet nga anëtarët e familjes fermere, në masën rreth 37% përballohet me kohë të plotë kryesisht nga bartësit e fermës dhe në masën 46% nga familjarët e tjerë të cilët angazhohen vetëm në sezone të caktuara dhe jo gjatë gjithë kohës.


Grafiku 48: Llojet e punës në fermë në rajonin e Pejës**Grafiku 49: Llojet e punës në fermë në rajonin e Prizrenit**

Burimi : Anketat 2015


Grafiku 50: Llojet e punës në fermë në rajonin e Gjakovës

Burimi : Anketat 2015


Grafiku 51: Angazhimi i anëtarëve të familjes dhe lloji i punës në fermë në rajonin e Pejës



Grafiku 52: Angazhimi i anëtarëve të familjes dhe lloji i punës në fermë në rajonin e Prizrenit



Grafiku 53: Angazhimi i antarëve të familjes dhe lloji i punës në fermë në rajonin e Gjakovës



Nga analiza e përgjigjeve rezulton se në rajonin e Prizrenit tek të gjashtë klasterat puna në fermë bëhet nga bartësit të cilët angazhohen me rreth 37 %, dhe nga anëtarët e familjes fermere me rreth 50%. Për rajonin e Gjakovës puna sipas ndarjes së klasterave arrin në 36% për bartësit dhe 43% për familjaret e tjerë të cilët janë në moshë për punë por punojnë vetëm në sezona të caktuara.

Indikatori 5 - Numri i fermave që punësojnë punëtor

Nga analiza e përgjigjeve rezulton se në rajonet e studimit kemi ferma të kombinuara sa i përket krahut të punës ku punët kryhen nga anëtarët e familjes, por edhe punësojnë punëtor sezonal. Në rajonin e Pejës fermat të cilat më së shumti punësojnë punëtor jashtë fermave janë tipi i fermave (klasterëve) *kultura të përhershme* dhe *kultura të përziera* me ç'rast punësojnë 2-3% të ditëve që punësohen këta punëtor në totalin e ditëve që punohet në fermë.

Në rajonin e Prizrenit kemi një angazhim më të madh të fuqisë punëtore në tre nga tipet e fermave (klasterëve), si në klasterin e *kulturave të përhershme*, *bagëti që kullosin* dhe *të përziera blegtorale*, më shumë se 3% të ditëve që punësohen këta punëtor në totalin e ditëve që punohet në fermë. Po ashtu në rajonin e Gjakovës kemi një angazhim më të madh të ditëve të punës tek *kulturat e përhershme*.

Indikatori 6 - Llojet e të ardhurave shtesë në fermë

Ndihmat qeveritare

Duke pas parasysh prioritetet e qeverisë të Republikës së Kosovës në mbështetje të këtij sektori dhe zhvillimit rural, edhe rezultatet e studimit rezultojnë se sidomos fermat komerciale dhe klasteri i *kulturave shumëvjeçare*, *fermave të përziera* dhe *blegtorale* kanë përfituar nga kjo ndihmë. Në Kosovë, MBPZHR është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Prandaj MBPZHR në kuadër të Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZHR) 2007-13 dhe 2014-2020 i cili pritet të miratohet nga qeveria është paraparë përkrahja e këtyre klasterave.

Instrumentet kryesorë të ndërhyrjes së politikës së qeverisë së Kosovës për të trajtuar disa nga problemet e tezës janë dhënë në Planin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZHR), synim i të cilit është sigurimi i një kornize që do ta ndihmojë Kosovën për:

1. Të ristrukturuar sektorin e bujqësisë në përputhje me atë të BE, dhe
2. Të përmirësojë standardet e jetesës të popullsisë rurale në Kosovë.

Është paraparë që realizimi i këtij synimi të PBZHR të bëhet duke u bazuar në këto dy shtylla të PPB;

- Shtylla e parë/masat që kanë për qëllim zhvillimin e bujqësisë, dhe
- Shtylla e dytë/masat që kanë për qëllim zhvillimin rural.

Objektivat kryesorë të PBZHR të mësipërme janë:

- a) Zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë;
- b) Përmirësimi i jetesës së familjeve që jetojnë në viset rurale;
- c) Përmirësimi i efikasitetit ekonomike të bujqësisë dhe teknologjisë së ushqimit;
- d) Përmirësimi i tregjeve bujqësore etj.

Në Planin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZHR), mbështetja bëhet përmes përkrahjes së drejtpërdrejtë të prodhimit e cila bëhet kryesisht me subvencione me qëllim rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit dhe po ashtu përmes granteve zhvillimore ku mbështeten sektorët me rëndësi strategjike për zhvillimin e bujqësisë.

Në kuadër të MBPZHR, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është përgjegjëse për zbatimin e Programit për Zhvillim Rural.

Për zbatimin e programit ka përcaktuar këto masa dhe nënmasa:

1. **Masa 101:** Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore, duke përfshirë: sektorin e pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull dhe vishnje), sektori i pemëve të imta (dredhëz, mjedër dhe manaferrë), sektori i perimeve (serra) dhe perime në ambient të hapur (duke përfshirë pataten), sektori i mishit (trashja e viçave dhe brojlerëve), sektori i qumështit (lopë qumështore, dele dhe dhi), sektori i drithërave, sektori i rrushit, si dhe sektori i pulave vojse.

2. **Masa 103:** Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe atyre të peshkatarisë, duke përfshirë: sektorin e përpunimit të qumështit, sektorin e përpunimit të mishit, sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve, si dhe sektorin e prodhimit të verës.

3. **Masa 302:** Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale duke përfshirë nënmasat:

- **nënmasa 302.1** - Bletaria prodhimi /përpunimi dhe marketingu i mjaltit;
- **nënmasa 302.2** - Përpunimi i barishteve bimore mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara;
- **nënmasa 302.3** - Përpunimi në fermë dhe marketingu i prodhimeve bujqësore në shkallë të ulët (perimet, frutat, barishtet, erëzat, bimët mjekuese, kërpudhat, si dhe qumështi i deleve dhe dhive).


Nga intervistat me fermer shohim po thuajse se çdonjëri prej fermerëve ka përfituar nga ndihma qeveritare sidomos subvencione dhe vazhdojnë edhe me tutje të rriten në cilësinë e përkrahjes me grante dhe subvencione (pagesa direkte). Vetëm në vitin 2016 përkrahja publike nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është 46 milion euro, e cila përkrahje është në formë të granteve investive dhe pagesave direkte dhe në këtë përkrahje janë përfshirë po ashtu të gjithë klasterat që janë në studim.

Ndihma sociale

Nga rezultatet e analizës së studimit nuk kemi has ndonjë fermer (luster) të jetë përgjigjur se ka përfituar nga ndihma sociale e cila plotësisht është e logjikshme për shkak se ne, në studim kemi përfshirë vetëm fermat komerciale. Zakonisht skemat sociale i shënjestrojnë fermerët të cilët janë me ndihmë sociale pra fermerët e vegjël. Mbështetjet financiare të tjera për fermat janë të papërfillshme pasi nuk kalojnë 1% të totalit të të ardhurave të fermës si nga skema të ndryshme apo donatorët.

Indikatori 7 - Struktura e tokës

Struktura e tokës në fermë ka të njëjtat madhësi në të tre rajonet e studiara me diferenca të vogla. Shumica e fermave kanë sipërfaqe me segmentim 0.5 deri në 2 ha dhe pasohet nga fermat me sipërfaqe nga 2 deri në 5 ha.

Grafiku 54: Struktura e fermës në rajonin e Pejës

Burimi: Analiza e autorit, anketat 2015

Sa i përket strukturës së fermës themi se madhësia mesatare e parcelave tek gjashtë klasterat është 4.7 ha që do të thotë se kemi të bëjmë me ferma të vogla, klasteri nr.1 në grafikon. Klasteri i *kulturave lavërtare* dhe klasteri nr.3 në grafikon *numri i bagëtive që kullosin* kanë sipërfaqe mesatare më të madhe (6.4), duke vazhuar me klasterin nr.5 në grafikon klasteri *të përziera blegtorale* me madhësi mesatare (6.2), përcjell me klasterin nr.2 në grafikon me *kultura të përhershme* me madhësi mesatare (3.3) dhe klasterin me madhësi mesatare më të vogël nr.4 në grafikon me *kultura të përziera* (2.6).

Parcelizimi i tokës në rajonin e Pejës

Kurse sa i përket parcelizimit po ashtu numri mesatar i parcelave /fermave tek gjashtë klasterat është 4.2, që do të thotë se analiza jonë i përgjigjet plotësisht teorisë së bujqësisë në Kosovë vuan nga fragmentimi mjaft i shprehur i tokave. Klasterat të cilët janë

më të fragmentuar në rajonin e Pejës janë: klasteri me ferma të përziera me bimë dhe kafshë, kultura të përhershme, kultura lavërtare e kështu me radhë.

Tabela 46: Parcelizimi i tokës në rajonin e Pejës


	Kultura lavërtare	Kultura të përhershme	Bagëti që kullosin	Kultura të përziera	Të përziera blegtorale	Ferma të përziera bimë dhe kafshë
Numri mesatar i parcelave	4.3	4.5	4.2	3.6	3.9	4.6

Burimi: Anketat, 2015

Struktura e fermës në rajonin e Prizrenit

Bazuar në rezultatet e hulumtimit po ashtu në rajonin e Prizrenit rezultojnë të kemi strukturë të përafërt të fermave sikurse në Rajonin e Pejës ku madhësia mesatare e parcelave tek gjashtë klasterat është 4.5 ha që do të thotë se kemi të bëjmë me ferma të vogla. Klasteri i ferma të përziera bimë dhe kafshë (7.1) dhe klasteri nr.5 në tab. të përziera blegtoriale kanë sipërfaqe mesatare më të madhe (5.5), duke vazhuar me klasterin nr.3 në tab. bagëtitë që kullosin më madhësi mesatare (4.8), përcjell me klasterin nr.2. në tabelë me kultura të përhershme me madhësi mesatare (4.2) dhe klasterin me madhësi mesatare më të vogël në nr.1 në tabelë me kultura lavërtare (4.1).

Grafiku 55: Struktura e fermës në rajonin e Prizrenit



Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Tabela 47: Parcelizimi i tokës në rajonin e Prizrenit

	Kultura lavërtare	Kultura të përhershme	Bagëti që kullosin	Kultura të përziera	Të përziera blegtorale	Ferma të përziera bimë dhe kafshë
Numri i mesatar parcelave	4.1	4.2	4.7	5.1	4.6	4.6


Burimi. Anketat, 2015

Po ashtu edhe në rajonin e Prizrenit parcelizimi i tokave është mjaft i shprehur sikurse edhe në rajonet tjera në Kosovë. Numri mesatar i parcelave/fermave tek gjashtë klasterat është 4.55. Klasterat të cilat janë me të fragmentuar në rajonin e Prizrenit janë: klasteri me *ferma të përziera me bimë dhe kafshë*, *kultura të përziera*, *bagëti që kullosin*, *kultura të përhershme* dhe *kultura lavërtare*.

Struktura e fermës në rajonin e Gjakovës

Në rajonin e Gjakovës rezulton të kemi strukturë ku fermat janë më të vogla në krahasim me Rajonin e Pejës dhe Prizrenit ku madhësia mesatare e parcelave tek gjashtë klasterat është 4.03 ha që do të thotë se kemi të bëjmë me ferma të vogla, klasteri nr.6 në tab. Klasteri i **fermave të përziera bimë dhe kafshë** (5.2) dhe klasteri nr.3 në tab. *bagëtitë që kullosin* kanë sipërfaqe mesatare më të madhe (4.8), duke vazhduar me klasterin nr.4 në tab. *kultura të përziera* me madhësi mesatare (4.2), përcjell me klasterin nr.1 në tab me *kultura lavërtare* me madhësi mesatare (3.8) dhe klasterin me nr.5. *të përziera blegtorale* me madhësi (3.8) klasterat me madhësi mesatare më të vogël nr.2 në tabelë me *kultura të përhershme* (3.2).

Grafiku 56: Struktura e fermës në rajonin e Gjakovës



Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Parcelizimi i tokës në rajonin e Gjakovës

Parcelizimi i tokave në rajonin e Gjakovës është më i shprehur se në rajonet tjera të përfshira në hulumtim. Numri mesatar i parcelave/fermave tek gjashtë klasterat është 4.16 . Klasterat të cilët janë më të fragmentuar në rajonin e Gjakovës janë: klasteri me *ferma të përziera me bimë dhe kafshë, bagëti që kullosin, të përziera blegtorale, kultura lavërtare dhe kultura të përhershme* (shih.tabela nr.48).

Tabela 48: Parcelizimi i tokës në rajonin e Gjakovës

	Kultura lavërtare	Kultura të përhershme	Bagëti që kullosin	Kultura të përziera	Të përziera blegtorale	Ferma të përziera bimë dhe kafshë
Numri mesatar I parcelave	3.8	3.2	4.8	4.2	3.8	5.2


Burimi: Anketat, 2015

Indikatori 8 - Madhësia e fermave

Në kuadër të realizimit të tipologjisë së fermave një prej elementeve mjaft të rëndësishme ka qenë edhe studimi i madhësisë së fermave, në bazë të informacionit të grumbulluar në teren rezulton së fermat në zonat e studimit janë të vogla, madhësia e tyre në gjitha rajoneve sillet prej 2.5-2 ha në përqindje prej 39-41%, duke vazhduar me një përqindje më të vogël 26% në rajonin e Gjakovës të fermave me madhësi 2-5 ha, rajonin e Pejës me 25% të fermave me madhësi 2-5 ha si dhe rajonin e Prizrenit me madhësi më të vogël se 0.5 ha 25% të fermave në Prizren, 20% të fermave në Pejë dhe 18% të fermave në Gjakovë.

Fermat me madhësi më të madhe se 5 ha ka më së shumti në rajonin e Pejës mbi 16%, në rajonin e Gjakovës 15% dhe në Prizren mbi 11%. Pra madhësia e fermave është munduar të kuptohet si një element kyç se si e influencon efektivitetin ekonomik të fermave në këto rajone.

Grafiku 57: Madhësia e fermave në zonat e marra në studim




Burimi : Anketat 2015

Nga analiza e të dhënave të madhësisë së fermave në nivel rajoni, pra madhësia e fermave tek klasterat e ndryshëm si dhe nga krahasimi i tyre rezulton se fermat (klasteret) e kulturave të përhershme dhe klasteri ferma të përziera bimë dhe kafshë kanë përqindje më të madhe të fermave me madhësi nga 0.5 -2 ha, pra rreth 40%, por pa përjashtuar edhe klasterat e tjerë kjo madhësi e fermave ku është prezente, duke vazhduar me ferma që kanë madhësinë më të madhe 2-5 ha nga 23-27% e të gjitha fermave kanë

këtë madhësi. Nga 13-18% e të gjitha fermave kanë madhësinë më të lartë së 5 ha. Pra nga kjo rezulton së fermat bujqësore në të gjithë klasterat janë në nivele të fermave familjare me një madhësi shumë të vogël dhe mjaft të fragmentuara.

Grafiku 58: Madhësia e fermave në rajonin e Pejës



Burimi : Anketat 2015

Në përgjithësi madhësia e fermave në të tre rajonet është e ngjashme, në rajonin e Pejës dhe Gjakovës kurse janë më të vogla në rajonin e Prizrenit.

Indikatori 9 - Ujitja e fermës

Sipërfaqe të ujitura

Bazuar në faktin që cilësia e tokës bujqësore dhe mundësia e ujitjes ndikon drejtpërdrejt edhe në rendiment, cilësi të produkteve, dhe përcaktimin e të ardhmes së fermës, vetëm 38% e fermave ujin të mbjellat në mënyra të ndryshme në rajonin e Pejës në vetëm 10 % të sipërfaqes së tokës së tyre. 28% e fermave ujin të mbjellat në rajonin e Prizrenit në vetëm 2% të tokave të tyre dhe 45% e fermave ujin të mbjellat në rajonin e Gjakovës në vetëm 13% të tokave të tyre. Pjesa më e madhe e tokave ujitet nga ujërat që

vinë nga lumenjtë, pronjët dhe një përqindje e vogël nga hidrosistemet.

Indikatori 10 - Pajisje dhe makineri pune

Fermtat në rajonin e Pejës kanë rreth 118 makineri bujqësore për 135 ferma të cilat janë në një cilësi në 69% të përdorura deri në 5 vjet dhe pjesa tjetër më shumë se 5 vjet. Kjo gjendje tregon për investime në mjete bujqësore cilësore.

Indikatori 11 - Vlera e prodhimit

Të ardhurat nga shitja/totale e prodhimit në rajonin e Pejës janë më të larta në klasterin e *kulturave të përhershme* me 86 % në krahasim me rajonet tjera, pra nga kjo rezulton se niveli i të ardhurave nga shitja është në një nivel të lartë nga 75% deri në 86% të prodhimit. Pra kemi produkte që tregu i tërheq dhe fermeri arrin që ti shesë. Pjesa që nuk shitet rezulton e dëmtuar, e destinuar për konsum familjar dhe firo të ndryshme sipas produktit dhe kohës në të cilën shitet. Produktet që kanë nivelin më të lartë të shitjeve në rajonin e Pejës është ajo e *kulturave të përhershme* me 86%, e ndjekur nga produktet e *bagëti që kullosin* me 83% e kështu më radhë deri tek 75% e produktit nga *fermat të përziera bimë dhe kafshë*. Ky rezultat na jep argumentin se fermtat të cilat janë të specializuara në pak kultura rezultojnë me produkt të shitur në shkallë më të lartë.

Tabela 49: Vlera e prodhimit në tre rajonet

Klasterat	Kultura lavërtare	Kultura të përhershme	Bagëti që kullosin	Kultura të përziera	Të përziera blegtorale	Ferma të përziera bimë dhe kafshë
Pejë	82%	86%	83%	79%	76%	75%
Prizren	80%	87%	86%	81%	78%	74%
Gjakovë	79%	84%	81%	77%	79%	76%

Burimi : Anketat 2015,

Indikatori 12 – Shpenzimet në fermë

Shpenzimet për inpute: Shpenzimet e fermave bujqësore, shpenzimet kryesore në këto ferma janë llogaritur që nga punimet paraprake, plotësimi i kushteve të përshtatshme për mbjellje, sigurimin e farërave, trajtimet me plehra organike dhe kimike, pesticidet dhe shpenzimet e vjeljeve, korrijeve, ruajtjes e deri në momentin e tregtimit të produktit final nga fermeri.

Shpenzimet e fermave blegtorale, shpenzimet kryesore në këto tipe fermash janë renditur në blerjen e bazës ushqimore me produktet e nevojshme (dengjë kashtë, kashtë, drithëra, ushqime të koncentruara dhe shpenzime sipas llojit). Gjatë studimit janë analizuar shpenzimet e farës, plehrave dhe shpenzimet për punime të tokës që është menduar se përbëjnë përqindjen më të madhe të shpenzimeve.

Nënindikatori - Shpenzimet për farë

Klasteri i kulturave lavërtare : Shpenzimet për farë të ky klaster sillen rreth 26.7% të shpenzimeve totale në të tre rajonet duke përfshirë rajonin e Pejës me rreth 26%, Prizrenit 28% dhe Gjakovën 29%.

Klasteri i kulturave të përhershme : nuk kemi shpenzime për farë në këtë klaster kemi shpenzime për fidanë që sillen rreth p.sh te kultivimi i mollës si njëra prej kulturave që nxë pjesën më të madhe të sipërfaqes së kulturave shumëvjeçare sillet mesatarisht rreth 2,500 euro/ha i cili është një shpenzim që nxë rreth 35% nga shpenzimet totale të ngritjes së një sipërfaqe prej 1 hektar pemishte.


Klasteri i bagëtive që kullosin : shpenzimi i farërave te bagëtisë që kullosin nxënë një përqindje më të vogël të shpenzimeve rreth 15 %, duke përfshirë rajonin e Pejës me 11%, Prizrenit 12 dhe Gjakovës 21%.

Klasteri i kulturave të përziara : shpenzimet e farës të ky klaster nxënë 33% nga shpenzimet totale d.m.th. 30% në rajonin e Pejës, 28 % Prizrenit dhe 40% në Gjakovë.

Klasteri të përziera blegtoriale : shpenzimi i farërave nxë 16% nga shpenzimet totale duke përfshirë rajonin e Pejës 14%, Prizrenit 16% dhe Gjakovës 19 %.


Klasteri i fermave të përziera bimë dhe kafshë : shpenzimet e farës të ky klaster nxënë 26% nga shpenzimet totale, në rajonin e Pejës 26%, Prizren 29% dhe Gjakovës 23%. Nga analiza empirike e kësaj variable rezulton që shpenzimi i inputit farë është mjaft i rëndësishëm dhe ka ndikim direkt në shpenzimet totale dhe në vlerën e produktit.

Nënindikatori - shpenzime për plehra kimike: Në nivelin e tre rajoneve shihet se kulturat lavërtarë nxënë 18%, të klasteri i *kulturave të përherëshme* 23%, tek klasteri i *bagëtivë që kullosin* 11%, klasteri i *kulturave të përziera* 18%, klasteri i *fermave të përziera bimë dhe kafshë* 18% dhe klasteri të *përziera blegtoriale* 12%. Nga analiza empirike shihet 37.6% e shpenzimeve totale nxënë shpenzimet për trajtimin me plehra kimike.

Grafiku 59: Shpenzimet për plehra kimike

Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Nën-indikatori - shpenzime për punime të tokës: Analiza në vijim rezulton që përqindje më të madhe të shpenzimeve për punime të tokës e ka klasteri me *kultura të përhershme* rreth 44% në nivel të tre rajoneve duke vazhduar me klasterin e *fermave të përziera bimë dhe kafshë* 30%, *kultura lavërtare* 29%, *kultura të përziera* 22%, *bagëti që kullosin* 15% dhe klasteri që kërkon më së pakti punime tokë është klasteri të *përziera blegtorale* me rreth 14%.

Grafiku 60: Shpenzimet për punimin e tokës

Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Indikatori 13 - Lloji i të ardhurave në fermë


Nënindikatori: Të ardhurat neto në fermë

Në llogaritjen e të ardhurave janë llogaritur të ardhurat nga shitja e produkteve përfundimtare duke vlerësuar konsumin familjar të produkteve, në të ardhurat neto në fermë zbriten të gjitha shpenzimet e inputeve bujqësore të përdorura gjatë kultivimit si fara, fidanët, plehrat organike, kimike, punimet themelore të tokës, punimet shtesë, vjelja, transporti, shpenzimet e ruajtjes, shpenzimet për preparate mbrojtëse (pesticide, herbicide, fungicide etj), fuqinë punëtore e cila edhe pse një përqindje e vogël marrin punëtor me qira, është llogaritur edhe fuqia punëtore e anëtarëve të familjes të cilët janë të angazhuar në fermë etj. Të ardhurat nga shitja dallojnë në mes të klasterave e po ashtu edhe në mes të rajoneve të shënjestruara.

Të ardhurat nga shitja në rajonet e studiuara

Shpenzimet janë llogaritur si për prodhimin kryesor (p.sh. grurin) po ashtu edhe për prodhimin sekondar (p.sh. kashtën), duke i zbritur poashtu prodhimet të cilat përdoren për familje.

Grafiku 61: Të ardhurat neto në rajonin e Pejës



Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015


Nga analiza rezulton se klasteri i *kulturave të përhershme* është klasteri me të ardhurën neto më të madhe për fermë (11.651 euro). Duke e llogaritur këtë të ardhur për të nxjerrë të ardhurën neto për njësi pune vjetore NjPV të cilat janë puna për njësi vjetore e cila është dashur të punohet për të arritur këtë të ardhur atëherë rezulton se më poshtë :

Tabela 50: Të ardhurat neto/NjPV

	Kultura lavërtare	Kultura të përhershme	Bagëti që kullosin	Kultura të përziera	Të përziera blegtorale	Ferma të përziera bimë dhe kafshë
Te ardhurat neto/NjPV	2.412	4.854	3.198	2.291	2.862	2.548

Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Të ardhurat nga klasteri i *kulturave lavërtare* ku janë analizuar kulturat siç janë: drithërat, misri, elbi, gruri, tërshëra, thekra, bimët foraxhere, bimët bishtajore, fasula , kulturat industriale siç janë duhani, luledielli, bimët aromatike dhe mjekësore të kultivuara etj. nga analiza e bërë rezulton se të ardhurat nga shitja në rajonin e Pejës janë të larta rreth (7,237 euro) por të ardhurat neto për NjPV e rendisin jo si ferma më e mirë. Ferma me të ardhurën neto për NjPV më të lartë në rajonin e Pejës rezulton *kultura të përhershme* (4,854euro) e ndjekur nga ajo me *bagëti që kullosin* (3,198), *të përziera blegtorale* (2,862euro), *fermat e përziera bimë dhe kafshë* (2,548 euro), *kultura lavërtare* (2,412 euro) dhe më ulëta *kultura të përziera* (2,291 euro), me (6.010 euro) *ferma të përziera blegtorale* dhe fermat më të ardhurat më të ulëta në këtë tipologji të fermave janë fermat më (4.840 euro) apo 11% nga totali i të ardhurave, pra *ferma të përziera bimë dhe kafshë*.

Grafiku 62: Të ardhurat netto në rajonin e Prizrenit

Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015


Tabela 51: Të ardhurat neto/NjPV

cluster	Kultura lavërtare	Kultura të përhershme	Bagëti që kullosin	Kultura të përziera	Të përziera blegtorale	Ferma të përziera bimë dhe kafshë
Të ardhurat neto/NjPV	2.735	2.648	2.911	2.390	3.900	2.374

Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Nga analiza rezulton së klasteri i *kulturave lavërtare* me të ardhurën neto për fermë më të madhe (8,751 euro). Por nga analiza për të ardhurën neto për NjPV rezulton që ferma të përziera blegtorale është ferma më të ardhurën neto më të lartë (3,900 euro). Duke vazhduar më fermën e *kultura lavërtare* (2,735 euro) , *bagëti që kullosin* (2,911 euro), *kultura të përhershme* (2,648 euro), *kultura të përziera* (2,390) dhe duke e mbyllur me të përziera bimë dhe kafshë (2,374 euro)

Grafiku 63: Të ardhurat netto në rajonin e Gjakovës



Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Tabela 52: Të ardhurat neto/NjPV

cluster	Kultura lavërtare	Kultura të përhershme	Bagëti që kullosin	Kultura të përziera	Të përziera blegtorale	Ferma të përziera bimë dhe kafshë
Te ardhurat neto/NjPV	2.142	2.921	2.866	2.344	2.371	2.358

Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Në rajonin e Gjakovës nga analiza rezulton së klasteri i *kulturave të përhershme* ka të ardhurën neto për NjPV më të madhe (2,921 euro). Vijnë me *bagëti që kullosin* (2,866 euro), vazhdon me *të përziera blegtorale* (2,371 euro), *të përziera bimë dhe kafshë* (2,358 euro) duke e mbyllur me *kultura të përziera* (2,344 euro).

Gjatë hulumtimit janë kryer dy tipologji, për secilin rajon u përshkrua më lartë dhe një për të gjithë kampionin (tre rajonet). Dallimet mes dy tipologjive janë konsideruar të jenë një tregues përafrues i karakteristikave të ndryshme të sistemeve bujqësore në çdo rajon. Nga kjo kemi arrit në përfundimin se fermat e grupuara në klasterë kanë

rekomandime për rajone të caktuara në bazë të efektivitetit ekonomik që ato kanë si p.sh.

1. Rajoni i Prizrenit rekomandohet për klasterin e kulturave: *të përziera blegtorale, bagëti që kullosin*.

2. Rajoni i Pejës rekomandohet për klasterin e kulturave *të përhershme, bagëti që kullosin* dhe

3. Rajoni i Gjakovës rekomandohet për klasterin e kulturave *të përhershme, bagëti që kullosin*.

Krahasimi i të ardhurave të fermave të grupuara në klasteret për tre rajonet

Grafiku 64: Të ardhurat netto/NJ.P.V

Te ardhurat neto/NJPV			
	Gjakove	Prizren	Peja
Kultura lavërtare	2.142	2.735	2.412
Kultura të përhershme	2.921	2.648	4.854
Bagëti që kullosin	2.866	2.911	3.198
Kultura të përziera	2.344	2.390	2.291
Të përziera blegtorale	2.371	3.900	2.862
Ferma të përziera bimë dhe kafshë	2.358	2.374	2.548

Burimi: Analizë e autorit, anketat 2015

Analiza e klastereve

1. Fermat që mbjellin kultura lavërtare me drejtim kryesor autokonsumin.

Fermat që mbjellin kultura lavërtare është klasteri i cili kryesisht prodhon për vetëkonsum dhe një sasi të vogël të prodhimit e qesin në treg. Të ardhurat mesatare neto nga ky klaster janë si p.sh në Rajonin e Pejës nga shitja rreth 7,543 euro. Këto ferma nuk kanë ndonjë specializim për ndonjë kulture të veçantë. Në këtë tip të fermave anëtarët e familjes janë të angazhuar shumë në fermë, familja fermere përmban mesatarisht 6.2 anëtarë dhe nga kjo 4.9 punojnë në fermë. Sa i përket arsimimit kryesisht dominon arsimimi i mesëm me rreth 60%, dhe 7.7 % i lartë dhe po ashtu kemi rreth 31% me arsim fillor. Ky tip i fermave angazhon anëtarët e familjes si fuqi punëtore dhe ka një përqindje të vogël të krahut të punës jashtë familjes. Ky klaster përkrahet me subvencione (pagesa direkte për sipërfaqe të kultivuara). Struktura e fermës karakterizohet me sipërfaqe më të mëdha toke me rreth (6.4 ha), dhe ka rreth 4.3 % parcelizim të sipërfaqeve, dhe ka një nivel më të ulët të ujitjes. Nga analiza e të dhënave të madhësisë së fermave tek ky klaster është 39% të fermave kanë madhësi nga 0.5 -2 ha. Shpenzimet për farë te ky klaster sillen rreth 26.7% të shpenzimeve totale në të tre rajonet si dhe kanë shpenzime më të larta në punime të tokës (rreth 42 %).

2. Klasteri me kultura të përhershme

Fermat që mbjellin kultura të përhershme është klasteri i pemëve që kryesisht prodhon për tregun. Ky grup karakterizohet nga pjesa më e lartë e ardhurave neto në të tre rajonet e sidomos në Rajonin e Pejës ku nga shitja fitojnë rreth (86 % të vlerës totale të prodhimit), si dhe kanë një specializim më të qartë në një dhe dy lloj të prodhimit bujqësorë. Sa i përket arsimimit kryesisht dominon arsimimi i mesëm, ky tip i fermave angazhon fuqi punëtore jashtë anëtarëve të familjes, me ç'rast punësojnë 2-3% të ditëve

që punësohen këta punëtor në totalin e ditëve që punohet në fermë. Ky klaster nuk ka të ardhura shtesë si ndihma sociale, ka të ardhura shtesë nga përkrahja qeveritare si grante direkte për rritje të sipërfaqeve dhe përmirësim të infrastrukturës si dhe subvencione (pagesa direkte për sipërfaqe të kultivuara). Struktura fermës karakterizohet me sipërfaqe relativisht të vogla (3.3 ha), me 4.5 % parcelizim të sipërfaqeve, por ka mundësi për t'u përdorur për ujitje, pjesa më e madhe e sipërfaqeve ujiten. Nga analiza e të dhënave të madhësisë së fermave tek klasterat e kulturave të përhershme kanë përqindje më të madhe të fermave me madhësi nga 0.5 -2 ha, pra rreth 40%, Ky klaster ka shpenzime të larta në fazën e investimeve për fidane, shpenzime mesatare për plehërime dhe spërkatje (28% të shpenzimeve) si dhe shpenzime të larta në punime toke (rreth 44%). Shpërndarja midis aktiviteteve të kultivimit është në favor të prodhimit të pemëve si mollë, dardhë, kumbull, vishnje, manaferrë dhe rrush).

3. Klasteri me bagëti që kullosin

Ferma të specializuara në blegtori (kryesisht në bagëti të imta), pra fermat që janë më të specializuara në prodhimin blegtoral. Ky grup karakterizohet me angazhim të madh të fuqisë punëtore sidomos anëtareve të familjes ku nga 4.9 anëtarë që jetojnë në këto ferma 6.1 punojnë në fermë. Sa i përket arsimimit kryesisht dominon arsimimi i mesëm rreth 59%. Duket se ky klaster duhet të ketë një strategji për rritjen e sipërfaqes së tokës punuese për shkak të tokës së punueshme kufizuar (mesatarisht më pak se një hektar / fermë) dhe të mundësive të reduktuara për t'u punësuar në sektorin jo-bujqësor. Pjesa e tokës së kultivuar (99% të sipërfaqes totale të tokës) tregojnë domosdoshmërinë e sipërfaqeve shtesë të tokës për fermat e këtij grupi. Të ardhurat neto nga ky klaster janë 7.046 euro, Prodhimi kulturë e këtij grupi është e karakterizuar nga një përdorim të kufizuar të mekanikës apo shpenzimeve të tjera bujqësore dhe jo një përdorim jashtë mase të forcës së punës.

4. Klasteri me kultura të përziera

Ferma të përziera (polikulturë kryesisht perime). Në këtë grup prodhimi kulturë të punueshme që janë dominante (gati 90% të prodhimit të përgjithshëm kulturë janë perimet). Pjesa e shitjes mbetet e rëndësishme dhe familja nga ky grup i prodhimit ka mbështetje të fortë financiare. Kryesisht janë të specializuara në dy deri tre prodhime, këto realizohen në fushë të hapur dhe ambiente të mbyllura. Ndihet nevoja të përmirësohet infrastruktura bujqësore për fermat e këtij lloji. Vetëm 11% e tokës së punueshme ujitet. Ka një konkurrencë të qartë për forcën e punës në mes të aktiviteteve bujqësore dhe aktivitete të tjera. Këto ferma punësojnë punëtorë sezonal 49 %, kjo rezulton mesatarisht nga 2.3% deri në 3.3% të ditëve që punësohen këta punëtorë me totalin e ditëve që punohet në fermë. Struktura fermës karakterizohet me sipërfaqe relativisht të vogla (2.6 ha), me 3.6 % parcelizim të sipërfaqeve. Nga ana tjetër, fermat e këtij grupi përdorin në pjesë më të madhe mekanikën bujqësore dhe shpenzimet e tjera. Forcat e kufizuara të punës dhe mundësitë të reduktuara për të ujitur, të udhëhequr fermerët për të ndjekur një strategji për intensifikimin e prodhimit bujqësor, duke rritur përdorimin e mekanizimit. Prodhimi është i ndarë në mes të vetë-konsumit dhe të tregut duke u përpjekur për të prodhuar jo vetëm ushqimin për familje, por edhe produktet që mund të shiten në tregjet pa kosto të rëndësishme të transaksionit (jo shitjeve direkte). Shpenzimet e farës të ky klaster nxënë 33% nga shpenzimet totale, shpenzime tjera për inpute dhe punim toke janë 22%,

5. Klasteri të përziera blegtorale

Ferma të përziera blegtorale, në këtë klaster mesatarisht në familjen fermere jetojnë 5.7 anëtarë nga të cilët 5.6 janë në moshë punë dhe 3.6 anëtarë punojnë në fermë. Dominon shkollimi i mesëm dhe fillor i bartësve të fermave bujqësore apo menaxherëve të tyre. Në këtë klaster kemi një angazhim më të madh të fuqisë punëtore jashtë fermës

me rreth 3 % dhe më shumë të ditëve që të ditëve që punësohen këta punëtor në totalin e ditëve që punohet në fermë. Sa i përket strukturës së fermës themi se madhësia mesatare e parcelave tek klasteri të përziera blegtorale është (6.2), dhe 3.9 është parcelizimi i këtij klasteri. Nga ana tjetër, fermat e këtij grupi përdorin një pjesë më të madhe mekanikën bujqësore dhe shpenzimet e tjera. Shpenzimi i farërave nxë një vlerë prej 16%, për plehra kimike 9%, dhe shpenzime për punime toke 14 %. Prodhimi është i ndarë në mes të vetë-konsumit dhe të tregut duke u përpjekur për të prodhuar jo vetëm ushqimin për familjen, por edhe produktet që mund të shiten në tregjet pa kosto të rëndësishme të transaksionit (jo shitjeve direkte).

6. Klasteri me ferma të përziera bimë dhe kafshë

Ferma të diversifikuara (më shumë aktivitete), është njëri prej klasterëve më të ardhura më të ulëta që sillën rreth 4,925 euro, këto ferma nuk kanë ndonjë specializim sa i përket prodhimtarisë, kryesisht punësojnë anëtarët e familjes, ju mungon infrastruktura bujqësore. Sa i përket strukturës së fermës themi se ky klaster ka madhësi mesatare të parcelave 3.1 dhe parcelizim 4.6. Të ardhurat nga shitja janë rreth 75% në tre rajonet, kurse shpenzimet më të larta i kanë sa i përket në punime të tokës me rreth 30% dhe shpenzime për farë 26 % dhe për plehra kimike 19 %. Do të thotë se ky klaster ka shpenzime shumë të larta në krahasim me efektivitetin ekonomik.

Rekomandime të pjesshme

Nga analiza e bërë rezulton se sektori bujqësorë në Kosovë ka pasur tendenca pozitive viteve të fundit. Në këtë kontekst shihet se tipet e fermave dy dhe katër (ferma që mbjellin kultura të përhershme dhe ferma të përziera) tregojnë një tendencë rritjeje vitet e fundit dhe mund të themi se ato do të konsiderohen si sektor lider në të ardhmen jo vetëm në gjenerimin e vendeve të reja të punës por dhe në kontributin që do të japin ato

në të ardhurat e fermave bujqësore. Momentalisht këto ferma kanë një sërë problemesh :

- Sezonalitetin e produkteve bujqësore pasi nuk arrijnë të plotësojnë nevojat e popullsisë jashtë sezonit;
- Mbiprodhim në pikun e sezonit bujqësorë (gusht - shtator) fakt i cili ndikon negativisht në uljen e çmimeve të produkteve bujqësore sidomos për tipin e fermës 4;
- Mos funksionim i sistemit të ujitjes, sidomos në zonën e Gjakovës;
- Mekanika bujqësore në një pjesë të madhe të fermave është tejet e amortizuar;
- Mungesa e kooperimit mes fermerëve, sidomos në pas periudhës së vjeljeve të produkteve bujqësore;
- Mungesa e kushteve të ruajtjes për një kohë të gjatë produkteve bujqësore;
- Në disa raste mungesa e financimeve bën që fermerët të mos kenë para në dorë për të paguar shpenzimet në momentin e fillimit të ciklit bujqësorë;
- Jo profilizimi i prodhimit të fermave, pasi që prodhojnë disa lloje të kulturave dhe në asnjërin nuk janë të specializuar;
- Mungesa e planifikimit të prodhimit, prodhimtaria nuk është e orientuar kah tregu (kërkesa);
- Mungesa e njohurive për aplikimin e teknikave më të avancuara poma dhe agroteknike në prodhim, mbrojtje dhe ruajtje që ndikon direkt në rendiment;
- Megjithatë për këto dy tipe fermash paraqiten një sërë mundësish për të ardhmen të cilat do të nxisin zhvillimin e këtyre dy tipeve në të ardhmen. Disa nga mundësitë që kanë këto dy tipe fermash janë:
- Zgjatja e periudhës së prodhimit të kulturave bujqësorë duke ulur në këtë mënyrë kërkesën për produkte të importit nëpërmjet përmirësimit të teknologjive në sera, ngritjes së dhomave ftohëse, konsolidimit të pikave të grumbullimit etj;
- Krijimit apo fortësimit të funksionimit të zinxhirit të vlerës në këta sektor;

- Gjetja e tregjeve të reja për eksport për tregtimin e produkteve bujqësore ;
- Aktualisht në vendet e rajonit Republikën e Shqipërisë Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë eksportohen sasi të vogla të produkteve bujqësore, pasi kemi kushte të përafërta klimatike. Tregjet kryesore ndërkombëtare për pasimin e produkteve të freskëta janë Gjermania, Zvicra dhe Suedia. Në këto vende eksportohen kryesisht specat dhe rrush tavoline. Njëkohësisht ekzistojnë edhe tregje të tjera, si Belgjika, Mbretëria e Bashkuar apo Turqia. Në këto kushte rritja e kërkesës për eksport nga këto vende do të nxisë shumë rritjen e aktivitetit bujqësor për këto dy tipe fermash.
- Gjithashtu një mundësi tjetër është përmirësimi i teknologjisë përpunuese. Lëngjet e frutave kosovare apo ajvari kanë një reputacion shumë të madh në të gjithë rajonin.

KAPITULLI VII

KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET

Ky kapitull do të paraqesë konkluzionet e gjithë hulumtimit, të përcjellura me rekomandimet për të gjithë aktet e këtij sektori, politikë bërësit dhe hulumtimet në të ardhmen.

Së pari të gjeturat kryesore do të diskutohen dhe do të krahasohen me rishikimin e literaturës në mënyrë për të theksuar kontributin teorik. Në pjesën e parë autori do të jetë në gjendje për t'iu përgjigjur pyetjeve të kërkimit, dhe për të verifikuar nëse propozim hulumtimin e këtij studimi mund ta mbajmë. Më pas konkluzionet e përgjithshme do të përkthehen në një kornizë që do të ndihmojë të gjithë aktet për të trajtuar më mirë tipologjinë e fermave në Republikën e Kosovës dhe për të pasur në konsideratë efektivitetin ekonomik të tyre, dhe në fund kufiri i studimit dhe rekomandimet për hulumtime në të ardhmen.

7.1. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUZIONE

Në bazë të të dhënave të studiuara gjatë punës sonë kërkimore, si dhe nga puna e bërë në terren, ne kemi arritur në një sërë konkluzionesh të rëndësishme të cilat na ndihmuan ti përgjigjemi pyetjeve kërkimore dhe të bëjmë verifikimin e hipotezave si në vijim :

Hipoteza 1: Konkurrueshmëria e fermave nuk varet vetëm nga madhësia e tyre por dhe nga një sërë treguesish të tjerë, si, numri i të punësuarve, të ardhurat neto të saj, apo të ardhurat për ditë punë.

Pytjet kërkimore 1 - Cila është tipologjia e fermave bujqësore në Kosovë dhe në zonën e studimit që do të bëjë të mundur rritjen e efektivitetit të tyre me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në treg.

Hipoteza e parë vërtetohet si e saktë se konkurrueshmëria e fermave nuk varet vetëm nga madhësia e tyre, numri i punëtorëve, të ardhurat por varet edhe nga një sërë faktorësh tjerë si niveli i edukimit, struktura e fermës, fragmentizimi, vlera e prodhimit, masat agroteknike të përdorura etj.

📊 Konkurrueshmëria e fermave varet edhe nga niveli i edukimit, në nivelin e tre rajoneve rezulton se arsimimi i fermerëve të intervistuar është kryesisht i mesëm dhe fillestar ndërsa arsimi i lartë është vetëm 6% në Pejë, 3.8 % në Prizren dhe 5.6 % në Gjakovë. Ndërsa arsimi i mesëm i profilizuar në atë bujqësor është vetëm 11% në Pejë, 16% në Prizren dhe 15% në Gjakovë.

📊 Niveli i shkollimit të bartësve të fermave /menaxherëve është i përafërt në të gjitha tipet e fermave (klasterave) në të gjitha rajonet, i cili kryesisht është i ulët dhe kjo reflekton automatikisht në suksesin e fermave bujqësore sidomos zhvillimin në hap me kohë të teknikave dhe teknologjisë më të avancuar, përdorimin e varieteteve më të reja, përdorimin e masave agro dhe pomoteknike më të avancuara që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe kualitetin, e po ashtu edhe në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve.

📊 Po ashtu është studiuar krahu i punës në këto ferma që buron nga familja fermere, Rajonet e Pejës dhe Prizrenit i kanë fermat me nga 3 deri në 4 krah punë nga familja fermere me masën rreth 44% ndërsa në Gjakovë me rreth 43%. Me mbi 4 krah punë janë 23% të fermave të rajonit të Pejës dhe Prizrenit dhe me rreth 21% rajonit të Gjakovës.

📊 Pra rezulton se në tipologji është përfshirë edhe krahu i punës si kriter me ç'rast

shohim se kemi të bëjmë me ferma që kanë një krah pune shumë të kufizuar e po ashtu kryesisht që vjen nga familja dhe një % e vogël del se punësojnë punëtor jashtë fermës.

✚ Sa i përket strukturës së fermës themi se madhësia mesatare e parcelave tek gjashtë klasterat është 4.7 ha, që do të thotë se kemi të bëjmë me ferma të vogla, Klasteri i kulturave lavërtare dhe klasteri i bagëtiqe që kullojnë kanë sipërfaqe mesatare më të madhe (6.4), duke vazhduar me klasterin të përziera blegtorale me madhësi mesatare (6.2), përcjell me klasterin kultura të përhershme me madhësi mesatare (3.3) dhe klasterin me madhësi mesatare më të vogël kultura të përziera (2.6).

✚ Pra në zonën e studimit kemi fermat e vogla për nga madhësia, të fragmentizuara, me një numër të vogël të krahut të punës kryesisht familjar, teknologji dhe masa agroteknike jo mire të avancuara, vlerë të ulët prodhimi për njësi. Në bazë të vlerës së prodhimit del se produktet në rajonin e Pejës kanë nivelin më të lartë të shitjeve si p.sh. Kulturat e përhershme me 86%, e ndjekur nga produktet e Bagëti që kullojnë me 83% e kështu më radhë deri tek 75% e produktit nga fermat të përziera bimë dhe kafshë. Do të thotë se këto janë ferma që bëjnë të mundur rritjen e efektivitetit të tyre me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në treg.

Hipoteza 2 - Tipi i fermave që ruan një nivel konkurrueshmërie më të lartë ndikon pozitivisht në efektivitetin e punës në fermë dhe në përmirësimin e të ardhurave të fermës familjare.

Pyetja kërkimore 2 - Cila është madhësia, tipologjia, lloji i punës dhe tregues të tjerë që bëjnë të mundur përcaktimin e tipologjisë së fermës më të përshtatshme për rajonin e marrë në studim aspekteve pozitive dhe negative të funksionimit të këtyre tipave të fermave?

Fermat në zonën e studimit janë kryesisht të vogla me madhësi, sa i përket strukturës së fermës, themi se madhësia mesatare e parcelave tek gjashtë klasterat është 4.7 ha që do të thotë se kemi të bëjmë me ferma të vogla. Struktura e bujqësisë kosovare karakterizohet nga ferma të vogla, prodhimtari të ulët, teknika dhe teknologji të vjetruara dhe investime të pakta në fermat bujqësore.

Së pari mund të themi se jo të gjitha tipet e fermave të cilat ne i kemi modelizuar do të jenë të afta të mbijetojnë në afatin e gjatë kohor. Përgjithësisht fermerët kanë filluar gjithnjë e më tepër që të drejtohen drejt aktiviteteve më fitim prurëse. Sa i përket tipologjisë fermat i kemi grupuar në këto kategori në gjashtë tipe të mëdha në funksion të orientimit të prodhimit :

- ✓ Ferma që mbjellin kultura lavërtare me drejtim kryesor autokonsumin
- ✓ Ferma që mbjellin kultura të përhershme
- ✓ Ferma të specializuara në blegtori (kryesisht në bagëti të imta)
- ✓ Ferma të përziera (polikulturë kryesisht perime)
- ✓ Ferma të përziera blegtorale
- ✓ Ferma të diversifikuara (me shumë aktivitete)

Tipi i dytë i fermave i kulturave të përhershme dhe **Tipi i tretë** i fermave, bagëti që kullosin, do të vazhdojnë të ekzistojnë dhe do të kenë rritje, pasi ato arrijnë të gjenerojnë sasi të ardhurash të konsiderueshme. Pra këto tipe të fermave ruajnë nivelin e konkurrueshmërisë dhe ndikojnë pozitivisht në efektivitetin e punës në fermë dhe në përmirësimin e të ardhurave të fermës familjare.

Pra, kanë një të ardhur bruto shumë të lartë dhe janë më të qëndrueshme nga pikëpamja ekonomike. Si për shembull të ardhurat neto për njësi punë (shih në grafikun 64, të ardhurat netto/NJ.P.V) rezulton se ka të ardhura më të larta në tre rajonet për njësi të

punës vjetore. Kurse tipet tjera të fermave, **tipi i parë i fermave kulturave lavërtare** në të ardhmen do të kenë vështirësi në drejtim të efikasitetit të tyre, ku efikasiteti do të zvogëlohet me kalimin e kohës, **Tipi i fermave katër dhe pesë** janë ferma të cilat nuk kanë ndonjë specializim në prodhimtari dhe kanë efikasitet të ulët, **tipi i gjashtë i fermave** bëjnë pjesë fermat me aktivitet të diversifikuar, ky tip i fermës është tipik për ekonomitë e vogla dhe në të ardhmen do të tentojë të zhduket.

Hipoteza 3 - Cilat janë instrumentet e politikave që mbështesin fermat bujqësore familjare në ndihmë të rritjes së efektivitetit ekonomik të tyre dhe mundësisë për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në treg.

Pyetja kërkimore 3 - Instrumentet e politikës që mbështesin fermat janë subvencionet dhe grantet me qëllim të rritjes së efektivitetit ekonomik dhe konkurrueshmërisë së tyre në treg. Qëllimi i hulumtimit ka qenë të vërtetohet se a janë instrumentet e politikës bujqësore në mbështetje të fermave bujqësore në Kosovë. Është vërtetuar si e saktë se instrumentet e politikës janë të pamjaftueshme në mbështetjen e fermave për rritjen e të ardhurave në nivel ferme.

Nga studimi kemi arritur në përfundim se instrumentet e politikës janë të pamjaftueshme për rritjen e të ardhurave në nivel ferme dhe kemi dal me disa konkluzione si dhe rekomandime për politikë bërësit si dhe studiuesit në të ardhmen.

 Sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural ka arrit që të jetë në nivelet më të larta të agjendës politike, si dhe viteve të fundit ka një trend pozitiv të rritjes së përkrahjes institucionale të sektorit të bujqësisë, agro-përpunimit dhe zhvillimit rural me qëllim për të arritur reduktimin e varfërisë në zonat rurale dhe njëkohësisht për të stimuluar zhvillimin ekonomik. Akoma në këtë sektor ka mjaft për tu bërë, sektori i bujqësisë ka filluar të përkrahet me subvencione dhe grante që nga viti 2007 dhe ka një rritje konstante të nivelit të përkrahjes si dhe sektorëve

që përkrahen. Edhe pse pjesa më e madhe e fermerëve janë regjistruar në regjistrin e fermave, ata nuk janë të përfshirë masivisht në sistemin e skemave dhe granteve të dhëna nga ministria. Për pjesën më të madhe prej tyre regjistrimi në këtë regjistër është vetëm formal;

✚ Procesi i integritetit e ka vendos bujqësinë përballë vështirësive të ndryshme për shkak të strukturave aktuale të fermave në zonat rurale, institucioneve publike jo të konsoliduara dhe konkurrencës nëpërmjet produkteve evropiane dhe atyre kosovare;

✚ Politikat publike kanë pasur shumë pak ndikim në zonat rurale, aplikimi mbetet një pikë e dobët dhe ndikimi është i limituar. Përgatitja e sektorit publik për të harmonizuar veprimet kombëtare me linjën e përgjithshme të Bashkimit Evropian mbetet faktori kryesor i pasigurisë;

✚ Tregtia ndërkombëtare tregon varësinë e tregut kosovar nga çmimet dhe strukturat ndërkombëtare. Këto tipare do të rrisin varësinë e tregut kombëtar nga ai ndërkombëtar. Rritja e kapaciteteve kombëtare mbetet një nga objektivat kryesore të politikave të së ardhmes;

✚ Ndihet nevoja e azhurnimit të politikave fiskale dhe doganore me qëllim të mbrojtjes së prodhuesve vendorë ndaj prodhimeve të importuara;

✚ Nxjerrja e udhëzimit administrativ për mbrojtjen e sipërfaqeve tokësore nga fragmentimi si në shumë vende të botës;

✚ Zhvillimi dhe zbatimi i politikave për konsolidimin e tokës, komasacionin e tokës dhe mbrojtjen nga ndërrimi i destinimit është nevojë imediate.

- 🚦 Lansimi i ndonjë programi për kreditim rural me kredi të favorshme dhe afatgjata të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e këtij sektori.

Përveç konkluzioneve në lidhje me tipet e fermave të evidentuara prej nesh, nga anketimi kemi nxjerrë dhe një sërë konkluzionesh të tjera të rëndësishme në lidhje me situatën e përgjithshme të fermave bujqësore në rajonet e studimit. Nuk është e gabuar nëse për këto konkluzione vejmë shenjën e barazimit dhe me zonat e tjera të Kosovës. Për të vërtetuar këtë nisemi nga analiza e përgjithshme që i kemi bërë situatës së përgjithshme të zhvillimit ekonomik e bujqësor në Kosovë.

Të gjitha këto konkluzione sa i përket tipologjisë dhe konkurrueshmërisë së fermave po i rendisim si më poshtë:

- ✚ Struktura e bujqësisë kosovare karakterizohet nga shumë ferma të vogla dhe shkalla e lartë e fragmentizimit ndikon negativisht në përmirësimin e strukturës së prodhimeve në fermat bujqësore;
- ✚ Nga hulumtimi rezulton se këto ferma luajnë rol të rëndësishëm në punësimin e popullsisë rurale, ku përgjithësisht janë punësuar anëtarët e familjes. Numri i punëtorëve të fermës jo anëtarë të familjes është shumë i vogël. Kryesisht janë të punësuar me kohë të pjesshme;
- ✚ Në zonat rurale ka një efektshmëri të ulët të fuqisë punëtore si pasojë e sipërfaqes së kufizuar të fermave dhe e nivelit të ulët në investimet bujqësore;
- ✚ Fermerët dhe banorët rural kanë të ardhura të ulëta nga ferma, kjo çon në mos përmirësimin e standardeve të jetesës dhe kushteve të punës në zonat rurale;
- ✚ Në zonë shihet krijimi i fermerit oportunist, të lidhur me tregun i cili ka lënë mënjanë aktivitetet tradicionale të fermës drejt aktiviteteve më tregtare;

- # Strategjitë e fermave kërkojnë shfrytëzimin produkteve që ofrojnë vlerë të shtuar nga karakteristikat e rajonit;
- # Nga anketimet rezulton se të ardhurat që vijnë nga bletaria janë shumë të kënaqshme dhe kjo konsiderohet si aktivitet i së ardhmes në Kosovë;
- # Mungesa e planeve strategjike bën që fermerët shpeshherë të bëjnë gabime me fermat e tyre, fakt i cili ndikon edhe në humbjen e burimeve;
- # Të ardhurat neto në fermë në fermat e zonës së studimit janë më të vogla se sa në vendet e rajonit për shkak të madhësive ekonomike të fermave, përfaqësuar nga standard outputi i tyre. Kosova i përket kategorisë IV të madhësisë ekonomike ashtu siç renditet nga BE-ja;
- # Niveli i ulët i shkollimit të popullsisë në zonat rurale ndikon negativisht në mungesën e vizionit për të ardhmen e fermave të tyre në afatin e gjatë kohor. Pjesa më e madhe e fermerëve mendon vetëm sot për sot;
- # Niveli i arsimimit të menaxherëve/pronarëve është mjaft i ulët (i mesëm dhe fillor) që paraqet pengesë në zhvillimin strategjik të këtyre fermave në të ardhmen e sidomos kur kërkohet aplikimi i teknikave dhe teknologjive moderne në mënyrë që të jenë konkurrentë në treg;
- # Ferma që mbjellin kultura të përhershme dhe ferma të përziara janë fermat lidere në Kosovë dhe mund të themi se janë fermat e së ardhmes që premtojnë shumë, si në aspektin e krijimit të të hyrave në nivel ferme, ashtu edhe në nivel kombëtar po që premtojnë punësim në nivel vendi;

- # Pamundësia për të depërtuar në mënyrë direkte nëpër tregjet ndërkombëtare, mungesa e laboratorëve të specializuar, si dhe vështirësitë financiare aktualisht pengojnë zhvillimin e fermave në zonën e studimit;
- # Pjesa më e madhe e investimeve në fermat e tre rajoneve sigurohet nga të ardhurat që vijnë nga remitancat si pasojë e nivelit të ulët të kreditimit nga bankat e nivelit të dytë;
- # Gjithashtu dhe niveli i subvencioneve nga ana e Ministrisë së Bujqësisë është shumë i ulët. Megjithëse pjesa më e madhe e fermerëve janë regjistruar në regjistrin e fermave, ata nuk janë të përfshirë masivisht në sistemin e skemave dhe granteve të dhëna nga Ministria. Për pjesën më të madhe prej tyre regjistrimi në këtë regjistër është vetëm formal;
- # Informacionet aktuale që kemi në dispozicion për rentabilitetin e fermave në Kosovë janë të kufizuara dhe nuk lejojnë të bëjmë analizë të thuktë për caktimin e të ardhurave në fermë;
- # Si konkluzion të përgjithshëm duhet të theksojmë se bujqësia kosovare është në udhëkryq. Ajo ka të gjitha tiparet e një vendi bujqësor në zhvillim, por nga ana tjetër duhet një rritje e performancës për sfidat e të ardhmes në integrim;
- # Menaxhimi i burimeve natyrore gjatë 15 viteve të fundit ka treguar dobësinë e institucioneve rregullatore kombëtare. Efekti i burimeve është i dukshëm në cilësinë e burimeve natyrore të rinovueshme;
- # Efikasiteti dhe aftësia konkurruese në prodhimtarinë primare bujqësore e ulët, në mënyrë që të arrihet zëvendësimi i importit dhe të përfitohet nga tregjet e eksportit;

- # Niveli i ulët i përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore dhe pyjore, që ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin dhe aftësinë konkurruese; Niveli i ulët i cilësisë dhe standardeve të higjienës në fermë/fabrikë; që ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillim të qëndrueshëm rural dhe përmirësimin e cilësisë së jetës (duke përfshirë infrastrukturën), mungesa e promovimit të bujqësisë dhe aktiviteteve tjera ekonomike, të cilat janë në harmoni me mjedisin; krijimin e mundësive të punësimit në zonat rurale etj.;
- # Të investohet në profilizimin e fermave bujqësore;
- # Përmirësimi i kualitetit të produktit dhe kuantitetit të prodhimeve;
